

# RAPORT VJETOR 2020

## Përmbajtja

|                                                                                                                                                                                |           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE .....</b>                                                                                                         | <b>4</b>  |
| <b>HYRJE .....</b>                                                                                                                                                             | <b>6</b>  |
| <b>1. STRATEGJIA E AUTORITETIT .....</b>                                                                                                                                       | <b>11</b> |
| <b>2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2019 .....</b>                                                 | <b>12</b> |
| <b>3. MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT .....</b>                                    | <b>34</b> |
| <b>4. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT .....</b>                                                       | <b>38</b> |
| <b>4.1 Progres-Raporti i BE-së .....</b>                                                                                                                                       | <b>38</b> |
| <b>4.2 Raportime të tjera .....</b>                                                                                                                                            | <b>39</b> |
| <b>5. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT .....</b> | <b>41</b> |
| <b>6. QEVERISJA E AUTORITETIT .....</b>                                                                                                                                        | <b>44</b> |
| <b>6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet .....</b>                                                                                                                         | <b>44</b> |
| <b>7. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM ....</b>                                                                                               | <b>49</b> |
| <b>7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara .....</b>                                                                                                                  | <b>49</b> |
| <b>7.2 Monitorimet e përmbajtjeve .....</b>                                                                                                                                    | <b>50</b> |
| <b>7.3 Qasja ndaj dukurisë së piraterisë në transmetimet audiovizive .....</b>                                                                                                 | <b>53</b> |
| <b>8. KËSHILLI I ANKESAVE .....</b>                                                                                                                                            | <b>55</b> |
| <b>9. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE .....</b>                                                                                                             | <b>59</b> |
| <b>9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit .....</b>                                                                                         | <b>59</b> |
| <b>9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve .....</b>                                                                          | <b>59</b> |
| <b>9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit .....</b>                                                                              | <b>60</b> |
| <b>9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave .....</b>                                                                                                          | <b>61</b> |
| <b>10. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV .....</b>                                                                                                      | <b>70</b> |
| <b>10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv .....</b>                                                                                      | <b>70</b> |
| <b>10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore .....</b>                                                                                                | <b>70</b> |
| <b>10.3 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv .....</b>                                                                                                              | <b>71</b> |
| <b>11. KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE .....</b>                                                                                                                               | <b>73</b> |
| <b>11.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital II .....</b>                                                                                                                    | <b>78</b> |
| <b>11.2 Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit .....</b>                                                                                                 | <b>79</b> |
| <b>11.3 Kontrata AMA – RTSH .....</b>                                                                                                                                          | <b>80</b> |
| <b>11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave .....</b>                                                                                                       | <b>84</b> |
| <b>11.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive .....</b>                                                                                                        | <b>84</b> |
| <b>11.4.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio .....</b>                                                                                                              | <b>86</b> |

|         |                                                                                             |     |
|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 11.4.3  | Koordinimi i frekuencave të brezit audio/audioviziv .....                                   | 87  |
| 11.5    | Adresimi i interencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive .....                 | 87  |
| 12.     | <b>AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL</b> ..... | 90  |
| 12.1    | Organizimi i brendshëm i institucionit .....                                                | 90  |
| 12.2    | Programi i transparencës .....                                                              | 91  |
| 12.3    | Aktivitetet e Autoritetit .....                                                             | 92  |
| 12.4    | Botimet e Autoritetit .....                                                                 | 95  |
| 12.5    | AMA në bashkëpunim me partnerët .....                                                       | 95  |
| 12.6    | Marrëveshjet e bashkëpunimit .....                                                          | 96  |
| 12.7    | Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s .....                                               | 98  |
| 12.8    | Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore .....                                        | 99  |
| 13.     | <b>TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE</b> .....                                  | 101 |
| 13.1    | Menaxhimi i burimeve financiare .....                                                       | 101 |
| 13.2    | Realizmi i burimeve të financimit në vitin 2020 .....                                       | 102 |
| 13.3    | Detyrimet financiare të OSHMA-ve .....                                                      | 105 |
| 13.4    | Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2020 .....                                         | 107 |
| 13.5    | Pasqyrat financiare .....                                                                   | 110 |
| ANEKS 1 | .....                                                                                       | 113 |
| ANEKS 2 | .....                                                                                       | 144 |

## **MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,**

**Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,**

**Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,**

Viti 2020 ka qenë krejt i pazakontë edhe për transmetimet audio dhe audiovizive në vendin tonë. Pandemia globale COVID-19 ka ndikuar në performancën e OSHMA-ve, ka dhënë efekte në strukturën dhe katalogun e përmbajtjeve të emetuara; në burimet njerëzore të angazhuara, në treguesit ekonomikë dhe financiarë, ku u reduktuan ndjeshëm të ardhurat nga reklamat dhe promocioni etj.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) u përfshi në aspekte të ndjeshme, që lidhen drejtpërdrejt me pasojat nga COVID-19. Duke nxitur dhe ndërgjegjësuar OSHMA-të, që të ishin bashkëpunuese me autoritetin shëndetësor publik në transmetimin e mesazheve informuese për qytetarët dhe institucionet, të nevojshme për parandalimin e përhapjes së koronavirusit, për njohjen me masat dhe protokollat e mbrojtjes dhe kurimit të rasteve të infektimit. Reagimi i OSHMA-ve ka qenë i menjëhershëm dhe efikas, në zbatim të kërkesave ligjore për raste të tilla, duke përcjellë, disa herë në ditë, mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, krahas angazhimit të redaksive për informimin intensiv mbi situatën epidemiologjike në vend dhe për sqarimin e dukurive, pjesa më e madhe të panjohura më parë.

Në këtë situatë të paprecedentë, AMA, jo vetëm që nuk ndërpreu apo zbehu angazhimet për funksionimin institucional dhe realizimin e objektivave, por, në vendimmarrjen e vet, u investua edhe në dimensionin social. Vijuan projektet me partnerët, institucione dhe organizata që punojnë në fushën e mediave, si dhe u lidhën marrëveshje me Ministrinë e Kulturës, për mbështetjen e projekteve të përbashkëta audiovizive, sidomos krijuesit e rinj, për promovimin e trashëgimisë sonë kulturore, si dhe me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, në garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audio e audiovizive. AMA nuk aplikoi vendosje të kamatëvonesave për shlyerjen e detyrimeve nga OSHMA-të, në përballjen e tyre me efektet negative nga COVID -19. Për vitin 2021, Autoriteti, po shqyrton vijimin e lehtësimit për detyrimet financiare nga sektorët më të goditur të tregut audio dhe audioviziv.

Përgjegjshmëri dhe seriozitet u tregua dhe në masat që morën redaksitë e OSHMA-ve për të mbrojtur shëndetin e personelit të tyre brenda dhe jashtë mjediseve të punës, si dhe për respektimin e standardeve për numrin dhe distancën e të ftuarve në programe të ndryshme audiovizive, duke u orientuar më shumë tek aplikimet e komunikimit në distancë, përmes lidhjeve virtuale direkte ose të regjistruara.

Viti 2020 do të mbahet mend dhe si viti i mbylljes së transmetimeve analoge në të gjithë territorin e vendit. Me gjithë rrethanat e pazakonta, që u shkaktuan nga përhapja në masë e COVID-19, kjo nuk pengoi finalizimin e procesit strategjik të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive. Qytetarët, në 12 qarqet e vendit, janë përfituesit më të mëdhenj të kalimit nga analogu në digjital: ata janë përballë realitetit konkret të shërbimit me cilësi dhe shumëllojshmëri të përmbajtjeve programore, por dhe duke pasur mundësi për më shumë kanale pa pagesë. Oferta, që varion nga 28 deri në 39 kanale pa pagesë, përbën një impakt që është ndër më pozitivët, krahasuar me vendet e rajonit.

Duke alternuar mbledhjet me prezencë fizike me ato me komunikim online, AMA vijoi normalisht funksionalitetin në vendimmarrje, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut audio dhe audioviziv, me shqyrtimin e miratimit të licencave dhe autorizimeve; me ndryshimet për përmirësimin e akteve nënligjore, duke komunikuar dhe bashkëpunuar me institucione publike ose jopublike në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta, si dhe duke përmbushur detyrën e raportimit, në mënyrë periodike, për Kuvendin e Shqipërisë.

COVID-19 nuk e pengoi AMA-n në realizimin e projekteve me partnerët, duke u fokusuar te sinergjia për studimin e tregut audioviziv në Shqipëri dhe modelet e vendeve të tjera; për përkthimin në shqip të botimeve më të zëshme të fushës; për kualifikime të personelit të OSHMA-ve etj. Përshtatur me rrethanat e krijuara, AMA organizoi një sërë panelesh virtuale, ku, me përfaqësues të OSHMA-ve, ekspertëve të fushës dhe grupeve të interesit, ndau mendime, vlerësime dhe propozime për përmirësimin e raportimit për mbrojtjen e fëmijëve, për edukimin mediatik, për shmangien e gjuhës së urrejtjes e diskriminimit etj.

Raporti vjetor, që po ju paraqesim, tregon, në mënyrë të strukturuar dhe të detajuar, të gjithë dinamikën e angazhimeve të AMA-s gjatë vitit 2020, duke parashtruar aspekte konkrete, duke i ilustruar me shembuj dhe të dhëna. Ky material bazohet në objektivat dhe funksionet institucionale, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke përfshirë dhe problematika e sfida për Autoritetin, në rolin dhe misionin e tij si rregullator i transmetimeve audio dhe audiovizive në vendin tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

## HYRJE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s, të përcaktuara në ligjin 97/2013, në Strategjinë për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2020, Autoriteti është angazhuar maksimalisht t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka ndikuar drejtpërdrejt dhe në tregun e transmetimeve audio/audiovizive. Dy fokuset kryesore të AMA-s, që në fillim të muajit mars 2020, si dhe në vijim, pas Vendimit të Këshillit të Ministrave (nr.243, datë 24.03.2020 për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore) ishin:

- zbatimi nga OSHMA-të i kërkesave të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht neni 34, ku flitet për informacionet që transmetohen pa shpërblim, si dhe kërkesave të rregullores së miratuar me vendim të AMA-s nr. 76 datë 04.04.2016, konkretisht nenin 6, pika 4, po për këtë çështje;
- zbatimi i masave dhe protokolleve të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në radhët e personelit që angazhohet brenda mjediseve të redaksive e studiove të regjistrimit dhe transmetimit, si dhe kufizimet në pjesëmarrjen e publikut në programet audiovizive direkte ose të regjistruara.

Të gjitha OSHMA-të kanë treguar gatishmëri në transmetimin pa pagesë të njoftimeve nga autoriteti shëndetësor, si pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimi të publikut në kushte të pazakonta, duke ndikuar drejtpërdrejt në përballimin e pasojave nga COVID-19. Redaksitë e OSHMA-ve, gjatë periudhës së pandemisë, janë angazhuar përmes reporterëve, redaktorëve dhe moderatorëve për të informuar pa ndërprerje mbi situatën epidemiologjike në vendin tonë, por dhe duke trajtuar dhe analizuar aspekte të ndryshme, që lidheshin me aktualitetin dhe sfidat në përballjen me pandeminë.

Nga OSHMA-të pati mirëkuptim dhe reagim të menjëhershëm për respektimin e udhëzimeve nga autoriteti shëndetësor për të respektuar masat dhe protokollet për distancën, përdorimin e maskave mbrojtëse apo dezinfektuesve në mjediset brenda dhe jashtë redaksive, si dhe për të kufizuar numrin e pjesëmarrësve brenda studiove të transmetimit apo regjistrimit.

Në 3 raste të identifikuara, që nuk u respektua kërkesa e autoriteteve shëndetësore, për numrin e të pranishmëve në studion televizive, AMA u ka tërhequr vëmendjen subjekteve përkatëse.

Për t'i ardhur në ndihmë tregut audioviziv, që, veçanërisht, u prek dhe u ndikua në veprimtarinë e tij drejtpërdrejt, fillimisht për shkak të fatkeqësisë natyrore (tërmetit) të datës 26 nëntor 2019, AMA duke mbajtur parasysh situatën e rëndë të krijuar, si dhe faktin që subjektet e autorizuar për të ofruar shërbim në qarkun Durrës ishin më të goditurat, edhe në aktivitetin e tyre të biznesit, mori vendimin nr. 13, datë 20.02.2020 “Për miratimin e pagesës me këste të detyrimeve financiare për vitin 2020, të subjekteve të autorizuar për përsëritjen e shërbimit programor në rrjet kabllor dhe IPTV, për të ofruar shërbim në qarkun Durrës”.

Me këtë vendim, AMA iu dha mundësinë subjekteve të autorizuar prej saj për ripërsëritës IPTV dhe për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor, të kryenin pagesat e detyrimeve financiare të vitit 2020, të ndara deri në 4 (katër) këste, duke e shtyrë afatin nga data 31 mars më datë 21 dhjetor 2020, pa aplikuar kamatëvonesë.

Më pas, me situatën e krijuar në muajt mars-prill 2020, prej pandemisë COVID-19, AMA vendosi të lehtësojë/mbështesë financiarisht OSHMA-të (subjektet e autorizuar/licencuara prej saj) duke marrë vendimin nr. 32, datë 04.05.2020 *“Për shtyrjen e afatit të aplikimit të kamatëvonesave mbi pagesat vjetore për licencë/autorizim për vitin 2020, deri në datën 30 qershor 2020”*, duke e shtyrë afatin e pagesave vjetore për autorizim dhe licenca nga data 31 mars më datë 30 qershor 2020, pa aplikuar kamatëvonesë. (pa cenuar subjektet e autorizuar të vendimit nr. 13, datë 20.02.2020).

Pasojat e COVID-19 u ndjenë edhe në procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive. Kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë, nevoja për shmangien e grumbullimit të njerëzve në pikat e shitjeve të dekoderave, si dhe faktorë të tjerë, çuan në shtyrjen e afateve të përcaktuara nga AMA përgjatë vitit 2020. Pavarësisht kësaj, u arrit të finalizohet me sukses procesi brenda 30 dhjetorit 2020.

Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive konsiderohet një ndër arritjet kryesore në fushën e medias, duke qenë se përfitimet nga ky proces i rëndësishëm janë të shumta dhe të prekshme për publikun shqiptar. Rritja e numrit të kanaleve televizive pa pagesë, rritja e cilësisë së shërbimit, rritja e ndërveprimit, gama e gjerë e shërbimeve të reja janë disa nga këto përfitime. Kjo arritje i adresohet, kryesisht, rregullatorit, i cili ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm, në ndjekjen e zbatimit të këtij procesi, duke garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive në këtë periudhë të vështirë tranzicioni, si dhe duke siguruar mbulim me sinjal numerik tokësor dhe cilësi transmetimi brenda standardeve ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2020, AMA, në mënyrë të vazhdueshme, ka koordinuar punën me operatorët audiovizivë në treg, ka kryer monitorime në terren, ka zhvilluar fushatën e informimit për qytetarët, u ka ardhur në ndihmë qytetarëve nëpërmjet strukturës Call Center, të ngritur prej saj, si dhe ka zhvilluar anketime nëpërmjet kësaj strukture, me qëllim identifikimin e pajisjes me dekodera të qytetarëve. Tashmë në çdo qark të vendit, qytetarët shqiptarë mund të shohim mbi 30 kanale televizive pa pagesë.

Teknologjia digjitale e transmetimeve tokësore është e vetmja teknologji që realizon një mbulim më të gjerë të territorit duke bërë të mundur që informacionet e dhëna në mënyrë të përsëritur mbi masat mbrojtëse ndaj pandemisë, gjatë vitit 2020, kanë ndihmuar qytetarët në parandalimin e përhapjes së kësaj pandemie duke shkuar në çdo “derë” të qytetarëve shqiptarë.

Sa i përket veprimtarisë administrative, pavarësisht situatës së pandemisë, AMA ka vijuar të ushtrojë kompetencat dhe funksionet që i ngarkon ligji organik, për çështjet brenda fushës së kompetencës, si shqyrtimi i aplikimeve edhe kërkesave për marrje licence/autorizimi, si dhënie mendimi, shqyrtim i kërkesave të ndryshme drejtuar autoritetit, vijim i procedimeve të ndryshme administrative.

Në muajin janar 2020, AMA miratoi rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, fusha e zbatimit të së cilës është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për dhënien e licencave lokale apo rajonale të shërbimit të programit audioviziv. Në zbatim të këtij akti, gjatë vitit 2020, AMA, për herë të parë prej hyrjes në fuqi të ligjit tonë organik, ka zhvilluar procedura dhe ka lëshuar licenca për ofrim shërbimi programi audiovizive me mbulim lokal apo rajonal.

Gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, AMA i ka zhvilluar mbledhjet e saj përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, në përputhje të plotë me parashikimet e Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID -19”.

Gjithashtu, në vijim të nismës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, njoftuar përmes shkresës së datës 4 prill 2020, administruar prej AMA-s me nr. 1035 prot, datë 06.04.2020, i është bashkuar kësaj nisme për dhënie kontributi financiar në kuadër të përballimit të nevojave për parandalimin e përhapjes së infeksionit shkaktuar nga COVID-19, nëpërmjet përgjysmimit të pagesë mujore të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të tij, për një periudhë tre mujore, duke filluar nga paga e muajit prill 2020.

Në vijim të organizimit të punës për të garantuar funksionimin, vijimësinë dhe kushtet e përshtatshme, për reduktimin e transmetimit të COVID-19, më 01.06.2020, AMA miratoi “Rregulloren për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Nëpërmjet kësaj rregulloreje u përcaktuan rregullat, procedurat standarde të punës në institucion, të harmonizuara e në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë për periudhën e pandemisë.

Monitorimet dhe shqyrtimet e tematizuara, të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara nga OSHMA-të, gjatë vitit 2020, u fokusuan në mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme; reklamat mbi pijet e gazuara dhe me sheqer të shtuar; respektimin e masave për mbrojtjen e personelit në redaksitë audiovizive nga COVID -19; programet dedikuar dinamikës së pandemisë dhe gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi. U identifikuan 10 raste që nuk kishin respektuar kërkesat e kuadrit ligjor dhe OSHMA-ve iu është tërhequr vëmendja. Bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e zbatimit të Kontratës së Shërbimit të Transmetuesit Publik, AMA, gjatë vitit 2020, realizoi dy shqyrtime dhe vlerësime për performancën e RTSH-së në ndërtimin e buketës programore në kanalet e veta, duke i dërguar gjetjet dhe përfundimet, në të dy rastet, menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të këtij institucioni.

Gjithashtu, AMA organizoi dy panele diskutimi virtual ku në fokus ishte mbrojtja e fëmijëve. Panelet me temë “Reklamat për fëmijë dhe me fëmijët” dhe “Fëmijët dhe shprehitë e edukimit mediatik” krijuan hapësira të shkëmbimit të pikëpamjeve dhe ideve nga përfaqësuesit e OSHMA-ve, ekspertëve të fushës dhe nga institucionet publike e shoqëria civile mbi kujdesin ndaj të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, si dhe përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në procesin e edukimit mediatik, përmes trajtimeve të kësaj çështjeje që në kurrikulat shkollore.



Edhe gjatë vitit 2020 vijoi praktika e organizimit të konferencave shkencore mbi dinamikën e tregut audioviziv në vendin tonë. Në partneritet me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës u zhvillua konferenca shkencore “Cilësia e lajmeve të transmetuesve televizivë shqiptarë”, ku u paraqit dhe një material voluminoz monitorimi dhe vlerësimi mbi produktin e edicioneve informative në OSHMA-të kombëtare e rajonale, gjykuar mbi treguesit e shpejtësisë dhe aktualizimit të lajmeve, gjeografinë e tyre, diversitetin, multimedialitetin, objektivitetin, gjinitë e raportimeve, kohëzgjatjen etj. Gjithashtu, fryt i partneritetit dhe sinergjisë së AMA-s me subjekte që punojnë në fushën e medias dhe komunikimit ishte dhe pasurimi i bibliotekës për redaksitë e OSHMA-ve, studentët e pedagogët e gazetarisë dhe të gjithë të interesuarit, me botimin në shqip të librit “Writing and Reporting News – A Coaching Method”, me autore Carole Rich. Më tej, gjatë vitit 2020, u realizua dhe Edicioni 6 i Buletinit Periodik të AMA-s, një set treguesish ekonomikë e financiarë, përmbajtësorë, teknikë dhe teknologjikë, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., për vitin 2019.

Në kuadër të planifikimit dhe administrimit të frekuencave, AMA kryen periodikisht monitorime të shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv. Monitorimet në terren janë intensifikuar gjatë vitit 2020, duke pasur parasysh edhe ndjekjen e zbatimit të përfundimit të procesit të digjitalizimit.

Sa i përket kontrolleve të ushtruara në terren ndaj subjekteve kablllore/ IPTV dhe OTT, për respektimin e të drejtës së transmetimit, ato kanë qenë në rënie për vitin 2020 në krahasim me vitet e mëparshme. Megjithatë, të gjitha ankesat e përcjella nga subjektet prodhuese të përmbajtjeve audiovizive, janë trajtuar me përgjegjësi nga ana jonë. Janë kryer të gjitha inspektimet përkatëse në terren dhe, aty ku ka pasur shkelje, janë marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

Në zbatim dhe të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2020, AMA ka lidhur 3 marrëveshje bashkëpunimi me institucione, aspektet e punës së të cilave lidhen me fushën e veprimtimit të Autoritetit, me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të koordinimit të punës.

Bashkëpunimi me rregullatorin e transmetimeve audio dhe audiovizive në Kosovë (Komisioni i Pavarur i Medias, KPM) u përqendrua, gjatë vitit 2020, tek krijimi i mundësive të realizimit të shkëmbimit të informacionit nga dy rregullatorët, për trajtimin dhe zgjidhjen më të shpejtë e profesionale të problematikave e ankesave, që adresojnë qytetarët dhe institucionet nga të dy vendet. Dy autoritetet homologe kanë instaluar, gjatë vitit 2020, link-et e tyre në faqet zyrtare të internetit të njëri-tjetrit, si një hap konkret për komunikimin virtual, por dhe promocionin publik të aktivitetit të tyre, në të dy shtetet.

Kalimi i transmetimeve nga analogu në digjital dhe aplikimet e reja teknologjike mbeten aspekte ku AMA dhe KPM kanë energji dhe hapësira për të intensifikuar më shumë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, bazuar dhe në praktikat e rregullatorëve në vendet e BE-së. Kuadri ligjor dhe nënligjor që ka zbatuar Shqipëria në procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, përbën një pikë reference për ekspertët juridikë nga AMA dhe KPM, për t’u përshtatur me rrethanat konkrete të vijimit të procesit në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2020, AMA ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA, REFRAM, etj. Përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2020, kanë marrë pjesë në rreth 38 konferenca, takime apo seminare, të zhvilluara kryesisht online, diktuar prej pandemisë COVID-19.

Edhe për vitin raportues, në politikën e vet të menaxhimit të burimeve njerëzore, AMA e ka vënë theksin te profesionalizmi, rezultatet dhe transparenca në shërbim, duke krijuar kështu bazat për një administratë dinamike në punën e përditshme, për realizimin e objektivave në vijimësi.

Pavarësisht situatës pandemike, edhe gjatë vitit 2020, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), krahas detyrave të përditshme funksionale, ka pasur në fokus përparësitë e vendosura nga Autoriteti, ndër të cilat, mbrojtja e fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive.

Gjatë vitit të kaluar, pranë AMA-s janë adresuar më shumë se 120 ankesa nga individë, organizata të ndryshme të shoqërisë civile, institucionet publike dhe jopublike etj. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë depozituar në AMA përmes rrugës/postës elektronike, sidomos pas muajit mars 2020, kur vendi iu nënshtrua masave të forta kufizuese, në përpjekje për të parandaluar përhapjen e COVID-19.

Në raport me vitet e kaluara, duke krahasuar ankesat që nga krijimi i Këshillit të Ankesave në prill të vitit 2016, rezulton se, gjatë vitit 2020, u adresuan më shumë ankesa. AMA vlerëson se numri në rritje i ankesave reflekton faktin që individët, organizatat e ndryshme të shoqërisë civile, institucionet publike dhe jopublike etj., kanë një “dritare” të hapur e të konsoliduar për të adresuar dhe trajtuar shqetësimet e tyre lidhur me përmbajtjet audiovizive. Nga ana tjetër, nënvizojmë edhe faktin e konstatimit të një përmirësimi të ndjeshëm në transmetimet audiovizive për fëmijët dhe rreth fëmijëve, e po aq edhe të një reagimi të shpejtë pozitiv nga OSHMA-të, në rastet kur subjekt i transmetimeve të tyre kanë qenë të miturit.

## 1. STRATEGJIA E AUTORITETIT

AMA, në fillim të vitit 2020, nisi punën për hartimin e Strategjisë së re të institucionit, për vitet 2020-2022.

Ndodhur përpara vështirësive dhe sfidave të pashembullta për sektorin audioviziv, të shkaktuara nga pandemia COVID-19, Autoriteti konsideroi të nevojshme zhvendosjen në kohë të zbatimit të Strategjisë së institucionit për vitet 2021-2023.

Hartimi i kësaj strategjie u parapri nga një analizë gjithëpërfshirëse e përparimit të bërë në këto vite, si dhe nga parapërgatitja për sfidat që na presin në të ardhmen. Vitet e fundit kanë shënuar hapa pozitivë në të gjitha drejtimet, por, padyshim, ka hapësira për përmirësime të mëtejshme. Angazhimi i AMA-s, në rregullimin e veprimtarisë së mediave audiovizive, vijon të mbetet ndër qëllimet kryesore.

Ndikimi dhe pasojat e pengesave dhe problematikave, që po shkakton pandemia, reflektohen dhe në dokumentin strategjik të veprimtarisë së AMA-s për periudhën 2021-2023.

Janë konceptuar, planifikuar dhe përshtatur veprimtari që, në fund të fundit, garantojnë ecje të qëndrueshme, në një kontekst të situatës së pazakontë, që po kalon vendi. Prandaj, që nga konsultimi publik, ne e kemi rishikuar planin tonë të veprimit, në kushtet e pandemisë COVID-19.

Strategjia dhe Plani i Veprimit të Autoritetit janë miratuar nga Këshilli i Autoritetit me Vendimin Nr. 94, datë 14.10.2020.

Plani i Veprimit të Autoritetit bazohet në statusin e përmbushjes së objektivave 2017-2019, si dhe përcakton objektivat strategjike për periudhën 2021-2023, duke marrë në konsideratë faktin se ka objektiva të cilat zgjaten në kohë, përderisa përkojnë me procese të vijueshme të punës së Autoritetit, për shkak të zhvillimeve të reja apo ndryshimeve a përmirësimeve të kuadrit ligjor.

Qëllimet strategjike të Autoritetit, të cilat do të mbulojnë periudhën tre vjeçare të Strategjisë, kanë disa objektiva strategjike specifike, të cilët kanë të bëjnë me:

1. Sigurimin dhe nxitjen e diversitetit dhe pluralizmit;
2. Përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit;
3. Qasjen proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme; dhe
4. Ngritjen e kapaciteteve dhe mirëqeverisjen.

## **2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2019**

- 1) Të tregojë kujdesin e nevojshëm për procesin e mbylljes së transmetimeve analoge në afatin e ri të vendosur nga AMA më 30 qershor 2020 për qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë, në mënyrë që qytetarët e këtyre qarqeve të jenë të parapërgatitur dhe të mirinformuar, si dhe të vijojë fushatën e informimit të qytetarëve në qarqet përkatëse deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, fushatë e cila duhet të përmbajë informacione sa më praktike, me gjuhë sa më të thjeshtë, ilustrime konkrete dhe imazhe për teknologjinë që duhet përdorur dhe duke theksuar se tregu i dekoderave DVB –T2 është treg i hapur dhe këta dekoderë mund të sigurohen në çdo pikë shitjeje të pajisjeve elektronike.**

Në zbatim të vendimit të AMA-s nr. 23, datë 26.03.2020, lidhur me mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë më datë 30 qershor 2020, u kryen një sërë veprimtarish, si vijon:

- U vendos korrespondencë e vazhdueshme me operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë, ku u kërkohej të merrnin masa për përmbushjen e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar (dërguar shkresat me nr. 1454/1455/1456/1457/1458/1459 prot, datë 09.06.2020, nr. 1465 prot, datë 10.06.2020);
- U ngrit grupi i monitorimit për të verifikuar situatën në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës së operatorëve privatë kombëtarë numerikë, si dhe nëse janë mbështetur operatorët lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare;
- U zhvillua fushata e informimit të publikut nëpërmjet spoteve publicitare.

Për vijimin e fushatës, AMA me vendimin nr. 40, datë 13.05.2020, bëri një ndryshim/rialokim fondesh të vendimit nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, të ndryshuar. Bazuar në VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike” u krye fushatë përmes transmetimit të spoteve në televizionet dhe radiot kombëtare dhe ato vendore (qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë) për një periudhë 35 ditore, 26 maj – 29 qershor 2020. Spotet publicitare mbi procesin e digjitalizimit janë publikuar edhe në faqen zyrtare të AMA-s [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al), si dhe në rrjetin social *facebook*.

Në përgjigje të shkresave tona, drejtuar operatorëve kombëtarë, shoqëria “TV Klan” sh.a me shkresën nr. 1471 prot, datë 11.06.2020 ka theksuar se mbyllja e transmetimeve analoge në katër qarqe është e përshpejtuar dhe e pamundur, pasi nuk është shtruar infrastruktura digjitale nga të gjithë operatorët privatë kombëtarë numerikë. Gjithashtu, nga monitorimet e kryera, në të katër këto qarqe, rezultonte se ende nuk kishte përfunduar plotësisht infrastruktura numerike nga operatorët privatë kombëtarë.

Problematicë tjetër e konstatuar nga monitorimet ishte se, në të katër këto qarqe, operatorët lokalë/rajonale nuk kishin mbështetur programin e tyre në rrjetin e RTSH-së apo në ndonjë rrjet tjetër privat kombëtar numerik.

Në adresë të AMA-s u paraqitën edhe ankesa nga qytetarët, lidhur me grumbullime njerëzish pranë zyrave postare apo pikave të ndryshme të shitjeve për të blerë dekoderat. Ata kërkonin shtyrjen e fikjes së sinjalit analog, deri në një periudhë më të përshtatshme.

Në përfundim, duke konsideruar situatën e krijuar nga COVID-19, faktin që subjektet nuk kishin shtruar plotësisht infrastrukturën numerike, me qëllim që të parandaloheshin grumbullimet e qytetarëve që stimulonin përhapjen e infeksionit COVID-19; si dhe duke konsideruar që subjektet televizive kanë një rol të rëndësishëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës, për marrjen e masave kundër përhapjes së infeksionit, Këshilli i AMA-s, me vendimin nr. 51, datë 29.06.2020, vendosi shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge, në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan, deri më 30 shtator 2020.

Gjatë periudhës 30 qershor-30 shtator 2020, AMA intensifikoi aktivitetet e veta, koordinimin me operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë të katër qarqeve, monitorimin në terren, si dhe vijoi fushatën e informimit të publikut, përmes transmetimit të spoteve, në televizionet dhe radiot kombëtare dhe ato vendore, të qarqeve Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë.

Përkatësisht, më datë 15 shtator 2020, u zhvillua takimi me operatorët lokalë të qarqeve Shkodër dhe Lezhë, me datë 17 shtator 2020 me operatorët lokalë të qarkut të Elbasanit, si dhe me datë 22 shtator 2020 me operatorët e qarkut Vlorë. Gjatë këtyre takimeve u diskutua mbi zbatimin e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge, si dhe u informuan operatorët lidhur me mënyrën e kompensimit financiar për 6.46 mujorin e parë të mbartjes së tyre në një nga rrjetet kombëtare, bazuar në ligjin nr.34/2017.

Gjithashtu, iu është dërguar shkresa me nr. 2577 prot, datë 14.09.2020, të gjithë subjekteve kryesore tregtare të shitjes së dekoderave DVB-T2 të vendit, ku iu është kërkuar që të marrin masat e duhura për pajisjen me dekodera të pikave të shitjes në qarqet ku digjitalizimi do të përfundonte më datë 30 shtator 2020.

Me qëllim identifikimin e pajisjes së popullsisë së qarqeve Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë me dekodera, AMA ka kryer një sondazh nëpërmjet qendrës Call Center, duke kryer telefonata drejt numrave fiks, në këto qarqe. Sondazhi ka filluar me 1 shtator dhe janë kryer gjithsej rreth 900 telefonata (300 në Elbasan, 200 në Lezhë, 200 në Shkodër, 200 në Vlorë). Nga telefonatat e kryera rezultoi se qytetarët ishin të informuar mbi procesin e digjitalizimit dhe pjesa më e madhe e tyre ishin të pajisur me dekodera.

Lidhur me fushatën e informimit të publikut, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit për vijimin e fushatës së informimit të qytetarëve në katër qarqet, deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, si dhe në zbatim të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike, AMA, me vendimin nr. 54, datë 05.08.2020, bëri një ndryshim/rialokim fondesh të vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, të ndryshuar, me qëllim vijimin e fushatës për një periudhë 35 ditore, 26 gusht – 29 shtator 2020. Spotet publicitare mbi procesin e digjitalizimit janë publikuar edhe në faqen zyrtare të AMA-s [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) si dhe rrjetin social facebook.

Si rezultat i aktiviteteve të kryera nga AMA, u bë e mundur që, më datë 30 shtator 2020, të mbylleen transmetimet analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan, duke çuar në nëntë numrin e qarqeve ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit. Procesi vijoi i qetë dhe nuk pati problematika.

Mbyllja e transmetimeve analoge në qarqet e sipërcituara u ndoq në terren nga AMA, me qëllim verifikimin e situatës dhe shmangien e problematikave të mundshme. Nga verifikimet e kryera rezultoi se të gjithë operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë, të këtyre qarqeve, fikën në kohë transmetimet analoge. Gjithashtu, u kontrolluan edhe pika të ndryshme të shitjeve të dekodereve për të verifikuar nëse kishte radhë të qytetarëve apo mungesë dekoderash në treg dhe u konstatua se situata ishte e qetë dhe të gjitha pikat e shitjeve kryesore kishin në gjendje dekodera.

AMA, gjatë vitit 2020, ka vijuar me kompensimin financiar për operatorët ekzistues analogë lokalë/rajonale që janë mbështetur në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara sipas ligjit për median audiovizive, për allotmentet Berat, Korçë, Fier; Tiranë (qarqet Tiranë-Durrës), Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë, që kanë plotësuar kërkesat e parashikuara ligjore, deri në masën 53,87% të pagesave të kryera për 1 vit.

***2) Të vijojë bashkëpunimin me operatorët audiovizivë në treg, si dhe institucionet përkatëse për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet e mbetura të vendit, duke mbajtur në mënyrë të vazhdueshme të informuar Kuvendin e Shqipërisë për afatet, masat e marra dhe ecurinë e këtij procesi të rëndësishëm, deri në përfundim të tij.***

Në kuadër të finalizimit të procesit të digjitalizimit, AMA, menjëherë pas mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë më 30 shtator 2020, vijoi me mbylljen e transmetimeve analoge në tre qarqet e mbetura Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë.

Në këtë kuadër AMA vijoi me aktivitetet si më poshtë:

- Koordinimin/bashkëpunimin me operatorët privatë kombëtarë numerikë në kuadër të shtrimit të plotë të infrastrukturës në këto tre qarqe.
- Koordinimin me operatorët lokalë/rajonale, që ofrojnë shërbim në këto qarqe, me qëllim mbështetjen e programit të tyre në njërën nga rrjetet kombëtare.
- Vijimin e fushatës së informimit në qarqet Kukës, Dibër, Gjirokastrë.
- Monitorimin e vazhdueshëm në terren për verifikimin e mbulimit me sinjal numerik të këtyre qarqeve.
- Fushatën e informimit të publikut për një periudhë 35 ditore.

AMA, me shkresat nr.3458 prot. dhe nr.3460 prot., datë 03.12.2020, ka njoftuar zyrtarisht operatorët audiovizivë të pajisur me licencë kombëtare dhe lokale të qarqeve Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë lidhur me afatin e mbylljes së transmetimeve analoge në këto qarqe, si dhe u ka kërkuar të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij afati. AMA, në një shkresë të dytë rikujtese, me nr.3592 prot. dhe 3597 prot., datë 17.12.2020, u ka kërkuar sërish operatorëve kombëtarë të marrin masa për mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonale të këtyre qarqeve në rrjetet e tyre si dhe u ka kujtuar operatorëve lokalë/rajonale mbi detyrimin për të depozituar pranë AMA-s kontratën e lidhur me një nga operatorët kombëtarë numerikë.

Në këtë mënyrë, do të sigurohet vijimësia e transmetimeve televizive në këto katër qarqe nga të gjithë operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë që transmetojnë aktualisht në analog. Përveç shkresave të dërguara në mënyrë zyrtare, AMA ka kryer dhe takime të veçanta me operatorët lokalë të këtyre qarqeve, duke iu shpjeguar në detaje procesin e mbartjes nga transmetimet analoge në ato digjitale, si dhe mënyrën e kompensimit financiar nga AMA në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirim të frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar, dhe vendimit të AMA-s nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e listës së subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfitojnë nga kompensimi financiar”. Subjektet janë informuar se do të kompensohen deri tani për 6.46 muaj, dhe kjo vetëm pasi të përmbushin detyrimet ligjore. Gjithashtu, AMA ka vijuar monitorimin në terren për të verifikuar mbulimin me sinjal numerik të këtyre qarqeve, si dhe kalimin e operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare.

Lidhur me fushatën e informimit të publikut, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit për vijimin e fushatës së informimit të qytetarëve deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, në zbatim të vendimit të Këshillit të AMA-s nr. 82, datë 08.10.2020 për mbylljen e transmetimeve analoge në tre qarqet Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës më datë 30 dhjetor 2020, Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike, si dhe në zbatim të vendimit nr. 83, datë 08.10.2020 “Për një ndryshim në vendimin e AMA-s, nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit të AMA-s për vitin 2020”, të ndryshuar, AMA kreu fushatën e informimit të publikut për një periudhë 35 ditore (25 nëntor – 29 dhjetor 2020) përmes transmetimit të spoteve publicitare në televizione dhe radio kombëtare dhe lokale. Gjithashtu, fushata vijoi edhe përmes faqes zyrtare të AMA-s [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) si dhe rrjetit social facebook.

Me qëllim identifikimin e nevojave të qytetarëve, në këto tre qarqe, për t’u pajisur me dekodera të tipit DVB-T2, si dhe për t’u njohur mbi ndikimin që ka pasur fushata e informimit të publikut të zhvilluar nga AMA sa i takon procesit të digjitalizimit, prej dy muajsh u zhvillua një sondazh nëpërmjet strukturës sonë Call Center, duke telefonuar qytetarët e qarqeve Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë dhe duke i pyetur ata mbi procesin e digjitalizimit, mbi teknologjitë që përdorin për të aksesuar transmetimet audiovizive, si dhe nëse janë pajisur apo jo me dekodera.

Janë kryer 300 telefonata në Gjirokastrë, 199 telefonata në Dibër dhe 226 telefonata në Kukës. Nga sondazhi i kryer rezultoi se teknologjia më e përdorur në këto qarqe është IPTV dhe Kablllore (Gjirokastrë 65% e të anketuarve; Dibër 68% e të anketuarve dhe Kukës 75% e të anketuarve).

AMA ka mbajtur të informuar Kuvendin e Shqipërisë mbi afatet, masat e marra dhe ecurinë e këtij procesi të rëndësishëm. Konkretisht pas vendimit të Këshillit të AMA-s nr. 82, datë 08.10.2020 për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë, me shkresën nr. 2864 prot., datë 12.10.2020 kemi bërë me dije Kuvendin e Shqipërisë.

Si rezultat i aktiviteteve të kryera nga AMA, u bë e mundur që më datë 30 dhjetor 2020 të mbyllet transmetimet analoge edhe në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë, duke shënuar kështu edhe finalizimin me sukses të procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë.

- 3) Duke pasur parasysh realitetin e ri kur mediat, bazuar në internet, kanë një zhvillim të pandalur dhe efekt të jashtëzakonshëm në industrinë mediatike, Kuvendi i Shqipërisë nxit AMA-n që të jetë proaktive në krijimin e një kuadri rregullator për mediat online, si dhe vlerësimin e akteve normative për median, nëse ato mund të gjejnë zbatim, edhe për mediat online.**

Sikurse është raportuar në raportin vjetor të AMA-s për vitin 2019, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ndërmarrë iniciativa ligjore, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, objekt i të cilit është përfshirja e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike në fushën e zbatimit të ligjit tonë organik.

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse dhe vepron në bazë e për zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe legjislationit në fuqi. Aktualisht, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar“ është në fazë rishikimi dhe AMA, në cilësinë e zbatuesit të këtij ligji dhe ndryshimeve të tij eventuale, do të ndjekë fazat e shqyrtimit të tij, me qëllim marrjen e masave administrative të mëtejshme, për të mundësuar zbatimin e plotë të tij.

Ndërkohë, AMA gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë aktive në forumet e organizuara prej organizatës ndërkombëtare OSBE, si dhe Ambasadës hungareze në Shqipëri, në bashkëpunim me BIRN-in.

Në këto takime janë diskutuar dhe tema lidhur me ndryshimet në ligjin për mediat dhe adresimi i opinionit të Komisionit të Venecias mbi këtë projektligj, siguria e gazetarëve dhe liria e medias gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19, shkelja e të drejtave digjitale, impakti i tyre mbi lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, e drejta e informimit gjatë pandemisë së COVID-19, vetërregullimi i medias në epokën e pandemisë etj.

- 4) Të luajë një rol proaktiv në bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët përkatës, duke bërë të mundur që, nga njëra anë, të bëhen përmirësimet e nevojshme ligjore në favor të marrëdhënieve më të mira të punës së gazetarëve dhe, nga ana tjetër, të nxitet një proces vetërregullimi. Të dyja këto procese së bashku çojnë në arritjen e rezultateve konkrete për mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë, shqetësim i cili theksohet në mënyrë të veçantë edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare (rekomandime të BE-së, raporti Freedom House 2019, Reporters Without Borders etj.), si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.**

AMA, në zbatim të këtij rekomandimi, inicioi tryezën e takimit në nivel teknik mes përfaqësuesve të shoqatave të gazetarëve dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në këtë tryezë ishin të ftuar përfaqësues të shoqatave të gazetarëve, departamentet e Gazetarisë në Universitetin publik dhe Universiteteve private.



AMA përcolli ftesë tek të gjitha shoqatat e gazetarëve, por duhet të theksojmë se, edhe për shkak të situatës së pandemisë, pjesëmarrja nuk ishte në nivele të kënaqshme.

Pjesëmarrësit vlerësuan se ka përmirësime në tregun e medias, por gjithashtu ka ende disa çështje të cilat kanë nevojë për adresim. Të pranishmit diskutuan mbi problematikat aktuale në tregun e medias, si: çështja e pagave minimale të deklaruara, kushtet e punës për të gjithë punonjësit e mediave, marrëveshjet e interesit që kanë përparësi mbi marrëdhëniet në punë, të cilat sjellin më pas dhe konflikte, punonjësit e përkohshëm si dhe praktikantët e studentëve.

Nga ana e ISHPSHSH u bë e ditur se ka nevojë për më shumë indicie nga ana e shoqatave apo edhe e gazetarëve. Sipas tyre, në vitin 2019, në drejtim të Inspektoratit, kanë mbërritur vetëm 4 ankesa, çka janë shumë krahasuar me vitet e shkuara, por janë ende pak, po të kemi parasysh problemet e medias në tërësi.

Diskutimi u përqendrua tek nevoja për gjetjen e një mekanizmi i cili ndërthur institucionet shtetërore, median dhe përfaqësuesit e gazetarëve (shoqatat). U evidentua mungesa e një sindikate të mirëfilltë që përfaqëson dhe mbron interesat e gazetarëve.

Nga të pranishmit u kërkuar prej AMA-s dhe ISHPSHSH ndërtimi i një mekanizmi nxitës për të hartuar dhe nënshkruar një kontratë kolektive. Sipas të pranishmëve, kjo kontratë do t'i shërbente të gjitha palëve si një platformë e mirë për të përcjellë shqetësimet duke shmangur iniciativat tërësisht personale.

Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar mes AMA-s dhe ISHPSHSH, të dy institucionet janë angazhuar në shkëmbimin e informacionit dhe gjetjen e mekanizmave nxitës për të kontribuar sa më shumë në zgjidhjen e kësaj problematike të hasur në tregun mediatik shqiptar.

Në vijim të angazhimit të AMA-s për të nxitur përmirësimin e marrëdhënieve të punës së gazetarëve të sektorit audio dhe audioviziv, si dhe në favor të procesit të vetërregullimit, në muajin nëntor 2020 u shpall, në faqen zyrtare web, një Thirrje për projekte, mes të cilave përfshihej dhe projekti me temë: “Marrëdhëniet e punës së gazetarëve audiovizivë dhe prezantim i modeleve bashkëkohore”, i cili konsistonte në realizimin e një studimi tregu mbi marrëdhëniet e punës në subjektet audio dhe audiovizive; duke përfshire problematikat kryesore në aplikimin e kontratave të punës, pagesat, propozime për nxitjen e procesit vetërregullues në ndërtimin e marrëdhënieve të standardizuara kontraktuale, propozime për modele kontratash pune, bazuar dhe në eksperiencat e vendeve të BE-së etj.

Për Thirrjen u identifikuan dy subjekte aplikuese që paraqitën propozime për këtë projekt, të cilat nuk ishin të suksesshme (nuk plotësuan kriteret e kërkuara).

- 5) *Për çështje dhe problematika të pazgjidhura, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit, si dhe për problematika dhe rekomandime të tjera, që kanë lidhje me fushën e mediave audiovizive, krahas vijimit të komunikimit me institucionet qeveritare përkatëse, AMA të mbajë të informuar dhe të bashkëpunojë me komisionin përgjegjës në Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim zgjidhjen e tyre.***

Në zbatim të Rekomandimit të mësipërm, AMA, me shkesën nr. 2590 prot., datë 15.09.2020, ka përcjellë, pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, informacionin mbi ankesat drejtuar AMA-s, që prekin të drejtat e konsumatorit dhe për të cilat pritet vendimarrje.

AMA ka nënshkruar, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, marrëveshjen e bashkëpunimit për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të konsumatorëve në fushën e mediave audiovizive, gjatë praktikave tregtare të ofrimit të shërbimeve nga operatorët. Në zbatim të detyrimeve ligjore dhe parashikimeve të marrëveshjes, AMA, rast pas rasti, ka përcjellë për kompetencë, pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, ankesa për çështje që bien brenda fushës së kompetencës së këtij organi. Një nga çështjet e përcjella për zgjidhje këtij organi, lidhet me ankesat për mungesën e sinjalit të televizionit kombëtar “TV Klan” dhe “TV Klan Plus”, në platformën private satelitore “Digit-Alb”, çështje e iniciuar që në muajin gusht 2019.

Duke qenë se pavarësisht korrespondencës së përsëritur shkresore të AMA-s, dhe kalimit të afateve për trajtimin e ankesave (KMK ka kthyer përgjigje duke mos e adresuar çështjen por duke rikërkuar nga ana jonë informacion dhe të dhëna shtesë në muajin dhjetor 2019), AMA mori në shqyrtim kontratën që shoqëria “Digit-Alb” sh.a., lidh me abonentët/pajtimtarët.

Nga shqyrtimi i kontratës së lidhur me abonentët/pajtimtarët, ka rezultuar se në termat kontraktorë parashikohet se “Digit-Alb” mund të ndryshojë përmbajtjen e programeve të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës së abonimit, sipas politikave dhe programacionit që vendos ky i fundit. Kontrata e depozituar nga shoqëria “Digit-Alb” sh.a., iu përcoll Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ndërkohë, në vijim të kërkesave tona, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit ka përcjellë pranë AMA-s, shkresat, administruar në AMA me nr. 2760 prot., datë 02.10.2020 dhe nr. 3285 prot., datë 18.11.2020. Përmes këtyre shkresave, KMK, në kuadër të shqyrtimit administrativ të çështjes mbi të drejtat e konsumatorit, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion nga shoqëria “Digit-Alb” sh.a. mbi ndryshimin e kushteve të kontratës së pajtimit me abonentët.

Procedimi administrativ është në zhvillim e sipër dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar për këtë ankesë.

- 6) Nxiti AMA-n në organizimin e aktiviteteve dhe krijimin e hapësirave të dobishme për të diskutuar me të gjitha grupet e interesit për aspekte të mbulimit në reklamat audiovizive të problematikave që lidhen me fëmijët; në të njëjtën kohë kërkon nga AMA që të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për propozime që lidhen me përmirësime në kuadrin rregullator në këtë fushë.**

Në vijim të komunikimit ndërinstitucional AMA-RTSH, në muajin shkurt 2020, ka pasur një kërkesë zyrtare nga RTSH-ja (nr. 388, datë 05.02.2020), ku u prezantua propozimi nga transmetuesi publik për të hequr kanalën RTSH FËMIJË 2 dhe për ta zëvendësuar në platformë me RTSH PLUS. AMA, në përgjigjen që ka dërguar zyrtarisht për RTSH-në, është shprehur, mes të tjerave, se ka qenë dhe mbetet e qartë mbi propozimin e përsëritur nga RTSH-ja, duke vlerësuar maksimalisht prezencën e dy kanaleve për fëmijë në buketën e RTSH-së. Për AMA-n kjo do të jetë realisht një hapësirë pozitive dhe tejet e dobishme për përmbushjen e angazhimeve të transmetuesit publik në zbatim të Kontratës së Shërbimit, dokument i konceptuar, hartuar dhe miratuar nga vetë RTSH-ja dhe i miratuar më pas nga Autoriteti në vitin 2017.

Në vijim të përgjigjes, AMA nënvizoi se mbetet në qëndrimin e zbatimit të Kontratës, duke menduar se dy kanalet, RTSH FËMIJË 1 dhe RTSH FËMIJË 2 janë garanci bazike dhe e domosdoshme për segmentimin moshor të tyre, duke adresuar përmbajtje që plotësojnë kushtet e zhvillimit psikosocial të ndjekësve, në favor të informimit, edukimit dhe argëtimit të tyre sipas standardeve mediatike profesionale, me programe cilësore dhe të shumëllojshme.

Argumentimi nga RTSH-ja për kushtueshmëri të hapjes dhe mbajtjes së një kanali të ri për fëmijë, apo zhvendosje të programeve në një kanal tjetër, nuk përbën shkak për AMA-n për të eliminuar RTSH FËMIJË 2 nga buketat programore. Çdo kanal i ri kërkon buxhet, energji njerëzore, kreative, aftësi blerëse të të drejtave etj., por modalitetet menaxheriale dhe organizative nuk mund të asgjësojnë një hapësirë të dedikuar për fëmijët, që mbetet prioritet, sidomos për transmetuesit publikë audiovizivë. Në përgjigjen e AMA-s theksohej, gjithashtu, se RTSH-ja mund të modifikojë, përmirësojë apo rikualifikojë përbërjen e buketës programore, duke propozuar ndryshime, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por jo duke shkurtuar pjesën e transmetimeve për fëmijët. AMA ka pritur dhe pret nga RTSH-ja propozime për zgjerim të numrit të kanaleve për fëmijët, siç është praktika dhe standardi i transmetuesve publikë në shumë vende evropiane dhe jo vetëm.

Pas këtij komunikimi, transmetuesi publik, nisur dhe rrethanat e krijuara nga efektet e pandemisë në sistemin arsimor të vendit tonë, ka paraqitur në AMA kërkesën për kanalën RTSH SHKOLLË, lindur si nevojë e ngutshme dhe e detyrueshme e aplikimit të formateve të mësimdhënies në distancë, për sistemin parauniversitar, për shkak të kufizimeve dhe ndërprerjeve të zhvillimit të kurrikulave në klasa dhe mjedise të tjera të shkollave, nga COVID – 19. RTSH SHKOLLË për vetë natyrën e përmbajtjes së programeve të transmetuara, si dhe grup-moshës që i drejtohet, ka atributet e një kanali të dytë për fëmijët, siç dhe me të drejtë u argumentua nga drejtuesit e RTSH-së. Ky kanal tashmë është pjesë e buketës programore, bazuar dhe në shtesën që iu bë Kontratës së Shërbimit.

AMA, në procesin e monitorimit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të, bazuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka realizuar dy monitorime (një në muajin shkurt 2020 dhe tjetri në muajin korrik 2020) me fokus zbatimin e kërkesave të legjislacionit për reklamimin e pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

Monitorimet kishin objektiv respektimin e kërkesave të ligjit nr. 74/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006, “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, i ndryshuar, konkretisht bazuar tek neni 9, sipas të cilit: “ndalohej transmetimi i publicitetit për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi” si dhe “ndalohej prodhimi dhe transmetimi i publicitetit që përmban skena me të mitur, të cilët konsumojnë pije alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.

Në të dy monitorimet, si në OSHMA-të kombëtare ashtu dhe ato lokale / rajonale, që u vizionuan, nuk u identifikuan shkelje në këto aspekte. Pavarësisht kësaj, AMA do të vijojë monitorime të tilla për të ndjekur përputhshmërinë me kërkesat e ligjit të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të

Në vijim, gjatë monitorimit, të kryer në muajin shtator 2020, të transmetimeve nga OSHMA-të, bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013 “Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA, ka identifikuar se në disa kanale të formatit muzikor kishte shkelje të ligjit dhe Kodit të Transmetimit. Konkretisht në programet muzikore të tyre janë transmetuar dhe përmbajtje të papërshtatshme dhe joetike, kryesisht me raste të teksteve apo pamjeve që nxisin dhunën ose përdorimin e alkoolit, lëndëve narkotike etj.

AMA u ka dërguar shkresë zyrtare subjekteve BBF, Melodi TV, Supersonic dhe My Music, ku i ka tërhequr vëmendjen për të shmangur emetimin e përmbajtjeve problematike në ato orare kur mendohet se para ekranit janë fëmijët, në zbatim të kërkesave të ligjit 97/2013 të ndryshuar, si dhe Kodit të Transmetimit, duke respektuar në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e fëmijëve.

Veprimtaria e transmetimeve audiovizive, sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar, neni 4, pika 1, germa b, respekton “në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”, ndërkohë që neni 33 pika 1, germa d, përcakton se “ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv, duhet të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik...”. Këto kërkesa të ligjit janë specifikuar edhe në Kodin e Transmetimit të AMA-s, në nenet e seksionit 5, dedikuar fëmijëve.

Më datë 06 tetor 2020, AMA organizoi panelin virtual të diskutimit me temë “*Reklamat për fëmijë dhe me fëmijët*”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të OSHMA-ve kombëtare dhe lokale, institucione publike dhe organizata jofitimprurëse që fokusohen dhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ekspertë të medias e komunikimit etj. Gjatë diskutimit u përmendën referenca të kuadrit ligjor në fuqi, si ligji 97/2013, për transmetimet audiovizive, i ndryshuar, Kodi i Transmetimit të AMA-s, rregullorja e reklamave, apo dhe ligji për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit.

Të pranishmit ngritën si problematikë promocionin për aktivitetin online të fëmijëve, mbi pajisje të ndryshme elektronike që i bëjnë ata të varur nga përdorimi i internetit. Gjithashtu dhe evitimi i reklamave audiovizive, ku përfshihen fëmijët në reklamat e produkteve të ndryshme ushqimore, u përmend si domosdoshmëri nga diskutantët.

Në panel pati propozime nga përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që, nga OSHMA-të, në mënyrë të veçantë nga RTSH-ja, duhet të ketë transmetim të reklamave pa pagesë, me përmbajtje mesazhesh në favor të respektimit të të drejtave të fëmijëve. Në këtë aspekt u nënvizua nga përfaqësuesit e AMA-s, fakti se ligji 97/2013 i ka të përcaktuara rrethanat se kur OSHMA-të transmetojnë informacione pa pagesë dhe propozimi që bëhet nga OJF-të duhet të garantojë ndryshime dhe amendime të ligjit ekzistues. Një propozim tjetër ishte dhe për ndalimin e përdorimit të imazhit të fëmijëve në transmetimet audiovizive në funksion të fushatave elektorale.

Paneli ka përsëritur nevojën e bashkëpunimit mes aktorëve të angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke sinjalizuar dhe trajtuar me profesionalizëm raste të përmbajtjeve të papërshtatshme audiovizive që dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të tyre.

Më datë 17 dhjetor 2020, AMA organizoi tryezën e diskutimit virtual me temë “*Fëmijët dhe shprehitë e edukimit mediatik*”, në vijim të aktiviteteve që AMA realizon me fokus mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në transmetimet audio dhe audiovizive.

AMA e ka përfshirë angazhimin në fushën e edukimit mediatik dhe në Strategjinë e Veprimit të institucionit në periudhën 2021-2023, aspekt që u vlerësua nga pjesëmarrësit. Të pranishëm në tryezë ishin zyrtarë dhe ekspertë nga institucionet dhe agjencitë publike të arsimit, nga Universiteti i Tiranës, subjekte të shoqërisë civile apo kërkues të fushës, të cilët trajtuan problematika që lidhen me përfshirjen e edukimit mediatik në kurrikulat e nxënësve dhe studentëve, për kombinimin e njohurive teorike me aftësimin teknologjik, për nevojën e iniciativave vetërregulluese të redaksive gazetareske për të evituar lajmet e pavërteta dhe ato të shtrembëruara etj.

Diskutantët theksuan se edukimin mediatik duhet ta vendosim në fokus jo vetëm me fëmijët por edhe me vetë median. Në media transmetohen më së shumti kronika për fëmijët problematikë dhe shumë pak kronika pozitive për këtë kategori, gjë që sjell demotivim tek brezi i ri.

U përmend dhe rasti i platformave rinore ku të rinjtë gjejnë gjithmonë më shumë veten, komunikojnë me njëri-tjetrin, për të mos rënë pre e bullizmit në mediat sociale.

Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe nga Sektori i Zhvillimit të Kurrikulës në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar, përmendën dhe faktin se në trajnimet e mësuesve do të futet edhe moduli i edukimit mediatik, i huazuar nga manuali i UNESCO-s. Impakti i pritshëm është se nxënësi i edukuar mediatikisht, gjithashtu, do të kërkojë cilësi nga media.

- 7) Duke pasur parasysh rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale, që janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi, edhe pas kalimit në transmetimet numerike, AMA, për zgjidhjen e problematikave, krahas vazhdimit të komunikimit me institucionet përkatëse, të mbajë të informuar dhe të bashkëpunojë me komisionin përgjegjës në Kuvendin e Shqipërisë.**

Në përmbushje të këtij rekomandimi, në datën 16 shtator 2020, në mjediset e AMA-s, u zhvillua një takim me përfaqësues të disa subjekteve televizive analoge lokale dhe rajonale si dhe shoqatës së Rrjetit të Televizioneve Lokale dhe Kabllore (RRTL), me qëllim identifikimin e problematikave me të cilat hasen këta operatorë në tregun audioviziv, si dhe për të vlerësuar impaktin e procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive të këta operatorë.

Disa nga çështjet kryesore dhe shqetësimet e ngritura prej tyre janë evidentuar më poshtë:

#### Çështja e tarifave të mbështetjes në rrjetin e RTSH-së

Përfaqësuesit e RRTL-së ngritën pretendimin se tarifat e miratuara janë të pabazuara në kostot reale të RTSH-së dhe kërkuar heqjen totale të tyre, duke argumentuar se aktualisht kostot për funksionimin e tyre në teknologjinë analoge janë rreth 350-400 euro, ndërsa tarifat e RTSH-së janë tepër të larta.

Subjekteve iu bë me dije se AMA ka kërkuar rishikimin e tyre nga RTSH-ja dhe kjo e fundit, në mënyrë shkresore, ka bërë me dije që procesi i rishikimit të tarifave do të kryhet pas përfundimit të transmetimeve analoge në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, rishikim i cili do të bazohet në kostot reale të vënies në funksionim të rrjetit të RTSH-së.

Po ashtu, subjektet u informuan se, në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirim të frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar, dhe vendimit të AMA-s, nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e listës së subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonalë që përfitojnë nga kompensimi financiar”, nëse do të ofrojnë shërbimin e tyre mbështetur në teknologjinë numerike do të përfitojnë kompensim financiar për mbulimin e tarifës së mbështetjes së operatorëve ekzistues analogë lokalë/rajonalë në rrjet numerik, për një periudhë 6.46 mujore, por, për ta përfituar kompensimin, duhet të mbështeten në rrjet numerik.

Edhe për këtë proces, subjektet ngritën si shqetësim ekzistencën e pengesave administrative, pasi fillimisht duhet të paguajnë te RTSH dhe më tej të kompensohen nga AMA, ndërkohë që mund të ketë rrugë më të thjeshta, sipas tyre. Gjithashtu, edhe periudha 6.46 mujore e kompensimit është e pamjaftueshme dhe nuk ndihmon dhe mbështet realisht këtë kategori subjektësh, së cilës, për shkak të kalimit në numerik, i shtohen së tepërmi kostot financiare, duke e bërë praktikisht të pamundur vijimin e aktivitetit audioviziv të tyre në zonat përkatëse.

Edhe për këtë problem, subjekteve iu bë me dije se procedura e kompensimit dhe vlera e kompensimit janë paracaktuar në ligjin nr. 34/2017.

### Reklama shtetërore

Përfaqësuesit e RRTL-së parashtruan se si operatorë vendorë nuk kanë transmetuar asnjë reklamë shtetërore, pasi këto të fundit transmetohen vetëm prej një kategorie subjektesh.

Shoqatës iu bë me dije se ligji nr. 97/2013 i ndryshuar, nuk parashikon rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të reklamave shtetërore. Kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore realizohet nga secili institucion publik.

Procesi i prokurimit mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin, e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe RRTL ka të drejtë të paraqesë propozime konkrete për ndryshime në këtë akt nënligjor.

Nisur nga sa më sipër, AMA i parashtron Kuvendit mundësinë për rishikimin e bazës ligjore në fuqi lidhur me reklamën shtetërore, me synimin që të gjitha subjektet audiovizive të jenë të përfshira në përfitimet nga këto reklama.

### Standardi i transmetimit i ofruar nga RTSH

Subjektet kërkuar rishikimin e kapaciteteve mbartëse të RTSH-se, duke iu dhënë mundësinë këtyre të fundit që transmetimet e tyre të mos jenë vetëm në standardin SD (Standard Definition), por të kenë mundësi transmetimi dhe në standardin HD (High Definition).

Subjektet u informuan se sipas Strategjisë së kalimit në transmetime numerike, në fazën e parë (mbyllja e transmetimeve analoge), për të siguruar mbështetjen e të gjithë programeve analoge ekzistuese në rrjetin e RTSH-së, standardi i transmetimit do të jetë SD (Standard Definition).

### Kërkesa për pajisjen me frekuencë lokale të televizioneve lokale për secilin allotment

Kërkesa e mësipërme është kërkesë e përsëritur dhe subjekteve iu risoll në vëmendje se, referuar planit aktual të frekuencave, për transmetimet numerike, rezulton se frekuencat për ndërtimin e rrjeteve lokale i përkasin brezit të frekuencave DD2, frekuenca, të cilat, referuar vendimeve të organizimave evropianë, do të kalojnë për përdorim në teknologjinë mobile dhe nuk do të përdoren për transmetime audiovizive. Në këto kushte, alternativa e tyre për kalim në transmetim numerik aktualisht mbetet vetëm mbështetja në rrjetet numerike të operatorit publik ose operatorëve privatë.

Subjektet u informuan se, në planifikimim e brezit të frekuencave audiovizive, në kuadër të procesit të lirimimit të brezit DD2, AMA do të mbajë në konsideratë edhe kërkesën e operatorëve lokalë/rajonale. Në përfundim, subjekteve iu bë me dije se AMA do të ndjekë në vijim shqetësimet e tyre, duke propozuar mbajtjen e takimeve të përbashkëta me përfaqësues të AMA-s, RTSH-së si dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura.

Sa më sipër, AMA, duke vlerësuar shqetësimet e parashtruara nga kjo kategori subjektësh si dhe me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura, me shkresën e datës 25.09.2020 i propozoi RTSH-së zhvillimin e një takimi në datën 12 tetor 2020, me përfaqësues të operatorit publik, AMA-s dhe subjekteve analoge private lokale. Në këtë takim, gjithashtu u ftuan të marrin pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Në përmbushje të këtij rekomandimi, në datën 12 tetor 2020, në mjediset e AMA-s, u mbajt takimi i radhës me përfaqësues të operatorit publik shqiptar (RTSH), operatorëve televizivë analogë lokalë/rajonale si dhe shoqatës së Rrjeteve Televizive Lokale dhe Kabllore (RRTL). Në takim ishin ftuar të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Disa nga çështjet kryesore dhe shqetësimet e ngritura prej tyre janë evidentuar më poshtë:

#### *Çështja e tarifave të mbështetjes në rrjetin e RTSH-së*

Përfaqësuesit e RRTL-së ngritën pretendimin se tarifat e miratuara janë të pabazuara në kostot reale të RTSH-së dhe kërkuar heqjen totale të tyre, duke argumentuar se aktualisht kostot për funksionimin e tyre në teknologjinë analoge janë rreth 350-400 euro, ndërsa tarifat e RTSH-së janë tepër të larta.

Lidhur me pretendimin e shoqatës RRTL që kjo tarifë është e lartë dhe e pabazuar në kosto reale, përfaqësuesit e RTSH-së sqaruan se krahasuar me tarifën e parashikuar në Strategjinë për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike kjo tarifë është reduktuar ndjeshëm dhe në procesin e miratimit të kësaj tarife nga AMA, RTSH ka argumentuar me dokumentacionin përkatës vlerën e përcaktuar. Megjithatë, RTSH, la të hapur diskutimin e tarifave për të gjithë operatorë pas përfundimit të digjitalizimit në të gjitha allotmentet e vendit.

Gjithashtu gjatë këtij takimi, subjektet u informuan se në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për Lirimin e Frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar dhe vendimit të AMA-s, nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e listës së subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfitojnë nga kompensimi financiar”, subjektet nëse do të ofrojnë shërbimin e tyre mbështetur në teknologjinë numerike do të përfitojnë kompensim financiar për mbulimin e tarifës së mbështetjes së operatorëve ekzistues analogë lokalë/rajonale në rrjet numerik, për një periudhë 6.46 mujore, por për ta përfituar kompensimin duhet të mbështeten në rrjet numerik.

#### *Kërkesa për pajisjen me frekuencë lokale të televizioneve lokale për secilin allotment*

Kërkesa e mësipërme është kërkesë e përsëritur dhe subjekteve iu risoll në vëmendje se referuar planit aktual të frekuencave për transmetimet numerike rezulton se frekuencat për ndërtimin e rrjeteve lokale i përkasin brezit të frekuencave DD2, frekuenca, të cilat, referuar vendimeve të organizmave evropianë do të kalojnë për përdorim në teknologjinë mobile dhe nuk do të përdoren për transmetime audiovizive. Në këto kushte, alternativa e tyre për kalim në transmetim numerik aktualisht mbetet vetëm mbështetja në rrjetet numerike të operatorit publik ose operatorëve privatë.



Subjektet u informuan se në planifikimim e brezit të frekuencave audiovizive në kuadër të procesit të lirim të brezit DD2, AMA do të mbajë në konsideratë edhe kërkesën e operatorëve lokalë/rajonale.

Në përfundim, subjekteve iu bë me dije se AMA, pas mbylljes së digjitalizimit në rang kombëtar, do të ndjekë në vijim shqetësimet e tyre, duke propozuar mbajtjen e takimeve të përbashkëta me përfaqësues të AMA-s, RTSH-së si dhe Komisionit të Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura të problematikave të ngritura nga operatorë lokalë.

**8) Të ndërmerren hapa konkretë konform ligjit për zbatimin e plotë të detyrimit ligjor të operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave, për të garantuar të drejtën e informimit përmes mediave audiovizive të çdo qytetari në vend.**

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, që prej muajit tetor të vitit 2017 ka iniciuar një komunikim shkresor, dhe jo vetëm, me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, mbi përmbushjen e detyrimit ligjor që këta operatorë kanë për atë që njihet si “gjuha e shenjave”. Pra, për plotësimin e detyrimit që ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Sipas përkufizimit në ligjin e sipërcituar (pika 10) dhe në Kodin e Transmetimit (pika 3, kapitulli “Përkufizime”), “Komunitete me nevoja të veçanta shqisore”, konsiderohen persona “me mangësi të pjesshme ose të plotë shikimi ose dëgjimi, aftësia e të cilëve për të perceptuar sinjale audio apo audiovizive është e kufizuar në atë masë që bën të pamundur gëzimin e së drejtës së informimit”.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, transmeton një edicion informativ me gjuhën e shenjave. Në muajt shkurt dhe mars 2020, AMA i dërgoi informacionin e kërkuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda, duke i bashkëngjitur edhe shkresat me nr. 4646, 2555 dhe 3258 prot., përkatësisht të datave 22.11.2018, 25.06.2019 dhe 11.09.2019, dërguar operatorëve audiovizivë “Top Channel”, “Tv Klan” dhe “Vizion Plus”, me të njëjtën kërkesë: Plotësimin e detyrimit ligjor për transmetimet me gjuhën e shenjave.

Konkretisht, tre operatorëve të mësipërm u janë dërguar shkresat me nr. 4646, 2555 dhe 3258 prot., përkatësisht të datave 22.11.2018, 25.06.2019 dhe 11.09.2019. Gjithashtu, përmes një shkrese të përbashkët, tre operatorëve kombëtarë (shkresa me nr. 2650 prot., datë 21.09.2020, e dërguar për dijeni edhe Kuvendit), veç përsëritjes së kërkesës për përmbushjen e detyrimit ligjor që këta operatorë kanë për “gjuhën e shenjave”, u është bërë e ditur se “mungesa e transmetimeve me gjuhën e shenjave përbën shqetësim edhe për Kuvendin e Shqipërisë, i cili e ka përfshirë këtë çështje në rekomandimet kryesore për AMA-n”.

AMA, në shkresat e dërguara, u ka risjellë në vëmendje operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare, bazën ligjore për transmetimet me gjuhën e shenjave. Duhet theksuar se, në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka parashikime për sanksione ndaj operatorëve audiovizivë për këtë çështje.

Megjithatë, duke i konsideruar shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme transmetimet me gjuhën e shenjave, si dhe duke konstatuar me keqardhje mungesën e reagimit nga ana e operatorëve audiovizivë kombëtarë, AMA e përfshiu për diskutim këtë çështje në mbledhjen e Këshillit të Autoritetit, të datës 12 nëntor 2020. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Këshilli i AMA-s apeloj ndaj operatorëve me licencë kombëtare për zbatimin e këtij detyrimi të rëndësishëm që ata kanë.

Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me operatorët, këta të fundit i parashtuan AMA-s shqetësimin për mungesën e interpretëve të gjuhës së shenjave. Operatori audioviziv “Tv Klan” kishte kërkuar bashkëpunimin e Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë për t’u ardhur në ndihmë me persona që mund të ofrojnë interpretimin në ekran të gjuhës së shenjave. Por vetë Shoqata, në përgjigje të kësaj kërkeje, ka vënë në dijeni operatorin audioviziv se “nuk ka persona që mund ta ofrojnë këtë shërbim të përditshëm...”, pra, interpretimin me gjuhën e shenjave.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, sipas të cilit: Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë (pika 15, kreu II); dhe Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimin të gjuhës së shenjave shqipe (pika 16, kreu II); Autoriteti i Mediave Audiovizive u sugjeroi dy ministrive përkatëse (Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) nxitjen dhe marrjen e masave të mëtejshme për konkretizimin e transmetimeve audiovizive për personat me nevoja të veçanta shqisore, përmes përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave.

Ende nuk kemi një reagim nga dy ministrinë e sipërpërmendura.

**9) Të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për parandalimin e sulmeve apo hyrjeve të paautorizuara në sistemet TIK të institucionit, menaxhimin e riskut lidhur me infrastrukturën TIK; këto rekomandime kanë një rëndësi të veçantë për mirëfunksionimin dhe sigurinë e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të AMA-s.**

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, AMA ka marrë masat e nevojshme për përmbushjen e tyre.

Aktualisht, janë konfiguruar filtra të cilët bllokojnë faqe adult dhe faqe të tjera të rrezikshme, që dëmtojnë dhe rrezikojnë pajisjet dhe rrjetin TIK në AMA. Sektori TIK, çdo javë, monitoron loget e firewall-it, në qoftë se janë tentuar të hapen këto faqe. Gjithashtu, është hartuar dhe miratuar rregullorja për menaxhimin e logeve.

AMA ka hartuar dhe miratuar regjistrin e risqeve mbi infrastrukturën TIK si dhe regjistrin e pajisjeve TIK në institucion ku identifikohet kodi i artikullit, emri, çmimi, vlera e mbetur duke zbatuar normën e amortizimit 25%, me qëllim parashikimin e çdo lloj risku të mundshëm dhe garantimin e vijueshmërisë së punës në institucion.

AMA vijon monitorimin mbi sasinë e internetit që përdoret në institucion me qëllim përcaktimin e nevojave për shtim apo pakësim të kapaciteteve.

Një ndër këto rekomandime ka qenë vendosja e një serveri backup me parametrat optimal si serveri i parë. Në zbatim të këtij rekomandimi, AMA ka blerë serverin back-up replikimi me serverin kryesor.

Një tjetër rekomandim i KLSH-së ka qenë vlerësimi dhe analizimi i nevojave mbi ofrimin e shërbimeve Helpdesk, ku çdo departament të ketë akses për problematikat dhe kërkesat e tyre, si dhe departamenti IT të procedojë me hedhjen e të gjitha konfigurimeve në këtë sistem. Duke pasur parasysh procesin zgjedhor në prill 2021, aplikacionet/programet kompjuterike që administrohen nga AMA për këtë qëllim, si dhe me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe shmangies së problematikave të mundshme, AMA parashikoi në projekt-buxhetin e vitit 2021 blerjen e programit Helpdesk.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 702/38 prot., datë 27.11.2020, administruar në AMA me nr. 3444 prot., datë 02.12.2020, ka paraqitur raportin përfundimtar të auditimit dhe kërkon nga AMA që, brenda 20 ditëve, të raportojë mbi masat e marra për zbatimin e plotë të rekomandimeve si dhe brenda 6 muajve të raportohet mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Në përgjigje të kësaj shkrese, AMA më datë 22.12.2020 ka dërguar zyrtarisht pranë KLSH-së informacionin mbi hapat e ndërmarra dhe statusin e realizimit të rekomandimeve.

***10) Të bashkëpunojë me AKEP-in dhe MIE-në për përcaktimin e hapave të procesit dhe nevojat për ndryshime ligjore për lirimin e brezit 700 MHz (brezi DD2) dhe dhënien në përdorim të tij për rrjetet e lëvizshme, kërkesë kjo edhe nga rekomandimet e Komisionit European. Procesi i lirimit të brezit DD2 do të ketë impakt të ndjeshëm në tregun audioviziv, duke qenë se ky brez aktualisht është në përdorim nga operatorët privatë kombëtarë numerikë të licencuar nga AMA.***

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020, është miratuar politika spektrale, dhe, bashkëlidhur saj, është miratuar edhe plani i veprimit për implementimin e kësaj politike, ku, ndër të tjera, është përfshirë edhe procesi i lirimit të brezit DD2. Sipas këtij plani, institucionet e ngarkuara për ndjekjen e këtij procesi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), AMA dhe AKEP.

Procesi do të fillojë me tryeza konsultimi me të gjitha palët e përfshira (operatorë audiovizivë, shoqata të mediave, rregullatorë etj) dhe në përfundim të konsultimeve të kryera do të hartohet një plan i detajuar i masave që duhet të ndërmerren për lirimin e brezit DD2 (ndryshime ligjore nëse do të jetë e nevojshme, kompensim financiar, realizimi i zgjidhjeve teknike etj).

Ndërkohë, MIE ka kërkuar asistencë teknike nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU) për gjetjen e zgjidhjeve efektive teknike, të cilat duhet të ofrojnë mundësinë që, pas lirimit të brezit DD2, të mos reduktohet numri i operatorëve në treg si dhe kapacitetet e tyre të transmetimit. Në grupin e punës që bashkëpunon dhe merr pjesë në takimet me konsulentët e ITU-së janë përfaqësues të MIE, AMA dhe AKEP.

Konsulenti i ITU-së ka dërguar draftin-raportin paraprak të dokumentit, ku në aspektin teorik janë paraqitur dy alternativa për lirimin e brezit DD2, por nuk është dhënë zgjidhje konkrete për të dy këto alternativa. Përfaqësuesit e grupit të punës kanë reflektuar komentet e tyre, me qëllim përmirësimin dhe finalizimin e këtij dokumenti.

Sa më sipër, lidhur me procesin e lirimit të brezit DD2, AMA vijon bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe AKEP, në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU) si dhe projektit të binjakëzimit me rregullatorin hungarez për këtë qëllim. Grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të MIE, AMA-s dhe AKEP, zhvillon takime online me konsulentët, si dhe shkëmben informacionet e nevojshme ligjore dhe teknike, me qëllim arritjen e objektivit të kësaj asistence, që është përcaktimi i zgjidhjeve efektive teknike duke ruajtur numrin e operatorëve numerikë në treg, si dhe kapacitetet e tyre të transmetimit.

Konsulentët kanë paraqitur draft-raportin me rekomandime për zhvillimin e procesit të lirimit të brezit DD2 në vendin tonë dhe janë duke punuar për hartimin e një plani frekuencor efektiv.

Ndërkohë, bazuar në VKM-në nr. 636, datë 29.7.2020, konkretisht, në planin e veprimit për implementimin e këtij dokumenti politik, duhej të kishte filluar paralelisht në shtator të këtij viti edhe konsultimi me operatorët numerikë në treg, të cilët preken drejtpërsëdrejti nga ky proces.

AMA, në mënyrë të përsëritur, ka kërkuar nga MIE fillimin e këtij procesi të rëndësishëm, dhe Kryetari i AMA-s ka zhvilluar, më datë 11.11.2020, një takim me zëvendësministrin Etjen Xhafaj, për këtë qëllim. Në këtë takim është rënë dakord që do të zhvillohet një tryezë e nivelit të lartë me operatorët kombëtarë audiovizivë, tryezë që, deri më sot, ende nuk është zhvilluar.

AMA e konsideron detyrim ligjor si dhe tepër të rëndësishëm procesin e konsultimit me të gjitha palët e përfshira në këtë proces, me qëllim shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë implementimit të tij. Nisur nga eksperiencat e mëparshme, sikurse procesi i lirimit të brezit DD2 apo procese të tjera të lidhura me të, ku ka pasur vonesa të konsiderueshme për shkak të proceseve gjyqësore të ngritura nga operatorët audiovizivë kombëtarë, mendojmë se duhet të nisë menjëherë procesi i konsultimit publik.

**11) Kuvendi i Shqipërisë nxit konkretizimin e bashkëpunimit të AMA-s dhe me institucione të tjera ligjzbatuese, aspektet e punës së të cilave lidhen me fushën e veprimit të Autoritetit dhe, njëkohësisht, thekson se me gjithë koordinimin e veprimeve të deritanishme mes AMA-s dhe AKEP-it, akoma nuk është arritur finalizimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes tyre, e cila do t'i japë një dimension të ri jo vetëm parandalimit dhe/ose ndalimit të piraterisë audiovizive online në përputhje me parashikimet ligjore, por edhe bashkëpunimit në drejtime të tjera të përbashkëta, që kanë lidhje me punën e dy institucioneve.**

Me qëllim koordinimin efektiv të veprimtarisë mes AMA dhe AKEP, në bazë dhe për zbatim të rekomandimit të dalë nga rezoluta e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vijim të përpjekjeve tona për finalizimin e marrëveshjes mes dy institucioneve, Autoriteti, me shkresat nr.767 prot., datë 25.02.2020, nr.767/2 prot., datë 19.08.2020 dhe nr.2602 prot., datë 11.09.2020 i ka ripërcjellë AKEP-it, për të disatën herë, marrëveshjen e bashkëpunimit të dakordësuar vitin e kaluar. Deri tani nuk kemi ndonjë reagim nga ky institucion.

Duke pasur parasysh ndryshimet e vazhdueshme teknologjike dhe shtimin e formave të reja të piraterisë në rrjetin e internetit, përmes portaleve, faqeve apo aplikacioneve të ndryshme on line, AMA e konsideron çështje problematike informalitetin në fushën e mediave audiovizive, që zhvillohet nga ISP-t në të gjithë vendin.

Pirateria televizive, në ditët e sotme, është duke u kryer përmes rrjetit të internetit, përmes shpërndarjes së shërbimit audioviziv përmes platformave Over The Top (OTT) dhe bashkëpunimi me AKEP-in dhe roli i këtij të fundit, në këtë proces, është i nevojshëm.

Këto subjekte, përveçse i shkaktojnë dëm ekonomik Buxhetit të Shtetit, u sjellin po ashtu dëm edhe interesave ekonomike dhe tregtare të subjekteve të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë televizive, duke ndikuar, në këtë mënyrë, në shtrembërimin e konkurrencës së ndershme dhe mungesës së ekuilibrit të tregut mediatik.

Sikurse është raportuar, AMA, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis AMA dhe AKEP dhe nënshkrimin e saj. Mungesa e reagimit nga ky autoritet, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura, nuk i shërben qëllimit tonë të përbashkët për garantimin e konkurrencës së ndershme në treg dhe parandalimit të fenomenit të piraterisë televizive dhe informalitetit në këtë fushë.

Në vlerësimin tonë, lidhja e kësaj marrëveshjeje do t'i shërbejë rritjes së efikasitetit dhe bashkërendimit të punës për forcimin e luftës kundër piraterisë në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Në vijim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, AMA ka vijuar punën dhe konkretisht:

Më 25 shtator 2020, në mjediset e AMA-s, u zhvillua një takim pune mes autoriteteve rregullatore të Shqipërisë (AMA) dhe të Kosovës (KPM) me qëllim bashkëpunimin dhe komunikimin sistematik të institucioneve, në shërbim të konsolidimit të performancës institucionale, për rregullimin e tregut audioviziv. Kalimi i transmetimeve nga analogu në digjital dhe aplikimet e reja teknologjike mbeten aspekte ku AMA dhe KPM kanë energji dhe hapësira për të intensifikuar më shumë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, bazuar dhe në praktikatat e rregullatorëve në vendet e BE-së.

Në këtë takim u diskutua dhe mbi rolin e impaktin e transmetimeve përtej kufirit, ku transmetimet e subjekteve audiovizive nga Shqipëria ndiqen në territorin e Republikës së Kosovës, dhe anasjelltas. Për trajtimin e problematikave që krijohen, për ankesa të ndryshme të qytetarëve nga të dy vendet, u pa mundësia e realizimit të shkëmbimit të informacionit nga dy institucionet për zgjidhjen më të shpejtë dhe profesionale të tyre.

Shkëmbimi i komunikimit virtual mes dy institucioneve ishte një pikë tjetër e takimit, e cila u vlerësua si mekanizëm në favor të intensifikimit të bashkëpunimit dhe mbulimit të angazhimeve me interes të ndërsjelltë. Kjo do të konkretizohet shumë shpejt me instalimin e linqeve në faqet respektive zyrtare online të AMA-s dhe të KPM-së.

Në datë 8 tetor 2020, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Ministria e Kulturës nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, për realizimin e projekteve të përbashkëta audiovizive mbi promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. AMA miratoi një fond për Ministrinë e Kulturës për prodhime audiovizuale, që kanë në fokus edukimin mediatik, lidhur me artin dhe kulturën në media. Projektet që mbështet AMA janë: *Muzeu i ri i Filmit*, një ndër projektet e Ministrisë së Kulturës; *realizimi i videotureve për "Itinerarin Fishtian"*, që rrëfen gjithë rrugëtimin jetësor dhe krijues të At Gjergj Fishtës apo *Via Egnatian*, një nga rrugët mijërvjeçare, që lidhte Lindjen me Perëndimin. Konteksti i ri, i krijuar prej pandemisë COVID-19, i vendosi institucionet kulturore përpara një realiteti të ri, që kërkon një qasje të re te publiku, sidomos ai i grupmoshave të reja. Në këtë këndvështrim po shihen të gjitha format e bashkëpunimit, që i ofrojnë publikut një produkt i cili i afron ata me trashëgiminë kulturore dhe artin. Bazuar në këtë marrëveshje, palët angazhohen për krijimin e hapësirave mbështetëse, për ruajtjen e krijimtarisë artistike, si dhe për të promovuar artin e kulturën në fushën audiovizive. AMA, si anëtar me të drejta të plota në Observatorin Evropian Audioviziv, organizëm që mbulon aktivitete audiovizive dhe të kinemasë, i cili monitoron tregun kinematografik brenda Bashkimit Evropian dhe vendeve që synojnë anëtarësimin në BE, me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin ndër-institucional në drejtime konkrete, firmosi këtë marrëveshje.

Në datë 23 nëntor 2020, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional, me fokus rëndësinë e garantimit të mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audiovizive.

Ky Memorandum mirëkuptimi synon institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre institucionale, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, për çështje të interesit të përbashkët, që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive. Bazuar në këtë memorandum, palët angazhohen për realizimin e veprimtarisë së përbashkët për respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë, të të drejtave që lidhen me mbrojtjen e grupeve të marginalizuara; rritjen e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; për të parandaluar e ndaluar rastet e veprimtarisë së paligjshme, si dhe për të kërkuar ndërhyrje të ndryshme nga subjektet mediatike në vend, sa herë që është e nevojshme.

Në datë 30 dhjetor 2020, Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit. Duke synuar respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive, si dhe me qëllim përcaktimin e fushave dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërmjet palëve, për çështje të interesit të përbashkët, që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive, palët nënshkruan këtë Memorandum Mirëkuptimi. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi sipas fushës së kompetencave, bashkëpunim i cili do të fokusohet në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive; shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues sa herë që ndërthuren fushat e kompetencës; angazhimin e përbashkët për çështje të përmbajtjeve audiovizive, duke pasur në fokus mbrojtjen e fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive dhe nga reklamat me dhe për fëmijët, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin moral, mendor dhe fizik të fëmijëve; nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe interesit më të lartë të tyre; shkëmbimin e informacionit dhe rekomandimeve për çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve; organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin e të drejtave që gëzojnë të miturit; bashkëpunimin në evidentimin e shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe situatave problematike në transmetimet në mediat audiovizive që cenojnë ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë së fëmijës në çdo rrethanë; raportim i ndërsjellë i rasteve të intervistimit, identifikimit të fëmijëve viktimë të abuzimeve të cilat dëmtojnë ose riviktimizojnë fëmijën viktimë; referimin e rasteve konkrete dhe marrjen e masave përkatëse, në rast konstatimi të shkeljeve ligjore të sipërpërmendura; organizimin e trajnimeve të përbashkëta, me aktorë të fushës së medias, gazetarë, studentë, lidhur me njohjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të fëmijëve në media.

Po në këtë kuadër, AMA, me shkresat nr.2955 prot., datë 20.10.2020 dhe nr. 2956 prot., datë 20.10.2020 i ka kërkuar lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit përkatësisht: Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit, Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ende nuk janë finalizuar marrëveshjet e bashkëpunimit me këto institucione.

Një delegacion nga AMA ishte, më 12 tetor 2020, në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë, në një takim zyrtar në Komisionin Parlamentar për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media, në prezencë të kryetarit z. Mërgim Lushtaku, dy nënkryetarëve, z. Valon Ramadani dhe z. Albert Kinolli, si dhe deputetëve të tjerë në komision.

Gjatë takimit, drejtuesit e delegacioneve, z. Sala dhe z. Lushtaku, kanë vlerësuar bashkëpunimin mes dy vendeve në fushën e rregullimit të transmetimeve audiovizive, si dhe praninë më të shtuar dhe të larmishme të programeve televizive nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas.

Ashtu si dhe në takimin e parë të zhvilluar në Tiranë, gjatë vitit të kaluar, pjesa më e madhe e diskutimit u fokusua te procesi i digjitalizimit.

Avancimi i procesit në tregun audioviziv të Shqipërisë, u përshkrua si një përvojë për Kosovën, si në përmirësimet e nevojshme të kuadrit ligjor, ashtu dhe në aspektet teknike dhe teknologjike. Fakti që rreth 30 për qind e qytetarëve në Shqipëri kanë mundësi të ndjekin deri në 39 kanale pa pagesë, u gjykua nga deputetët e pranishëm si një impakt shumë i dobishëm i digjitalizimit për popullatën, që nuk ka të ardhura të mjaftueshme financiare për shërbime audiovizive me pagesë.

Delegacioni nga Kosova shprehu gatishmërinë për një vizitë pune në mjediset e AMA-s në Tiranë, për të diskutuar mbi qasjet e duhura në legjislacion apo në ndërtimin e infrastrukturës së përshtatshme teknologjike për të avancuar në procesin e digjitalizimit edhe në Republikën e Kosovës.

Z. Sala përmendi dhe rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë që AMA të intensifikojë kooperimin me institucionin homolog në Kosovë, KPM. Ai informoi deputetët e Komisionit Parlamentar për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për akordin mes dy rregullatorëve, në Tiranë dhe në Prishtinë, për trajtimin sa më të shpejtë dhe profesionalisht të rasteve të ankesave që bëjnë qytetarët apo subjektet nga të dy shtetet, për përmbajtjet audiovizive të transmetuara.

Kjo u vlerësua nga deputetët e pranishëm në takim, të cilët kanë nxitur bashkëpunimin më të ngushtë mes AMA-s dhe KPM-së, në shërbim dhe në dobi të publikut në Shqipëri dhe në Kosovë.

Më datat 29 dhe 30 tetor 2020, përfaqësues të AMA-s zhvilluan takime pune me homologët e Komisionit të Pavarur të Medias, si autoriteti rregullator i transmetimeve audio dhe audiovizive në Kosovë. Takimet kanë qenë në kohën kur është konstituuar në detyrë kryetari i ri i KPM, z. Xhevat Latifi.

Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive, digjitalizimi i transmetimeve audiovizive, edukimi mediatik, apo dhe trajtimi me shpejtësi dhe efikasitet i problematikave që kanë ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv apo shikuesit në dy vendet kanë qenë temat kryesore që janë diskutuar. Sa i takon shkëmbimit të përvojave mbi procedurat e zbatimit të digjitalizimit në Kosovë, përfaqësuesit e dy rregullatorëve kanë parë shumë hapësirë bashkëveprimi, si në planin bilateral, ashtu dhe në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në platformat evropiane EPRA e ERGA, ose në struktura të tjera, rajonale e globale, ku AMA e Shqipërisë dhe KPM e Kosovës janë anëtarë.



**12) Të vijojë të ndjekë çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, duke i vlerësuar me seriozitet. Fakti që numri i ankesave pranë Këshillit të Ankesave që nga krijimi i tij në prill 2016 ka pasur një rritje progresive nga viti në vit, tregon për rritjen e besimit tek Autoriteti në funksion të interesit publik.**

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s është njësia që ndjek dhe shqyrton çdo ankesë që adresohet pranë Autoritetit për shkelje të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Procedura e shqyrtimit të ankesave deri në shpalljen e konkluzioneve është një proces dinamik, që është realizuar dhe po realizohet në vijimësi, brenda afateve të parashikuara nga ligji. Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar 123 ankesa dhe, në përfundim të shqyrtimit të tyre, u ka tërhequr vëmendjen OSHMA-ve në 36 raste.

Më konkretisht:

- 12 raste për shkelje të të drejtave të fëmijëve;
- 10 raste për shkelje dinjitetit, të etikës, keqpërdorimit të fjalorit;
- 5 raste për shtrirjen e orarit të transmetimit të përmbajtjeve të caktuara, sipas parashikimeve të Kodit të Transmetimit;
- 4 raste për vendosjen e shenjave paralajmëruese, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive;
- 3 raste për shkelje të të drejtave të njeriut dhe cenim të privatësisë;
- 1 rast tjetër për shkeljen e masave anti-Covid në kuadër të Aktit Normativ;
- 1 rast për ndërprerjen e transmetimit të një seriali me përmbajtje joetike.

Sa i përket objektit të tyre, ankesat paraqiten si më poshtë:

- 39 me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 41 me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, të etikës dhe moralit publik;
- 19 rezultuan jashtë objektit të punës së AMA-s, përcaktuar nga ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 2 për të drejtën e përgjigjes;
- 2 për verifikim informacioni;
- 20 ankesa kishin objekt të ndryshëm.

### **3. MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORITETIT**

#### ***Auditim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit “Mbi performancën e internetit në administratën publike”***

Në nëntor të vitit 2019 AMA u auditua nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ”Mbi performancën e internetit në Administratën Publike”, dhe në përfundim të auditimit rekomandoi marrjen e disa masave organizative që lidhen me parandalimin e sulmeve ose hyrjeve të paautorizuara në pajisjet e institucionit, menaxhimin e riskut lidhur me infrastrukturën TIK, si dhe menaxhimin e shërbimeve Helpdesk.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH, AMA ka marrë masat për përmbushjen e tyre gjatë vitit 2020. Konkretisht, gjatë këtij viti është prokuruar (blerë) një server sekondar replikimi, me qëllim rritjen e sigurisë së informacionit, në rast të dëmtimit të serverit primar, janë konfiguruar filtra të cilët bllokojnë faqe adult dhe faqe të tjera të rrezikshme, që dëmtojnë dhe rrezikojnë pajisjet dhe rrjetin TIK në AMA. Në vijim të përmirësimit dhe standardizimit të akteve rregullatore mbi administrimin e sistemeve dhe proceseve TIK, AMA ka hartuar dhe miratuar akte rregullatore lidhur me ruajtjen dhe analizimin e log-eve, është hartuar regjistri i risqeve mbi infrastrukturën TIK, me qëllim parashikimin e çdo lloj risku të mundshëm dhe garantimin e vijueshmërisë së punës në institucion.

Një tjetër rekomandim i KLSH-së ka qenë vlerësimi dhe analizimi i nevojave mbi ofrimin e shërbimeve Helpdesk, ku çdo departament të ketë akses për problematikat dhe kërkesat e tyre, si dhe departamenti IT të procedojë me hedhjen e të gjitha konfigurimeve në këtë sistem. Duke pasur parasysh procesin zgjedhor në prill 2021, aplikacionet/programet kompjuterike, që administrohen nga AMA për këtë qëllim, si dhe me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe shmangies së problematikave të mundshme, AMA parashikoi në projektbuxhetin e vitit 2021 blerjen e programit Helpdesk.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 702/38 prot., datë 27.11.2020, administruar në AMA me nr. 3444 prot., datë 02.12.2020, ka paraqitur raportin përfundimtar të auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve duke kërkuar nga AMA që, brenda 20 ditëve, të raportonte mbi masat e marra për zbatimin e plotë të rekomandimeve si dhe brenda 6 muajve të raportonte mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Në përgjigje të kësaj shkrese, AMA më datë 22.12.2020 ka dërguar zyrtarisht pranë KLSH-së informacionin mbi hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të rekomandimeve.

#### ***Rekomandime nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale***

Në vijim të Rekomandimit nr.43, datë 14.10.2019, të Komisionierit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në lidhje me programin e transparencës së AMA-s, dërguar me shkresën e tyre nr.1603/1 prot. datë 14.10.2019, gjatë vitit 2020, Programi i Transparencës ka pësuar disa ndryshime, konkretisht:

- ✓ Informacioni i bërë publik në faqen zyrtare, tashmë, është i ndërlidhur në programin model të transparencës.
- ✓ Informacioni për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, është i publikuar në faqe dhe i ndërlidhur në programin model të transparencës.
- ✓ Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik – gjendet në informacionin e publikuar në menunë Legjislacioni / Dhënie mendimi.
- ✓ Publikimi i vendimeve të Këshillit të AMA-s gjendet në një nënmenu të veçantë.
- ✓ Një përshkrim i thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë – Informacioni është i publikuar në Programin e Transparencës.

Të gjitha ndryshimet e mësipërme janë bërë në përputhje e në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Kjo mënyrë vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti rrit transparencën, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit të sipërcituar.

### ***Rekomandime nga Avokati i Popullit***

Avokati i Popullit, përmes shkresave me nr. K5/S1-5 prot., datë 29.05.2020 dhe nr. K5/IU-2 prot., datë 01.06.2020, përkatësisht “*Rekomandim për marrjen e masave në rastin e dhunës ndaj të miturit S.Ç., nga disa punonjës të Policisë së Shtetit*” dhe “*Rekomandim për përmirësimin e punës për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës*”, parashtronte një sërë rekomandimesh për disa institucione, përfshirë edhe AMA-n.

Ndër të tjera, institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi edhe “*Marrjen e masave për ndryshimin e legjislacionit që rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive, për përcaktimin e rregullave më të detajuara, për sa u përket çështjeve të abuzimit/dhunës tek të miturit*”.

AMA, përmes shkresës me nr. 1390/1, datë 09.06.2020, e informoi Avokatin të Popullit për të dy rekomandimet e tij, si më poshtë:

AMA është autoriteti rregullator për fushën e mediave audiovizive, në bazë të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Sipas nenit 2 të ligjit të sipërcituar (“Fusha e zbatimit”), ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.

Në mënyrë më të detajuar, parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikat në transmetimet audiovizive përcaktohen në Kodin e Transmetimit, një akt nënligjor i rëndësishëm, i hartuar dhe i miratuar nga AMA.

Ligji organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është i përafëruar plotësisht me Direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar), Numri CELEX: 32010L0013, Fletore Zyrtare e BE-së, Seria L 95, datë 15. 4. 2010). Për rrjedhojë, ky ligj është hartuar edhe në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Ndërsa Kodi i Transmetimit është hartuar dhe miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, të sipërcituar. Ky Kod vendos rregullat, standardet dhe praktikat e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

-Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

-Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për kinematografinë”, i ndryshuar.

-Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

-Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Kodi i Transmetimit është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Evropian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së (“Audiovisual Media Services Directive”), në zbatim të akteve ndërkombëtare për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut: “Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore” (e vitit 1998) dhe Konventa e OKB-së “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” (e vitit 1989).

Në vitin 2017, Kodi i Transmetimit pësoi përmirësime të dukshme, pas një konsultimi disamujor me grupe të ndryshme interesi, aktorë dhe faktorë të medias, shoqërisë civile etj. Megjithatë, një rishikim i mundshëm i tij është përfshirë në Strategjinë e Autoritetit për vitet 2021-2023, diktuar edhe nga zhvillimet e vrullshme teknologjike.

Nga ana tjetër, Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018 (Direktiva 2018/1808), datë 14.11.2018).

Në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit edhe me ndryshimet e saj, AMA ka filluar punën parapërgatitore për t'u njohur me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni evropian në fushën audiovizive. Referuar parashikimeve të Direktivës së ndryshuar, shtetet anëtare ngarkohen për miratimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore për të qenë në pajtueshmëri me këtë akt, në shtator të vitit 2020.

Sa më sipër, pavarësisht se AMA vlerëson që baza ligjore aktuale për veprimtarinë e mediave audiovizive, edhe për çështjen që ju adresoni, është e plotë dhe e përafëruar me standardet dhe praktikën më të mira evropiane, vijon procesi i përshtatjes me ndryshimet e legjislacionit ndërkombëtar.

## **4. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT**

### **4.1 Progres-Raporti i BE-së**

Në progres raportin e BE-së për Shqipërinë, në kapitullin 10 “Shoqëria e informacionit dhe Media”, për vitin 2020, rekomandohet:

*Nuk u arrit progres në finalizimin e kalimit në transmetimet audiovizive dixhitale, i cili mbetet për t'u finalizuar, së bashku me rishikimin e planit kombëtar të brezit të gjerë me objektiva dhe synime të qarta, si dhe në zbatimin e numrit evropian të urgjencës 112, siç rekomandohet tashmë në raportin 2018.*

Ndërkohë, në Kapitullin 23 “Liria e shprehjes”, ndër të tjera, rekomandohet:

- 1. Sigurimi i zbatimit të Kodit të Punës dhe forcimi i mbrojtjes së të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë;*
- 2. Legjislacioni të jetë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare në reklamat publike për rritjen e transparencës;*

Lidhur me rekomandimin e kapitullit 10, AMA ka raportuar si më poshtë:

*Në zbatim të ligjit nr. 97/2013, datë 4.03.2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në përmbushjen e detyrave të tij, të përcaktuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 2.05.2012, "Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike", AMA ndërmori disa aktivitete në lidhje me procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive.*

*AMA vijoi koordinimin me operatorët analogë lokalë/rajonale dhe kombëtarë, në kuadër të përmbushjes së këtij detyrimi. AMA vijoi fushatën e informimit përmes kanaleve të ndryshme mediatike (fushatë e brendshme dhe e jashtme), kreu vazhdimisht inspektime në terren për të verifikuar mbulimin e territorit me sinjal digjital dhe monitoroi procesin e mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare numerike etj.*

*Si rezultat i aktiviteteve të kryera nga AMA, finalizimi i procesit të digjitalizimit u bë i mundur në 30 dhjetor 2020.*

*Transmetimi digjital, që ofron cilësi të lartë dhe një numër të madh të programeve televizive falas, është i arritshëm nga e gjithë popullsia.*

Lidhur me rekomandimin 1, të kapitullit 23, AMA ka raportuar si më poshtë:

*Autoriteti i Mediave Audiovizive, ndonëse nuk e ka objekt të punës së vet këtë çështje, nisur dhe nga rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, është bërë nismëtar i krijimit të platformave të ndryshme të diskutimit për këtë çështje mes aktorëve të përfshirë. Autoriteti i Mediave Audiovizive inicioi tryezën e takimit në nivel teknik mes përfaqësuesve të shoqatave të gazetarëve dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Në këtë tryezë ishin të ftuar përfaqësues të shoqatave të gazetarëve, departamentet e Gazetarisë në Universitetin publik dhe Universiteteve private. Pjesëmarrësit vlerësuan se ka përmirësime në tregun e medias, por gjithashtu ka ende disa çështje të cilat kanë nevojë për adresim. Të pranishmit diskutuan mbi problematikat aktuale në tregun e medias, si: çështja e pagave minimale të deklaruara, kushtet e punës për të gjithë punonjësit e mediave, marrëveshjet e interesit që kanë përparësi mbi marrëdhëniet në punë, të cilat sjellin më pas dhe konflikte, punonjësit e përkohshëm si dhe praktikën e studentëve. Diskutimi u përqendrua tek nevoja për gjetjen e një mekanizmi, i cili ndërthur institucionet shtetërore, median dhe përfaqësuesit e gazetarëve (shoqatat). U evidentua mungesa e një sindikate të mirëfilltë që përfaqëson dhe mbrohet interesat e gazetarëve. Nga të pranishmit u kërkuar prej AMA-s dhe I.SH.P.SH.SH ndërtimi i një mekanizmi nxitës për të hartuar dhe nënshkruar një kontratë kolektive. Sipas të pranishmëve, kjo kontratë do t'i shërbente të gjitha palëve si një platformë e mirë për të përcjellë shqetësimet duke shmangur iniciativat tërësisht personale.*

Lidhur me rekomandimin 2, të kapitullit 23, AMA ka raportuar si më poshtë:

*AMA, në mënyrë të përsëritur, ka raportuar se veprimtaria e saj mbështetet në ligjin nr. 97/2013, i cili rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre. Në dispozitat e ligjit jepen përkufizimet e reklamave politike dhe institucionale dhe nuk parashikohen rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të tyre. AMA, në kuptim të tagrave dhënë prej ligjit organik, monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive ndërkohë që është jashtë sferës së veprimtarisë së AMA-s kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore, të cilat, aktualisht, prokurohen nga secili institucion publik. AMA, si autoriteti monitorues i programeve, që emetohen prej subjekteve audio dhe audiovizive, raporton mbi volumnin që zënë reklamat, përfshirë reklamat institucionale (në kohë dhe në numër).*

## **4.2 Raportime të tjera**

AMA ka raportuar periodikisht në kuadër të Komitetit të Stabilizim Asociimit, Nënkomitetit “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikë Sociale”, Nënkomitetit “Për Drejtësi, Liri dhe Siguri” si dhe Nënkomitetit “Lira e Shprehjes”.

Komiteti i Stabilizim Asociimit, mbledhur në nëntor 2019, rekomandon marrjen e masave si më poshtë: “Shqipëria ftohet të reflektojë komentet e BE dhe organizmave ndërkombëtare në hartimin e ndryshimeve të ligjit për median”.

Nënkomiteti Liri, Drejtësi dhe Siguri, mbledhur në korrik 2020, rekomandon: *“Shqipëria ftohet të zbatojë rekomandimet e Komisioneve të Venecias mbi draftin e ndryshimeve në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*

Lidhur me këto dy rekomandime, AMA ka informuar se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar“, është në fazë rishikimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe AMA nuk raporton mbi këtë nismë ligjore.



## 5. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT

Një prej aspekteve të punës së AMA-s është kontrolli i veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të ligjit dhe mbikëqyrja e respektimit të kushteve të licencës/autorizimit.

Gjatë vitit 2020, nga AMA janë vendosur 6 sanksione me gjobë, të ndërmarra si më poshtë:

- Drejtoria e Mbikëqyrjes: 5 vendime të sanksioneve me gjobë;
- Drejtoria Juridike dhe Licencave: 1 vendim të sanksioneve me gjobë.

### Drejtoria e Mbikëqyrjes

Autoriteti, gjatë viteve 2018 dhe 2019 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh në terren për parandalimin e piraterisë nga subjektet kabllore në vend. Ndërsa, sa i përket vitit 2020, numri i inspektimeve ka qenë në rënie, kjo shkaktuar dhe nga pandemia e COVID-19 si dhe nga kërkesat në rënie të subjekteve për ndërhyrje nga ana jonë.

Megjithatë, të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore, AMA i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.

Nga verifikimet tona është konstatuar se dukuria e piraterisë televizive ka ardhur duke u pakësuar, nga viti në vit, falë edhe punës së kryer nga Autoriteti. Kjo situatë reflektohet dhe në numrin e ankesave drejtuar institucionit tonë.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:

| SUBJEKTI | Viti 2017                 | Viti 2018                 | Viti 2019                | Viti 2020                 |
|----------|---------------------------|---------------------------|--------------------------|---------------------------|
| Digitalb | 19 ankesa për 45 subjekte | 11 ankesa për 28 subjekte | 6 ankesa për 10 subjekte | -                         |
| Tring    | 11 ankesa për 36 subjekte | 5 ankesa për 12 subjekte  | 2 ankesa për 2 subjekte  | 18 ankesa për 23 subjekte |
| Klan     | -                         | -                         | -                        | 5 ankesa për 5 subjekte   |

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2020, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 55 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve.

Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

5 vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, prej të cilave:

- 5 sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve (kabllorë, iptv, ott) nga të cilat 2 gjoba janë shfuqizuar nga Këshilli i AMA-s, pas ankimimeve.
- Për 13 raste është vendosur tërheqja e vëmendjes ndaj subjekteve OSHMA.

Përveç sa më sipër, AMA, pas verifikimeve dhe shqyrtimeve përkatëse, ka kryer sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të 3 subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet audioviziv pa licencimin ose autorizimin e AMA-s.

Siç vihet re, në krahasim me vitet e mëparshme, aktivitetet e paligjshme audiovizive, pa licencimin ose autorizimin e AMA-s, janë gjithnjë në rënie.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:

| VITI | INSPEKTIMET | GJOBA TOTAL<br>(SHFUQIZUAR) | TËRHEQJE<br>VËMENDJE | SEKUESTRIME |
|------|-------------|-----------------------------|----------------------|-------------|
| 2017 | 488         | 64 (29)                     | 25                   | 19          |
| 2018 | 224         | 27 (10)                     | 49                   | 11          |
| 2019 | 162         | 19 (5)                      | 22                   | 9           |
| 2020 | 55          | 5 (2)                       | 13                   | 3           |

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2020, është fokusuar në monitorimin e programeve mbi tematikën e tyre, respektimin e parashikimeve ligjore për transmetimin e reklamave dhe për evidentimin e volumit të reklamave në televizionet kombëtare, sikurse edhe në monitorimin e programeve të lira në platformat numerike tokësore.

### **Drejtoria Juridike dhe e Licencave**

Në vijim të kontrollove të ushtruara kryesisht, mbi të dhënat e subjekteve të pasqyruara në ekstraktin për të dhënat e subjekteve në faqen zyrtare elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit, gjatë vitit 2020, Drejtoria Juridike dhe e Licencave, ka ndëshkuar 1 subjekt, me vendim për dënimin me gjobë nr. 6<sup>1</sup> datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA, me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021.

#### **Ecuria financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2020**

lekë

|                                                                                                 |                    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|
| <b>Çelja në fillim të vitit 2020</b>                                                            | <b>307,751,388</b> |
| + Vendime të dënimeve me gjobë në 2020                                                          | 5,160,000          |
| + Kamatëvonesa të lindura në vitin 2020                                                         | 0                  |
| - Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë dhe kamatëvonesat e lindura              | 2,008,191          |
| - Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi | 4,000,000          |
| <b>Detyrimi në fund të vitit 2020</b>                                                           | <b>306,903,197</b> |

Masa e detyrimeve të lindura prej 6 sanksioneve me gjobë në vitin 2020 është në vlerën 5.160.000 lekë. Masa e uljes në vlerën 4,000,000 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të AMA-s janë shfuqizuar 2 vendime të sanksioneve me gjobë të vitit 2020: gjoba nr. 2, datë 21.07.2020, shfuqizuar me vendimin nr. 81, datë 03.09.2020 dhe gjoba nr. 4 datë 21.07.2020 shfuqizuar me vendimin nr. 71, datë 21.08.2020.
- 2 vendime të sanksioneve me gjobë janë shfuqizuar me vendim gjykatë: gjoba nr. 49 datë 24.11.2015 shfuqizuar me VGJA me nr. 682, datë 29.06.2020 dhe gjoba nr. 55 datë 07.12.2015 shfuqizuar me VGJA me nr. 130, datë 29.01.2020.

<sup>1</sup> Sanksioni me gjobë nr. 6 datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë, duke qenë se është shfuqizuar me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021, efektet financiare të tij janë pjesë e ecurisë financiare të sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2021.

## 6. QEVERISJA E AUTORITETIT

### 6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet

Lëshimi i licencave/autorizimeve është një nga funksionet kryesore të AMA-s dhe bëhet në bazë të kërkesave të subjekteve, disponibilitetit të frekuencave, kapaciteteve transmetuese dhe në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës. Edhe gjatë vitit 2020, AMA ka ushtruar veprimtarinë e saj kolegjiale, në bazë dhe zbatim të ligjit organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative dhe kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Vendimmarrjet kryesore të AMA-s lidhen me shqyrtimin e aplikimeve për marrje licence/autorizimi për ushtrim veprimtarie audio/audiovizive, shqyrtimin e aplikimeve për rinovimin e licencave/autorizimeve të OSHMA-ve të subjekteve të ndryshëm, shqyrtimin e kërkesave për heqje dorë nga licenca/autorizimi, njoftimet për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesat për marrje licence dhe/ose autorizimi, si dhe shqyrtimin e ankimeve administrative ndaj sanksioneve administrative.

AMA, në ushtrim të funksioneve rregullatore, ka miratuar disa akte nënligjore me të cilat garantohet ofrimi i shërbimeve audiovizive.

Duke qenë se kuadri nënligjor për lëshimin e licencave të transmetimit audio është i plotë, AMA, gjatë vitit 2020, pas studimit të planit të përdorimit të frekuencave radio që shfrytëzohen për transmetime audio, me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur 7 (shtatë) gara për lëshimin e licencave të transmetimit audio analoge, duke përfshirë edhe një licencë transmetimi audio me mbulim kombëtar. Caktimi i frekuencave të transmetimit nga AMA, në çdo rast, ka respektuar parimet e parashikuara në ligj, si objektiviteti, transparenca, mosdiskriminimi, dhe disponueshmëria e frekuencave të lira. Në kuadër të transparencës dhe për t'i dhënë mundësi çdo pale të interesuar për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit, çelja e çdo gare është publikuar në faqen e internetit të AMA-s dhe në disa organe shtypi.

Pas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara, në vijim të shpalljeve publike, AMA:

- Me vendimin nr. 45, datë 25.06.2020, vendosi dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Klan” sh.p.k., për subjektin audio “Radio Klan”.
- Me vendimin nr. 96, datë 14.10.2020, vendosi dhënien e licencës lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për subjektin audio “Saranda Ime Radio”, për të mbuluar me sinjal bashkinë Sarandë.
- Me vendimin nr. 140, datë 10.12.2020, vendosi zgjerimin e zonës së shërbimit të shoqërisë “Radio Logos” sh.p.k., për subjektin audio “Radio Logos”, në “bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Gramsh”.
- Me vendimin nr. 146, datë 17.12.2020, vendosi zgjerimin e zonës së licencës së shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., për subjektin audio “MCN Radio”, në qarqet Elbasan, Fier dhe Vlorë.

Në muajin janar 2020, AMA miratoi rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”, fusha e zbatimit të së cilës është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për dhënien e licencave lokale apo rajonale të shërbimit të programit audioviziv. Në zbatim të këtij akti, gjatë vitit 2020, AMA ka vijuar me çeljen e procedurave për lëshimin e licencave lokale dhe rajonale të shërbimit të programit audioviziv duke çelur 5 (pesë) gara publike për lëshimin e licencave të shërbimit të programit audioviziv, konkretisht në allotmentin Tiranë si dhe allotmentet Fier, Berat dhe Korçë.

Pas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara, në vijim të shpalljeve publike, AMA:

- Me vendimin nr. 132, datë 04.12.2020, vendosi pranimin e aplikimit dhe dhënien e licencës së shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv “ABEG TV” në qarqet Tiranë-Durrës.
- Me vendimin nr. 46, datë 25.06.2020, vendosi pranimin e aplikimit dhe dhënien e licencës së shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv në qarqet Fier, Berat dhe Korçë.
- Me vendimin nr. 28, datë 22.04.2020, vendosi pranimin e aplikimit dhe dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv, shoqërisë “3DS&AF Entertainment” sh.p.k., për qarqet Fier dhe Korçë.

Në kuadër të procesit të digjitalizimit, dhe në zbatim të dispozitave kalimtare të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas mbylljes së transmetimeve analoge qark pas qarku, AMA, me qëllim harmonizimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të licencuar për transmetime analoge me dispozitat e ligjit nr. 97/2013, ka proceduar me zëvendësimin e licencave për transmetime analoge me licencë për shërbimin e programit audioviziv. AMA, gjatë vitit 2020, ka pajisur me licencë shërbimi programi audioviziv, [në qarqet ku gjatë kësaj periudhe janë mbyllur transmetimet analoge, konkretisht “Qarqet Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe Shkodër” (u mbyllën 30 shtator 2020) si dhe “Qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë” (u mbyllën në datë 30 dhjetor 2020)], **18 subjekte të licencuar për transmetime analoge**, pas depozitimit nga ana e tyre të kontratave të mbështetjes në njërën nga rrjetet numerike, publike ose private.

Me mbylljen e transmetimeve analoge në gjithë territorin e vendit, kalimi në transmetimet numerike është pasuar me zëvendësimin e licencës për 35 subjekte audiovizive analoge të cilët kanë depozituar kontratë mbështetjeje me njërën nga rrjetet numerike publike (29 subjekte) ose private.

Nga lista e plotë e subjekteve televizive analoge, 2 subjekte ekzistues kanë shfaqur interes të zëvendësojnë licencën e tyre me autorizim, duke u mbështetur në rrjete të tjera të komunikimeve elektronike si kablllore, internet etj., duke e arsyetuar këtë vendim me pamundësinë e tyre financiare për t’u mbështetur në rrjet numerik.

Ndërkohë, disa subjekteve ekzistues u është hequr ose bërë e pavlefshme, licenca për transmetime televizive analoge, për shkaqe të parashikuara në ligj, detyrime financiare, mosrinovim për mangësi në dokumentacion, mungesë interesi etj.

Ndërsa 2 subjekte të licencuar për transmetim analog në qarkun Elbasan, duke themeluar një shoqëri të përbashkët, mbështetur në parashikimet ligjore, janë pajisur me licencë lokale transmetimi numerik, duke e ndërtuar vetë rrjetin numerik. Për subjektet e qarqeve Vlorë, Kukës, Dibër, që ende nuk kanë depozituar kontratat e mbështetjes, AMA po mban korrespondencë shkresore për depozitimin e tyre.

Gjatë vitit raportues, AMA, në zbatim të parashikimeve ligjore, ka miratuar edhe vendime për mosdhënie licencash/autorizimesh dhe mosrinovim licencash/autorizimesh, si dhe heqje licencash/autorizimesh për disa subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në licencë/autorizim.

Sa i përket aplikimeve për marrje autorizimi, aplikime të cilat shqyrtohen mbi bazë kërkesë, për vitin 2020 rezulton se kanë shfaqur interes 10 subjekte nga të cilët, 9 subjekteve iu është dhënë autorizimi, përsëritës/ofrues në rrjet kabllor/internet IPTV/OTT, ndërsa 1 subjekti i është rrëzuar aplikimi.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, konstatohet se 10 subjekte ekzistues të autorizuar për shërbim kabllor, kanë kërkuar zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit. Po ashtu, një fenomen i vërejtur gjatë 2 viteve të fundit, është edhe kalimi i të drejtave të autorizimit në subjekte të tjerë kabllorë, duke bërë të mundur, në këtë mënyrë, zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjekteve kabllore, që u kanë kaluar të drejtat.

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjektet e licencuar/autorizuar kanë detyrimin që brenda 30 ditëve të njoftojnë AMA-n lidhur me ndryshimet e ndodhura në kërkesën për licencë dhe/ose autorizim, për kalim të drejtash apo për ndryshime në strukturën e pronësisë, brenda të njëjtit subjekt tregtar.

AMA, për të siguruar respektimin e dispozitave të ligjit për strukturën e pronësisë së OSHMA-ve, në mënyrë periodike, ka verifikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), të dhënat mbi ndryshimet e kryera prej ofruesve të shërbimit mediatik audio/audioviziv, për të cilat nuk ishte njoftuar autoriteti rregullator. Në vijim të kontrolleve të kryera, AMA, rast pas rasti, ka ndërmarrë procedimet administrative ndaj OSHMA-ve, duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim si dhe, rast pas rasti, duke vendosur sanksionet përkatëse.

Për vitin 2020, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 1 subjekt, ndryshime të cilat janë miratuar nga AMA. Po ashtu, 8 subjekte kanë njoftuar vetë për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, të cilat janë miratuar nga Autoriteti. Ndërkohë, për 6 subjekte, AMA ka miratuar kalimin e të drejtave të licencës/autorizimit.

Theksojmë se në shumicën e rasteve ndryshimet kanë ndodhur brenda vetë strukturës së ortakëve, por ka edhe raste të kalimit të të drejtave nga person fizik në person juridik, të cilat janë iniciuar nga AMA.

AMA vëren një ndërgjegjësim më të madh të subjekteve audio/audiovizive për respektimin e kuadrit ligjor në fuqi për njoftimin e ndryshimeve, pasi, gjatë periudhës raportuese, rezulton se pjesa më e madhe e subjekteve kanë njoftuar Autoritetin mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë, brenda afatit të përcaktuar në kuadrin ligjor, 30 ditë nga kryerja e tyre.

Gjatë vitit 2020, për aplikimet për licencë/autorizim, Autoriteti ka vendosur:

- Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge për 1 subjekt, zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 3 subjekte;
- Dhënien e licencës së transmetimit audioviziv lokal numerik për 1 subjekt dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 2 subjekte;
- Dhënien e autorizimit për 9 subjekte nga të cilët 6 subjekte për përsëritjen e shërbimit të programit, për 3 subjekte ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv si dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit për 10 subjekte të autorizuar;
- Rinovimin e autorizimit për 20 subjekte (përsëritës/ ofrues në rrjete kabllorë/ internet IPTV dhe OTT/satelit);
- Rinovimin e licencës për 13 subjekte audio;
- Pajisjen me licencë shërbimi programi audioviziv për 18 subjekte;
- Heqjen e licencës për transmetime televizive dhe radio për 1 subjekt, mosdhënien e licencës për 1 subjekt, mosrinovimin e licencës/autorizimit për 4 subjekte dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës/autorizimit për 7 subjekte;
- Zgjerimin e zonës së autorizimit për 9 subjekte, zgjerimin e zonës së licencimit për 2 subjekte radio dhe rrëzimin e aplikimit për zgjerim zone për 4 subjekte;
- Miratimin e ndryshimeve në të dhënat e ndodhura në kërkesën për marrje licence/autorizimi për 15 subjekte duke përfshirë në këtë numër edhe kalimin e të drejtave të licencës/autorizimit (6 subjekte);
- Ndryshime të ndodhura në emrin/logon për 6 subjekte.

### **Proceset gjyqësore**

E drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor i njihet çdo subjekti që preket nga një vendimmarrje e AMA-s, si organ kolegjial, si nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative dhe legjislacioni material dhe procedural në fuqi.

Gjatë vitit 2020, AMA ka qenë palë e paditur në procese gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të ndryshme, kryesisht me subjekte audio/audiovizive. Në pjesën më të madhe ankimohen në gjykatë vendimet e AMA-s, lidhur me mosdhënie licence/autorizimi, mosrinovim licence/autorizimi, sanksione administrative (gjoba) etj. Edhe AMA, si person juridik ka investuar, në disa raste, organet gjyqësore duke kërkuar gjyqësisht shlyerjen e detyrimeve financiare të subjekteve që rezultojnë debitorë ndaj AMA-s ose Buxhetit të Shtetit. Ecuria e proceseve gjyqësore në të gjithë shkallët e gjykimit, gjatë periudhës raportuese, është ndikuar edhe prej situatës së shkaktuar prej infeksionit COVID-19, pasi për një periudhë kohore rreth 3 muajore janë pezulluar gjykimet në gjykatat e vendit.

Si në vitet e kaluara edhe gjatë këtij viti, ekzekutimi i vendimeve të AMA-s të shndërruara në tituj ekzekutivë, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbarimor. Për vitin 2020, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 79 titujve ekzekutivë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

AMA, gjatë kësaj periudhe, përveç ndjekjes së proceseve të iniciuara gjatë vitit raportues, ka vijuar ndjekjen e proceseve gjyqësore të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatat e Apelit apo Gjykatën e Lartë.

Informacion i detajuar mbi proceset gjyqësore ku është palë AMA, jepet në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij Raporti.



## 7. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

### 7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

Gjatë vitit 2020 janë kryer monitorime dhe shqyrtime të tematizuara të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara nga OSHMA-të. Ato janë fokusuar në:

- mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme;
- reklamat mbi pijet e gazuara dhe me sheqer të shtuar;
- respektimin e masave për mbrojtjen e personelit në redaksitë audiovizive nga COVID -19;
- programet dedikuar dinamikës së pandemisë;
- gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit.

Për rastet e identifikuar që nuk respektonin kërkesat e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kodit të Transmetimit të AMA-s apo akteve të tjera nënligjore në fuqi, OSHMA-ve respektive u janë dërguar tërheqje vëmendjeje.

Konkretisht, nga monitorimet dhe shqyrtimet e tematizuara, janë identifikuar 10 raste që nuk kanë respektuar kërkesat e kuadrit ligjor:

- 4 raste (40 për qind), për mosrespektimin e kërkesave për mbrojtjen e fëmijëve;
- 3 raste (30 për qind), për mosrespektim të udhëzimeve të autoritetit shëndetësor për pjesëmarrjen e personave në studio;
- 2 raste (20 për qind), për qëndrime joetike në trajtimin e problematikave mbi pandeminë COVID-19.
- 1 rast (10 për qind), për përdorim të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit ndaj refugjatëve nga Lindja e Mesme.

| Nr. | Kategoria e shkeljes                                                                         | OSHMA-të    | Emisioni                      |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------------------------|
| 1   | Mosrespektimi i kërkesave për mbrojtjen e fëmijëve                                           | BBF         | Transmetim i pjesëve muzikore |
|     |                                                                                              | Melodi Tv   |                               |
|     |                                                                                              | Supersonic  |                               |
|     |                                                                                              | My Music    |                               |
| 2   | Mosrespektimi i udhëzimeve të autoritetit shëndetësor për pjesëmarrjen e personave në studio | Klan        | “Klanifornia”                 |
|     |                                                                                              | Top Channel | “Portokalli”                  |
|     |                                                                                              | Ora News    | “360 Gradë”                   |
| 3   | Qëndrime joetike në trajtimin e problematikave mbi pandeminë e COVID-19                      | Top Channel | “E diell”                     |
|     |                                                                                              | ABC News    | “ABC e mëngjesit”             |
| 4   | Përdorim i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit ndaj refugjatëve nga Lindja e Mesme         | ABC News    | “Edicion informativ”          |

## 7.2 Monitorimet e përmbajtjeve


Për monitorimin e transmetimeve digjitale në Studion e Monitorimit dhe Arkivës së AMA-s, gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, kanë qenë në regjistrim 48 njësi regjistrimi, ku përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor dhe Abcom.

*Në terma statistikorë, në total, gjatë këtij viti, janë regjistruar:*

- në transmetimet digjitale, në total, janë regjistruar **410 000** orë transmetime audiovizive dhe rreth **30 000** orë transmetime audio

që, krahasuar me vitet e mëparshme, janë si më poshtë:

| Vite                        | 2015   | 2016   | 2017    | 2018    | 2019    | 2020    |
|-----------------------------|--------|--------|---------|---------|---------|---------|
| Orë regjistrime televizione | 69,000 | 70,000 | 142,000 | 178,000 | 299,500 | 410,000 |
| Orë regjistrime radio       | 5,000  | 5,000  | 5,650   | 15,700  | 26,200  | 30,000  |



*Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, Studioja e Monitorimit kryen edhe monitorimin e:*

A. Edicioneve informative;

*Në subjektet audio dhe audiovizive kombëtare janë monitoruar rreth **2,600 edicione informative** (1,500 edicione të subjekteve audiovizive kombëtare dhe 1100 edicione të subjekteve audio kombëtare.*

B. Reklamave;

*Për monitorimin e reklamave në subjektet audiovizive kombëtare janë rreth **25,500 orë** programe të monitoruara*

*Sa i takon monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, nga AMA realizohet vlerësimi i një edicioni në ditë, si bartës i linjës editoriale. Të dhënat sasiore të proporcionalitetit kohor, në edicionet informative kryesore, publikohen rregullisht çdo muaj në faqen zyrtare të institucionit, në një rubrikë të veçantë.*

Shqyrtimin e ankesave nga publiku dhe nga operatorët;


*Gjatë vitit 2020, në Studion e Monitorimit dhe Arkivës, kanë ardhur për ndjekje 11 kërkesa/ ankesa nga publiku, për marrje informacioni të regjistrimeve.*

*Gjatë vitit 2020 janë kryer në Studion e Monitorimit dhe Arkivës 200 orë regjistrime të subjekteve OSHM audio, për shqyrtime të përmbajtjes së programeve.*

Krahasuar me vitet e mëparshme, të dhënat janë si më poshtë :


**A. Monitorime edicione lajmesh**

| Kategoria e OSHMA-ve | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|----------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Televizione          | 900       | 900       | 1,340     | 1,500     | 1,500     | 1,500     |
| Radio                | 600       | 600       | 770       | 1,000     | 1,100     | 1,100     |




#### B. Monitorime reklamash

| Kategoria e OSHMA-ve           | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|--------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Subjekte audiovizive kombëtare | 14,000    | 14,000    | 16,000    | 17,500    | 17,500    | 25,500    |



### C. Monitorime për të drejta transmetimi

| Kategoria e OSHMA-ve          | Viti 2017 | Viti 2018 | Viti 2019 | Viti 2020 |
|-------------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| Televizione lokale            | 6,700     | 1,500     | 560       | -         |
| Platformat DigitAlb dhe Tring | 2,100     | -         | 860       | 580       |



Gjatë vitit 2020, treguesit sasiorë të monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, RTSH1, Top Channel, Klan dhe Vizion Plus, Radio Tirana, Top Albania Radio dhe Club FM, janë publikuar çdo muaj nga AMA, në versionin virtual, në një rubrikë të veçantë të faqes zyrtare online, si dhe do të përfshihen në Buletin Periodik vjetor. Në Aneksin 2 paraqiten, përmbledhtas, të dhënat për vitin 2020.

### 7.3 Qasja ndaj dukurisë së piraterisë në transmetimet audiovizive

Një tjetër përmasë e rëndësishme e punës sonë, për vitin 2020, ka qenë pirateria përmes internetit. Është një sfidë e re për Autoritetin, duke qenë se kjo lloj teknologjie e përdorur nga ISP (ofruesit e shërbimit të internetit) është shumë e sofistikuar dhe kërkon investime në teknologji dhe në burime njerëzore të kualifikuara. Me qëllim luftimin e dukurisë së piraterisë nëpërmjet internetit, AMA, në strategjinë e sa, ka vendosur një objektiv të veçantë në shtimin e kapaciteteve teknike si dhe të trajnimit të burimeve njerëzore, që do t'i vijnë në ndihmë për evidentimin dhe reduktimin e numrit të rasteve të piraterisë online. Megjithatë, bashkëpunimi me institucione të tjera si AKEP-i, Policia e Shtetit etj., është i domosdoshëm për të sjellë një qasje tjetër sa i përket këtij fenomeni. AMA, edhe pse në mungesë të marrëveshjes së bashkëpunimit me institucionin e AKEP-it, ka kryer verifikime në terren nëpërmjet grupeve të veta të inspektimit, për identifikimin e aktiviteteve të paligjshme, që kryhen përmes internetit nga subjektet ISP.

Sikurse është raportuar, AMA, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis AMA-s dhe AKEP-it dhe nënshkrimin e saj. Mungesa e reagimit nga ky autoritet, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura, nuk i shërben qëllimit tonë të përbashkët për garantimin e konkurrencës së ndershme në treg dhe parandalimit të dukurisë së piraterisë televizive dhe informalitetit në këtë fushë.

## 8. KËSHILLI I ANKESAVE

### *Shqyrtimi i ankesave*

Në përmbushje të detyrave, objektivave të përcaktuara, angazhimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, gjatë vitit 2020, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe të rregulloreve të miratuara nga AMA.

Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar, me vëmendje dhe profesionalizëm, ankesat e dërguara në AMA, si dhe ka shtuar kontaktet (on line, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19) me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, me agjencitë dhe organizatat për mbrojtjen e fëmijëve: - në veçanti me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, si një agjenci e cila ndjek drejtpërdrejt problemet që lidhen me fëmijët, duke i referuar pranë Këshillit të Ankesave rastet e evidentuara në mediat audiovizive; - si dhe me aktorë dhe faktorë të rëndësishëm në fushën e mediave audiovizive.

Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe propozuar masat përkatëse për dhjetëra ankesa, të dërguara në AMA nga qytetarë, institucione dhe organizata të ndryshme, mbi probleme të përmbajtjeve audiovizive.

Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave, të ardhura përmes postës zyrtare, postës elektronike apo faqes së internetit të AMA-s, kishin si objekt të tyre shkeljen e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenimin e dinjitetit, si dhe disa ankesa të shtuara ndaj rrjeteve sociale, portaleve dhe gazetave.

Këshilli i Ankesave është kujdesur që, në çdo rast, ankuesit të merrnin një përgjigje paraprake, para se të njihen me konkluzionet përfundimtare, brenda afateve të parashikuara ligjore.

Gjithsej, gjatë gjithë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar 123 ankesa; pjesa më e madhe e tyre janë dërguar pranë Autoritetit nga individë dhe shoqata e organizata të shoqërisë civile.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave u ka tërhequr vëmendjen operatorëve në 36 raste; në dy raste u ka kërkuar atyre zhvendosjen e orarit të transmetimit për dy seriale filmike, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit. Operatorët reagues në një kohë të shpejtë, duke marrë në konsideratë respektimin e kërkesave dhe normave etike e ligjore të Kodit të Transmetimit.

Sipas objektit, ankesat paraqiten si më poshtë:

- 39 me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 41 me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, etikës dhe moralit publik;
- 19 rezultuan jashtë objektit të punës së AMA-s, përcaktuar nga ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 2 për të drejtën e përgjigjes;
- 2 për verifikim informacioni;
- 20 ankesa kishin objekt të ndryshëm.

## **Aktivitetet**

Në zbatim të objektivave, të prioriteteve të përcaktuara nga Këshilli i AMA-s dhe të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, veç procesit të përditshëm të marrjes dhe trajtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në disa aktivitete të përbashkëta me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë.

-Gjatë vitit 2020, në muajin shkurt, Këshilli i Ankesave ishte pjesëmarrës në aktivitetin me temë “Barazia gjinore dhe integrimi në BE - Roli i medias në promovimin e barazisë gjinore dhe raportimit me ndjeshmëri gjinore”.

Aktiviteti i zhvilluar në kuadër të projektit “Asistenca Teknike për Agjendën e Barazisë Gjinore në Shqipëri në procesin e pranimi në Bashkimin Evropian”, i financuar nga Bashkimi Evropian, kishte për qëllim të mbështesë punën e qeverisë shqiptare mbi barazinë gjinore, duke rritur mbështetjen institucionale në nivel qendror dhe lokal dhe duke promovuar një platformë të përbashkët për të nxitur veprimet mbi përparësitë e barazisë gjinore.

-Në qershor 2020, Këshilli i Ankesave ishte pjesëmarrës në Webinarin e organizuar nga ERGA (The European Regulators Group for Audiovisual Media Services), mbi “Kodin e Praktikës dhe Dezinformimin”. Në këtë takim virtual u diskutua gjerësisht mbi fenomenin e “fake news” dhe mënyrat për të kontrolluar faktet mbi informacionin, përpara se ai të publikohet, si dhe ndihma që u ofron gazetarëve për këtë qëllim Kodi i Praktikës.

-Në korrik 2020, Këshilli i Ankesave mori pjesë virtualisht në një tjetër Webinar, me temën “Zgjedhjet, pandemia dhe dezinformimi”, ku edhe AMA raportoi mbi punën e kryer në kushtet e izolimit të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 dhe situatën në mediat audiovizive, pas kufizimeve anti-COVID.

-Në shtator 2020, Këshilli i Ankesave mori pjesë në një trajnim të organizuar në Tiranë nga UNICRI (me numër të kufizuar pjesëmarrësish) mbi “Lidhjen (Nexus) midis Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Terrorizmit”. Në këtë trajnim u diskutuan mbi praktikën e mira, sigurinë që komunitetet të kenë ose të marrin akses në shërbimet bazike, si dhe forcimin e skemave të punësimit dhe zhvillimit përmes iniciativave ekonomike, ndihmuar nga informimi që japin për çështje të tilla operatorët audiovizivë.

-Po në shtator, Këshilli i Ankesave mori pjesë në Webinarin e EPRA-s, “Politikat evropiane digjitale dhe TV” ( "EU digital policies & TV"). E ardhmja e mediave audiovizive në kuadrin e Shërbimeve Digjitale, Plani i Veprimit të Demokracisë Evropiane, ndikimi i industrisë së medias nga inovacionet teknologjike, platformat rregullatore dhe kuadri ligjor ishin çështjet e diskutuara nga pjesëmarrësit referues. Aksesit i kushtëzuar dhe filtrimi i informacionit përmes shërbimeve digjitale ishin alternativat e diskutuara për përmirësimin e informimit online.



-Gjatë vitit 2020, Këshilli i Ankesave ka përfaqësuar Autoritetin e Mediave Audiovizive në të gjitha takimet e organizuara në kuadër të SELP (Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut), ku AMA ka një rol kryesor për njohjen e publikut të gjerë me kuadrin ligjor për transmetimet audiovizive, në veçanti me Kodin e Transmetimit. Kemi informuar Rrjetin e SELP se, përgjatë këtij viti (2021) është parashikuar një anketim për Kodin e Transmetimit për median audiovizive, përfundimet e të cilit do të na shërbejnë për procesin e përmirësimit të këtij dokumenti të rëndësishëm.

### ***Buletini i Ankesave***

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave hartoi dhe publikoi Buletinin nr. 6, që përmban ankesat e ardhura dhe të trajtuara për periudhën janar-qershor 2019, deri në muajin qershor 2019, ndërkohë që është drejt fundit procesi për hartimin dhe publikimin e Buletinit nr. 7, që reflekton të gjitha rastet e shqyrtuara për periudhën korrik-dhjetor 2019.

Në Buletinin nr.6, që gjendet në faqen zyrtare të internetit të AMA-s, janë publikuar shqyrtimet dhe masat përkatëse mbi ankesat e adresuara në AMA, kryesisht për cenim dinjiteti, shkelje të të drejtave të fëmijëve, reklamat e ndaluara etj. Mendojmë se ky Buletin, por edhe të tjerët, shërbejnë si udhërrëfyes për çdo OSHMA, që mund të përballet në të ardhmen me raste të ngjashme.

### ***Gjuha e shenjave në transmetimet audiovizive***

Këshilli i Ankesave, që prej muajit tetor të vitit 2017, ka iniciuar një komunikim shkresor, dhe jo vetëm, me operatorët audiovizivë me licencë kombëtare mbi përmbushjen e detyrimit ligjor që këta operatorë kanë për atë që njihet si “gjuha e shenjave”. Pra, për plotësimin e detyrimit që ligji nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon për “komunitetet me nevoja të veçanta shqisore”.

Duke i konsideruar tepër të rëndësishme transmetimet për personat me nevoja të veçanta shqisore, Autoriteti ka pasur komunikime të herëpashershme shkresore me 3 prej 4 operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare: “Top Channel”, “Klan” dhe “Vizion +”, por për fat të keq, nuk mori përgjigje apo reagim pozitiv prej tyre, edhe pse u janë vendosur disa herë afate për të njoftuar “marrjen e masave për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor”.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, transmeton një edicion informativ me gjuhën e shenjave.

Konkretisht, tre operatorëve të mësipërm u janë dërguar shkresa disa herë - për dijeni edhe Kuvendit – ku, veç përsëritjes së kërkesës për përmbushjen e detyrimit ligjor që këta operatorë kanë për “gjuhën e shenjave”, u është bërë e ditur se “mungesa e transmetimeve me gjuhën e shenjave përbën shqetësim edhe për Kuvendin e Shqipërisë, i cili e ka përfshirë këtë çështje në rekomandimet kryesore për AMA-n”.

Edhe gjatë vitit 2020, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ka vijuar komunikimet me operatorët audiovizivë kombëtarë, në lidhje me zbatimin e këtij detyrimi. Po gjatë këtij viti, AMA ka komunikuar shkresërisht, në disa raste, edhe me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të cilit i është vendosur në dispozicion i gjithë informacioni i kërkuar prej tij. Duhet theksuar se, në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka parashikime për sanksione ndaj operatorëve audiovizivë për këtë çështje.

AMA e përfshiu për diskutim këtë çështje në mbledhjen e Këshillit të Autoritetit, të datës 12 nëntor 2020. Në përfundim të kësaj mbledhjeje, Këshilli i AMA-s apeloj ndaj operatorëve me licencë kombëtare për zbatimin e këtij detyrimi të rëndësishëm që ata kanë. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me operatorët, këta të fundit i parashtruan AMA-s shqetësimin për mungesën e interpretëve të gjuhës së shenjave. Operatori audioviziv “Tv Klan” kishte kërkuar bashkëpunimin e Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë për t’u ardhur në ndihmë me persona që mund të ofrojnë interpretimin në ekran të gjuhës së shenjave. Por vetë Shoqata, në përgjigje të kësaj kërkeje, ka vënë në dijeni operatorin audioviziv se “nuk ka persona që mund ta ofrojnë këtë shërbim të përditshëm...”, pra, interpretimin me gjuhën e shenjave.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1074, datë 23.12.2015, sipas të cilit “Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë” (pika 15, kreu II); dhe “Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimi të gjuhës së shenjave shqipe” (pika 16, kreu II); Autoriteti i Mediave Audiovizive u sugjeroi dy ministrive përkatëse (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) nxitjen dhe marrjen e masave të mëtejshme për konkretizimin e transmetimeve audiovizive për personat me nevoja të veçanta shqisore, përmes përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave. Ende nuk kemi një reagim nga dy ministrinë e sipërpërmendura.

## 9. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

### 9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për transmetimet audio/audiovizive.

Roli, funksionet dhe kompetencat e autoritetit rregullator përcaktohen në legjislacionin e posaçëm, ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Po ashtu, veprimtaria e AMA-s normohet nga tërësia e akteve ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë politikat e zhvillimit të sektorit audioviziv, rekomandimeve të Kuvendit, aktet nënligjore të miratuara nga AMA etj.

### 9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

Gjatë vitit raportues, ka vijuar puna administrative për hartimin e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMA-s, për të garantuar përmbushjen e objektivave të Autoritetit. Bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 97/2013, sipas të cilit “1. AMA, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik”, procesi i hartimit të akteve nënligjore rregullatore i është nënshtruar konsultimit të gjerë publik, në të cilin palët e interesuara kanë pasur mundësinë të paraqesin sugjerime e propozime konkrete.

Gjatë vitit 2020, janë miratuar 2 akte nënligjore, ndërkohë që ka përfunduar procesi i këshillimit publik dhe janë në fazën e miratimit nga Autoriteti edhe 2 akte të tjera nënligjore.

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Vendimi i AMA-s, nr. 1, datë 16.01.2020 “Për dhënien e licencave të transmetimit për periudhë të përkohshme dhe për nevoja institucionale”. Ky akt nënligjor përmbush detyrimin ligjor të parashikuar në nenet 77 dhe 78 të ligjit organik si dhe hap rrugën për plotësimin e nevojave për licencë transmetimi audio për qëllime të përkohshme, që mund të jenë kulturore, sociale etj., si dhe për nevoja të institucioneve arsimore apo shëndetësore.
- Vendimi i AMA-s nr. 2, datë 16.01.2020 “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv”. Në këtë akt nënligjor përcaktohen në mënyrë të detajuar kërkesat, kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencës së shërbimit të programit audioviziv. Miratimi i këtij akti ka plotësuar bazën ligjore për lëshimin e licencave të shërbimit të programit, duke mundësuar hyrjen në tregun audioviziv edhe të aktorëve të rinj të interesuar për këtë aktivitet.

Ndërkohë, janë në fazën e miratimit nga AMA aktet e mëposhtme nënligjore:

- Rregullore “Për kriteret dhe masat që rregullojnë bashkëpërdorimin e infrastrukturës transmetuese të transmetuesit publik”, që synon përmbushjen e objektivave nga transmetuesit e shërbimit publik, si dhe rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive.
- Udhërrëfyes (rregullore) për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve të mediave audio dhe/ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik që përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv dhe OSHMA-ve, lidhur me shfrytëzimin e multipleksit, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Po ashtu AMA, ka miratuar pas kërkesave nga Radiotelevizioni Shqiptar:

- Vendim nr. 25, datë 15.04.2020, “Për miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetuesit publik për çeljen e shërbimit programor Tirana Jazz”.
- Vendim nr. 97, datë 14.10.2020, “Për dhënien në përdorim të frekuencave 90.5 Mhz dhe 91.5 Mhz radiotelevizionit shqiptar për mbulimin me sinjal audio të zonës së shërbimit të bashkive Himarë (për radio Tirana 1) dhe Pogradec (për radio Korça)”.
- Vendim nr. 98, datë 14.10.2020, “Për miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetuesit publik, për çeljen e shërbimit audio të transmetuesit publik “Radio Tirana Fëmijë”.
- Vendim nr. 99, datë 14.10.2020, “Për miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetuesit publik për çeljen shërbimit të transmetuesit publik “RTSH Kukësi”.
- Vendim nr. 100, datë 14.10.2020 “Për miratimin e shtojcës së kontratës së transmetuesit publik për ndryshimin e emrit të shërbimit programor “RTSH Fëmijë 2” në “RTSH Shkollë”.
- Vendim nr. 44, datë 25.06.2020, “Për miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetuesit publik (karakteristikat teknike të rrjeteve numerike dhe stacioneve radio FM)”.

### **9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit**

Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila është e transpozuar plotësisht në ligjin nr. 97/2013, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. (Direktiva 2018/1808), datë 14.11.2018). Këto ndryshime përfshijnë, ndër të tjera, disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve; ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare, rregulla të reja për platformat online, promovimin e veprave evropiane etj.

Në kuadër të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*” është detyrim për Shqipërinë dhe aktorët kryesorë të procesit të transpozimit të legjislacionit të BE-së, në fushën e mediave audiovizive, në Republikën e Shqipërisë, janë Kuvendi dhe ministri i linjës, që mbulon fushën e komunikimeve elektronike. AMA, gjithashtu, do të japë kontributin e saj në procesin e transpozimit të ndryshimeve në legjislacionin kombëtar.

## **9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave**

Në kuadër të finalizimit të procesit të digjitalizimit, fokusi kryesor, gjatë vitit 2020, sa i takon mbikëqyrjes së shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, ka qenë monitorimi në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës numerike nga operatorët privatë kombëtarë audiovizivë, identifikimi i mbulimit me sinjal numerik audioviziv të territorit të vendit si dhe verifikimi i mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonalë në rrjetet kombëtarë numerike.

Nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit, në përfundim të procesit të digjitalizimit, rezulton se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara të vendit, si më poshtë:

### **1. OPERATORI PUBLIK SHQIPTAR, RTSH**

#### ***QARKU BERAT***

- Lagjet mbas Kalasë së Beratit
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çepan.

*Rreth 5 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### ***QARKU KORÇË***

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Çerrave (qendër)
- Njësia administrative Mokërr (pjesërisht)
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### ***QARQET TIRANË – DURREËS***

- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### ***QARKU ELBASAN***

- Komuna Labinot ( Fushë-Xibrakë)

- Njësia administrative Qukës (pjesërisht)
- Njësia administrative Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë).

*Rreth 1 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU VLORE**

- Njësia administrative Borsh (pjesërisht)
- Njësia administrative Himarë (pjesërisht)
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç).

*Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU SHKODËR**

- Njësia administrative Ana e Malit.
- Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht).
- Njësia administrative Kelmend.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU GJIROKASTËR**

- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagore
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull i sipërm
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU DIBËR**

- Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
- Njësia administrative Sllovë, Kala e Dodës.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU KUKËS**

- Njësia administrative Lek Bibaj.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

## **2. SHOQËRIA “MEDIA VIZION”**

### **QARKU BERAT**

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Polican
- Njësia administrative Çorovodë.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **QARKU KORÇË**

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Cërravë
- Njësia administrative Mokër.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **QARKU TIRANË**

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndroq.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **QARKU DURRËS**

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **QARKU SHKODËR**

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Vau i Dejes
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana- Malit.

*Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU KUKËS*

- Njësia administrative Bajram Curri
- Njësia administrative Has.

*Rreth 12 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU PESHKOPI*

- Njësia administrative Peshkopi
- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

*Rreth 41 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU LEZHË*

- Njësia administrative Rrëshen.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU ELBASAN*

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd
- Njësia administrative Qukës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

*Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU GJIROKASTËR*

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*



#### **QARKU VLORE**

- Njësia administrative Delvinë
- Njësia administrative Dhërmi
- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës ( Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).

*Rreth 7 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **3. SUBJEKTI TV “KLAN”**

#### **QARKU KORÇË**

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Mokër.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU TIRANË**

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë.
- Njësia administrative Ndroq.

*Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU DURRËS**

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU SHKODËR**

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Vau i Dejës
- Njësia administrative Fushë – Arrëz
- Njësia administrative Ana e Malit.

*Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU GJIROKASTËR**

- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 25 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU VLORE**

- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës ( Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaë, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).

*Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

### **4. SUBJETET TV “TOP –CHANNEL”, “DIGITALB” DHE “ADTN”**

#### **QARKU BERAT**

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Poliçan (DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Çorovodë.

*Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU KORÇË**

- Njësia administrative Ersekë
- Njësia administrative Leskovik
- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Cërravë
- Njësia administrative Mokër.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### **QARKU FIER**

- Pjesërisht Bashkia Divjakë.

*Rreth 0.3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU TIRANË*

- Bashkia Kavajë
- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndroq
- Pjesërisht Bashkia Vorë.

*Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU DURRËS*

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU SHKODËR*

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Vau i Dejës
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana- Malit.

*Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU KUKËS*

- Njësia administrative Bajram Curri
- Bashkia Kukës
- Njësia administrative Has.

*Rreth 75 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU PESHKOPI*

- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Peshkopi (DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

*Rreth 41% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU LEZHË*

- Njësia administrative Rrëshen.

*Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU ELBASAN*

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Qukës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

*Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU GJIROKASTËR*

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

*Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

#### *QARKU VLORE*

- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Selenicë
- Njësia administrative Himarë (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Dhërmi (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Konispol.
- Njësia administrative Delvinë (“DIGITALB” DHE “ADTN”).
- Fshatrat e lumit të Vlorës ( Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuc, etj.).

*Rreth 16 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.*

Në nivel kombëtar përqindja e popullsisë e pambuluar me shërbim audioviziv numerik është paraqitur në tabelën si vijon për çdo operator.

| <b>Nr.</b> | <b>Subjekti</b> | <b>Përqindja e popullsisë e pambuluar me shërbim audioviziv numerik</b> |
|------------|-----------------|-------------------------------------------------------------------------|
| 1          | RTSH            | 2.8%                                                                    |
| 2          | TV Klan         | 3%                                                                      |
| 3          | Top Channel     | 11%                                                                     |
| 4          | Digitalb        | 11%                                                                     |
| 5          | Media Vizion    | 7.5%                                                                    |
| 6          | ADTN            | 11%                                                                     |

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, është kryer monitorim i shfrytëzimit të spektrit audio, në sistemin e qendëruar të monitorimit, si dhe në terren, në kuadër të ankesave të paraqitura në AMA për interferencë, si dhe në kuadër të çeljes së garave për frekuenca audio FM, për të identifikuar nëse frekuencat e propozuara për çelje gare janë të pastra nga ndërhyrje të ndryshme nga vendet fqinjë apo ndërhyrje të brendshme.

## **10. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV**

### **10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv**

Në zbatim të objektivave të veprimtarisë së AMA-s, e cila, ndër të tjera, mundëson dhe nxit zhvillimin teknologjik dhe zbatimin e tij në sektorin e transmetimit, është parashikuar, në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Autoritetit, për vitet 2021-2023, rregullimi i teknologjive të reja në shërbimet e transmetimit audio, me qëllim, sigurimin e një kuadri rregullator, që do të rregullojë teknologjinë e re T-DAB (Terrestrial Digital Audio Broadcasting - Transmetimet Tokësore Audio Digjitale). Implementimi i kësaj teknologjie do të rrisë cilësinë e shërbimit, diversifikimin e programacionit të shërbimit audio, si dhe do të sjellë zhvillim ekonomik për vendin.

Radioja ka një rol të rëndësishëm social, kulturor dhe demokratik në zhvillimin e një shoqërie. Zhvillimi i këtij sektori do t'i përgjigjet sfidave teknologjike dhe do të mundësojë ndryshimet e nevojshme për dëgjuesit.

Në krahasim me transmetimet audio FM, radio digjitale ofron shumëllojshmëri përzgjedhjeje për dëgjuesit, përmirëson përdorimin efikas të spektrit frekuencor (deri në 18 shërbime në një frekuencë të vetme) dhe zgjeron diapazonin e shërbimeve të reja si ofrimin e të dhënave (data).

Ndërkohë, rregulloret e AMA-s kanë liberalizuar futjen e shërbimeve të reja në treg, duke lehtësuar barrierat hyrëse për të gjithë subjektet e interesuar për ofrimin e shërbimeve të reja, sikurse është shërbimi OTT. Për pasojë, është rritur dhe diversifikuar gama e operatorëve në tregun e përmbajtjeve audiovizive.

Tashmë kemi dy platforma në teknologjinë e transmetimeve OTT si “RTSH Tani” dhe “KLANI IM”, të cilët mundësojnë ndjekjen e kanaleve televizive tokësore jo vetëm nëpërmjet televizorit, por edhe në çdo ekran tjetër të pajisjeve të ndryshme elektronike, si telefona smart me sistem Android apo iOS, tablet, laptop apo kompjuter, në përdorim nga çdo moshë e kategori dhe, në mënyrë të veçantë, nga të rinjtë.

### **10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore**

Më 26 tetor 2020, në mjediset e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit zhvilloi konferencën shkencore “Cilësia e lajmeve të transmetuesve televizivë shqiptarë”. Ky projekt studimor shkencor u mbështet nga AMA, në vijim të bashkëpunimit mes dy institucioneve publike, prej vitit 2015.

Gjatë konferencës u prezantuan komponentë nga të dhënat e përfthuara prej monitorimeve, të zhvilluara për një periudhë 4 javore, në edicionet informative të subjekteve kombëtare dhe ato lokale e rajonale, duke vlerësuar shpejtësinë dhe aktualizimin e lajmeve, gjeografinë e tyre, diversitetin, multimedialitetin, objektivitetin, gjinitë e raportimeve dhe kohëzgjatjen.

Disa nga temat kryesore ku u përqendruan referentët gjatë konferencës ishin: “Cilësia e informacionit në RTSH”; “Format e reja të paraqitjes së informacionit në një edicion informativ”; “Gjenerata Z dhe lajmet televizive”; “Dominimi i informacioneve nga zyrat e shtypit në edicionet informative: Rasti i TV Vizion Plus”; “ABC News – Politika si lajm, gazetari si zëdhënës dhe qasja e munguar drejt teknologjive të reja”; “Cilësia e përmbajtjes informative dhe raporti me audiencat: Rasti i TV Klan”; “Informimi si indikator i shkëputjes vlerore të audiencave nga modeli i mediave konvencionale në Shqipëri”; “Ndikimi i kontekstit social-politik mbi informacionin masiv në televizionet shqiptare”; “Përfaqësimi dhe karakteri i çështjeve sociale në edicionet informative të A2CNN”; “Lajmi ekonomik në median audiovizive” etj.

Parashtrimet dhe problematikat e identifikuara gjatë konferencës shkencore janë përmbledhur në një publikim të veçantë për të gjithë të interesuarit, në radhë të parë për përfaqësuesit e OSHMA-ve, studiuesit dhe kërkuesit e fushës, studentët, atyre që ndjekin dinamikën dhe performancën e tregut audioviziv, sidomos për përmbajtjet e transmetuara në edicionet informative.

### **10.3 Bashkëpunimi në rregullimin e tregut audioviziv**

Në vijim të bashkëpunimit me partnerët, AMA ka mbështetur projektin e përkthimit në shqip të botimit “Writing and Reporting News – A Coaching Method”, me autore Carole Rich. Botimi në origjinal përbën pjesë të një spiraleje ribotimesh (edicionesh) dhe versioni që iu soll lexuesit shqiptar ishte Edicioni 8, (viti 2016), i cili është një miksim mes atyre parimeve që janë të pandryshuara në tregun mediatik, si dhe pjesëve të përshtatura bazuar në ndryshimet e fundit. Ai ka rëndësi për bibliotekën e redaksive audio dhe audiovizive, për studentët dhe pedagogët e gazetarisë dhe komunikimit, por dhe për kërkuesit dhe ekspertët e fushës së medias dhe ata që pëlqejnë këtë fushë sepse prezantohet koloriti në industrinë mediatike – nga klasikja te bashkëkohorja, ajo që thirret si konvergjenca dhe multimedialiteti në performancën e redaksive – produkti në hapësirat virtuale, fluksi i informimit dhe argëtimit nga rrjetet sociale etj. Prezantohet tipari i interaktivitetit në media, çka e bën produktin më të larmishëm dhe konsumatorin e produktit më aktiv në përmbajtje dhe formë.

Në përpjekjet që ka bërë e bën Autoriteti për pasurimin e bibliotekës në fushën e medias, po gjatë muajit nëntor 2020, nisi një proces për realizimin e një projekti për sjelljen në gjuhën shqipe të botimit “Post Truth: The New War of Truth and How to Fight Back”, (viti 2017), teksti origjinal është nga Ebury Press i Penguin Random House, në Britaninë e Madhe.

Publikimi përfshin aspekte tërheqëse, për të cilat duhet një debat gjithëpërfshirës, nga vetë media, nga institucionet, vendimmarrësit, qytetarët, grupet e interesit. Rritja e masës së informacionit që ka burim nga media klasike, ajo e re dhe rrjetet sociale, nuk po shoqërohet me cilësi të këtij informacioni, duke krijuar ndikime që, në jo pak raste, kanë deformuar demokracinë, duke e bërë atë dhe më pak funksionale, pavarësisht përvojës dhe traditës së një sërë vendeve perëndimore. Post e vërteta e ka trazuar informacionin duke ngritur shpesh dhe perceptime e vlerësime të rreme nga ana e qytetarëve dhe institucioneve. Shenjat autokratike në qeverisjen e vendeve, presioni ndaj redaksive të gazetave dhe keqorientimi nga zyrat e PR-it, kanë lënë dhe po lënë gjurmë edhe në shoqëritë demokratike.

Ky projekt është ende në proces dhe pritet që, në fazën finale, të përfshijë organizimin e tryezave të diskutimit në qarqet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës e Korçës.

Nisur dhe nga realiteti, me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, po gjatë muajit tetor 2020 ka nisur procesi për realizimin e një projekti që mbështetet nga AMA, titulluar “Informimi dhe trajtimi i temave mbi shëndetin dhe përdorimin e ekraneve audiovizive”.

Projekti do të ketë në fokus performancën e 5 OSHMA-ve, analizë të përmbajtjeve të emetuara prej tyre, sondazh me qytetarët në dy qarqe të vendit, realizim të dy tryezave të diskutimit dhe një publikim ku do të përmbledhen gjetjet dhe përfundimet. Projekti është ende në vijim.



## 11. KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE

### *Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive*

Viti 2020 shënon përfundimin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në vendin tonë, këtij procesi të vështirë, të tejzgjatur në kohë dhe të shoqëruar me mjaft problematika, duke përmbytur kështu një detyrim kombëtar, ndërkombëtar si dhe kërkesat në rritje të qytetarëve.

Digjitalizimi i transmetimeve audiovizive konsiderohet një ndër arritjet kryesore në fushën e medias, duke qenë se përfitimet nga ky proces i rëndësishëm janë të shumta dhe të prekshme për publikun shqiptar. Rritja e numrit të kanaleve televizive pa pagesë, rritja e cilësisë së shërbimit, rritja e ndërveprimit, gama e gjerë e shërbimeve të reja janë disa nga këto përfitime. Kjo arritje i adresohet, kryesisht, rregullatorit, i cili ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm, në ndjekjen e implementimit të këtij procesi, duke garantuar vijueshmërinë e transmetimeve televizive në këtë periudhë të vështirë tranzicioni, si dhe duke siguruar mbulim me sinjal numerik tokësor dhe cilësi transmetimi brenda standardeve ndërkombëtare.

AMA, gjatë vitit 2020, në mënyrë të vazhdueshme ka koordinuar punën me operatorët audiovizivë në treg, ka kryer monitorime në terren, ka zhvilluar fushatën e informimit për qytetarët, u ka ardhur në ndihmë qytetarëve nëpërmjet strukturës Call Center, të ngritur nga Autoriteti, si dhe ka zhvilluar anketime nëpërmjet kësaj strukture me qëllim identifikimin e pajisjes me dekodera të qytetarëve.

Përfundimi i procesit u realizua me mbylljen e transmetimeve analoge, gjatë këtij viti, në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë më 30.09.2020, si dhe në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë më 30.12.2020.

Me kalimin në transmetime numerike, numri i kanaleve kombëtare, të aksesueshme për publikun shqiptar, është rritur ndjeshëm. Krahasuar me tre kanalet televizive në nivel kombëtar, ku njëri kanal ofrohej nga operatori publik shqiptar (RTSH) dhe dy kanalet e tjera nga operatorët privatë, sot vetëm RTSH transmeton pa pagesë në të gjithë Shqipërinë 15 kanale televizive nga të cilët 3 janë gjeneralistë dhe 10 të tjerat tematike, për grupe të ndryshme shoqërore, si RTSH Fëmijë, RTSH Sport, RTSH Muzikë, RTSH Film, RTSH Kuvend etj.

Duke konsideruar edhe kanalet e tjera të ofruara nga operatorët privatë kombëtare dhe operatorët lokalë, në çdo qark të vendit, qytetarët shqiptarë mund të shohim mbi 30 kanale televizive pa pagesë.

Dy rrjetet numerike të operatorit publik shqiptar dhe pesë rrjetet numerike private tashmë ofrojnë përmbajtje të ndryshme në nivel kombëtar (në standardet SD dhe HD), një gamë të gjerë shërbimesh të reja, zgjedhje shumë të pasur dhe konkurruese në krahasim me platformat e tjera.

Aktualisht në qarqet Tiranë, Durrës ofrohen 38 kanale pa pagesë, në qarkun Korçë ofrohen 37 kanale, në qarkun Berat 35 kanale, në qarkun Fier 33 kanale, në qarkun Vlorë 36 kanale, në qarkun Shkodër 40 kanale, në qarkun Lezhë 34 kanale, në qarkun Elbasan 38 kanale, në qarkun Kukës 26 kanale, në qarkun Dibër 28 kanale dhe në qarkun Gjirokastrë 36 kanale të lira, pa pagesë.

Në fillim të këtij procesi njerëzit kanë qenë skeptikë dhe paragjykes lidhur me atë çfarë do të ndodhte, pasi ka qenë një proces teknik i vështirë edhe për t'u kuptuar, sikurse çdo risi që vjen për shkak të zhvillimeve teknologjike. Me kalimin e kohës dhe pas implementimit të transmetimeve digjitale, kërkesa e qytetarëve për të përfunduar procesin ka qenë e vazhdueshme. Kjo shpjegohet me arsyen e thjeshtë se cilësia e transmetimit është e pakrahasueshme me transmetimet analoge dhe numri i madh i kanaleve televizive pa pagesë ofron një larmishmëri të madhe të programeve televizive.

Vlen të përmendet se kalimi në transmetimin digjital ka përfunduar në shumicën e vendeve evropiane, dhe Shqipëria është ndër vendet e vonuara në këtë proces, por ndërkohë, ndryshe nga shumica e vendeve evropiane, ku aktualisht vijon tranzicioni për kalimin nga teknologjia DVB-T në DVB-T2, vendi ynë bëri zgjedhjen e duhur duke implementuar që në fillim teknologjinë më të fundit DVB-T2/MPEG-4, me qëllim ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë transmetimi.

Fusha e mediave audiovizive në vendin tonë, ndërkohë, po përballët me një tjetër sfidë të rëndësishme. Implementimi i teknologjisë 5G, teknologji e cila ofron internet me shpejtësi të lartë, kërkon lirim të brezit të frekuencave 700 MHz i cili aktualisht është në përdorim nga operatorët privatë kombëtarë numerike (mbi 30 % e këtij brezi). Kjo do të thotë që nevojitet një planifikim i kujdesshëm dhe efektiv i spektrit të mbetur për transmetimet audiovizive, me qëllim sigurimin e numrit të njëjtë të rrjeteve kombëtare numerike, të cilët janë aktualisht në treg, si dhe ruajtjen e kapaciteteve transmetuese të këtyre rrjeteve.

Kjo sfidë, ashtu sikurse digjitalizimi i transmetimeve audiovizive, do të kapërcehet në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e përfshira në këtë proces, institucionet, operatorët audiovizivë, shoqatat e transmetuesve televizivë e më gjerë.

### ***Përfundimi i DSO në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë***

AMA, me vendimin nr. 179, datë 25.11.2019, përcaktoi datën 31 mars 2020 si afat për realizimin e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë e Vlorë.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar dhe të vendimit nr. 183, datë 19.12.2019, "Për miratimin e projektbuxhetin për vitin 2020", AMA zhvilloi fushatë për informimin e publikut për një periudhë 30 ditore (01 mars – 30 mars 2020) përmes transmetimit të spoteve publicitare në televizione dhe radio (kombëtare dhe lokale) si dhe përmes transmetimit nëpërmjet 14 portaleve për një periudhë 2 mujore (01 shkurt – 30 mars 2020).

Nisur nga situata e krijuar për shkak të përhapjes së pandemisë ishte e pamundur të vijohej puna për koordinimin me operatorët, monitorimin në terren si dhe vlerësimin e pajisjes me dekodera të banorëve të këtyre qarqeve. Kufizimet e vendosura nga qeveria në mbrojtje të qytetarëve nga përhapja e këtij infeksioni si kufizime në qarkullimin e makinave, kufizime në lëvizjen e qytetarëve, kufizime në numrin e personave në ambiente të përbashkëta, si dhe mbyllja e bizneseve që tregtojnë dekodera, nuk mundësonin realizimin brenda afatit të përcaktuar.

Në këto kushte, si dhe duke konsideruar që subjektet televizive kanë një rol të rëndësishëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës për marrjen e masave kundër përhapjes së infeksionit, AMA, me vendimin nr. 23, datë 26.03.2020 shtyu afatin e mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë, deri më datë 30 qershor 2020.

Në zbatim të këtij vendimi, u kryen veprimtaritë si më poshtë:

- U vendos korrespondencë e vazhdueshme me operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë, ku i kërkohej të merrnin masa për përmbushjen e këtij detyrimi brenda afatit të përcaktuar (dërguar shkresat me nr. 1454/1455/1456/1457/1458/1459 prot., datë 09.06.2020, nr. 1465 prot., datë 10.06.2020);
- U ngrit grupi i monitorimit për të verifikuar situatën në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës së operatorëve privatë kombëtarë numerike, si dhe nëse janë mbështetur operatorët lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare;
- U zhvillua fushata e informimit të publikut nëpërmjet spoteve publicitare.

Për vijimin e fushatës, AMA, me vendimin nr. 40, datë 13.05.2020 bëri një ndryshim/rialokim fondesh të vendimit nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, të ndryshuar. Bazuar në VKM-në nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”, u krye fushatë përmes transmetimit të spoteve në televizionet dhe radiot kombëtare dhe ato vendore (qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë) për një periudhë 35 ditore, 26 maj – 29 qershor 2020.

Në përgjigje të shkresave tona drejtuar operatorëve kombëtarë, shoqëria “TV Klan” sh.a me shkresën nr. 1471 prot., datë 11.06.2020 ka theksuar se mbyllja e transmetimeve analoge në 4 qarqe është e përshpejtuar dhe e pamundur, pasi nuk është shtruar infrastruktura digjitale nga të gjithë operatorët privatë kombëtarë numerikë. Gjithashtu, nga monitorimet e kryera në të katër këto qarqe, rezultonte se ende nuk kishte përfunduar plotësisht infrastruktura numerike nga operatorët privatë kombëtarë.

Problematikë tjetër e konstatuar nga monitorimet ishte se në të katër këto qarqe operatorët lokalë/rajonale nuk kishin mbështetur programin e tyre në rrjetin e RTSH-së apo në ndonjë rrjet tjetër privat kombëtar numerik.

Në adresë të AMA-s u paraqitën edhe ankesa nga qytetarët lidhur me grumbullime njerëzish pranë zyrave postare apo pikave të ndryshme të shitjeve për të blerë dekoderat dhe ata kërkonin shtyrjen e fikjes së sinjalit analog deri në një periudhë më të përshtatshme.

AMA, duke konsideruar situatën e krijuar nga COVID-19, faktin që subjektet nuk kishin shtruar plotësisht infrastrukturën numerike, me qëllim parandalimin e grumbullimeve të qytetarëve që stimulonin përhapjen e infeksionit COVID-19, si dhe duke konsideruar që subjektet televizive kanë një rol të rëndësishëm në informimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës, për marrjen e masave kundër përhapjes së infeksionit, me vendimin nr. 51 datë 29.06.2020 vendosi shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan deri më 30 shtator 2020.

Gjatë periudhës 30 qershor - 30 shtator 2020, AMA intensifikoi aktivitetet e veta, sikurse koordinimin me operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë të katër qarqeve, monitorimin në terren, si dhe vijoi fushatën e informimit të publikut përmes transmetimit të spoteve në televizionet dhe radiot kombëtare dhe ato vendore të qarqeve Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë.

Përkatësisht, më datë 15 shtator 2020 u zhvillua takimi me operatorët lokalë të qarqeve Shkodër dhe Lezhë, me datë 17 shtator 2020 me operatorët lokalë të qarkut të Elbasanit, si dhe me datë 22 shtator 2020 me operatorët e qarkut Vlorë. Gjatë këtyre takimeve u diskutua mbi zbatimin e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge, si dhe u informuan operatorët lidhur me mënyrën e kompensimit financiar për 6 mujorin e parë të mbartjes së tyre në një nga rrjetet kombëtare, bazuar në ligjin nr.34/2017.

Gjithashtu, u është dërguar shkresa me nr. 2577 prot., datë 14.09 2020, të gjithë subjekteve kryesore tregtare të shitjes së dekoderave DVB-T2 të vendit, ku iu është kërkuar që të marrin masat e duhura për pajisjen me dekodera të pikave të shitjes në qarqet ku do të përfundojë digjitalizimi, më datë 30 shtator 2020.

Për të identifikuar pajisjen e popullsisë së qarqeve Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë me dekodera, AMA ka kryer një sondazh, nëpërmjet qendrës Call Center, duke kryer telefonata drejt numrave fiks në këto qarqe. Sondazhi ka filluar me 1 shtator dhe janë kryer gjithsej rreth 900 telefonata (300 në Elbasan, 200 në Lezhë, 200 në Shkodër, 200 në Vlorë). Nga telefonatat e kryera rezultoi se qytetarët janë të informuar mbi procesin e digjitalizimit dhe pjesa më e madhe e tyre janë të pajisur me dekodera.

Lidhur me fushatën e informimit të publikut, AMA, me vendimin nr. 54, datë 05.08.2020, bëri një ndryshim/rialokim fondesh të vendimit nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2020”, të ndryshuar, me qëllim vijimin e fushatës për një periudhë 35 ditore, 26 gusht – 29 shtator 2020. Spotet publicitare mbi procesin e digjitalizimit janë publikuar edhe në faqen zyrtare të AMA-s [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) si dhe rrjetin social *facebook*.

Si pasojë e aktiviteteve të kryera nga AMA, u bë e mundur që, më datë 30 shtator 2020, të mbyllen transmetimet analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan. Procesi vijoi i qetë dhe nuk pati problematika.

Me vendimin nr. 82, datë 08.10.2020, AMA miratoi vijimin e procesit të digjitalizimit në 3 qarqet e mbetura, Kukës, Dibër, Gjirokastrë, ku ende nuk ishin mbyllur transmetimet analoge, por, ndërkohë, qytetarët kishin mundësi të aksesonin transmetime analoge ose digjitale, pasi infrastruktura numerike e operatorit publik shqiptar dhe pjesërisht infrastruktura e operatorëve privatë kombëtarë ishte shtruar edhe në këto qarqe.

Në kuadër të mbylljes së transmetimeve analoge, në tre qarqet e mësipërme, AMA ka koordinuar dhe bashkëpunuar me operatorët audiovizivë në treg, ka monitoruar në terren në mënyrë të vazhdueshme për të verifikuar mbulimin me sinjal numerik, ka monitoruar procesin e mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare numerike, si dhe zhvilloi fushatën e informimit të publikut për një periudhë 35 ditore.

AMA, me shkresat nr. 3458 dhe nr. 3460 prot., datë 03.12.2020, ka njoftuar zyrtarisht operatorët audiovizivë të pajisur me licencë kombëtare dhe lokale të qarqeve Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë lidhur me afatin e mbylljes së transmetimeve analoge në këto qarqe, si dhe u ka kërkuar të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij afati. AMA, në një shkresë të dytë rikujtese, me nr. 3592 dhe 3597 prot., datë 17.12.2020, u ka kërkuar sërish operatorëve kombëtarë të marrin masa për mbështetjen e operatorëve lokalë/rajonale të këtyre qarqeve në rrjetet e tyre, si dhe u ka kujtuar operatorëve lokalë/rajonale mbi detyrimin për të depozituar pranë AMA-s kontratën e lidhur me një nga operatorët kombëtarë numerikë. Në këtë mënyrë do të sigurohej vijimësia e transmetimeve televizive në këto katër qarqe nga të gjithë operatorët lokalë/rajonale dhe kombëtarë, që transmetojnë aktualisht në analog.

Përveç shkresave të dërguara në mënyrë zyrtare, AMA, ka kryer dhe takime të veçanta me operatorët lokalë të këtyre qarqeve, duke iu shpjeguar në detaje procesin e mbartjes nga transmetimet analoge në ato digjitale, si dhe mënyrën e kompensimit financiar nga AMA në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirin e frekuencave të Dixhital Dividentit”, të ndryshuar dhe vendimit të AMA-s nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e listës së subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfitojnë nga kompensimi financiar”. Subjektet janë informuar se do të kompensohen deri tani për 6.46 muaj, dhe kjo vetëm pasi të përmbushin detyrimet ligjore. Gjithashtu, AMA ka vijuar monitorimin në terren për të verifikuar mbulimin me sinjal numerik të këtyre qarqeve, si dhe kalimin e operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtare.

Lidhur me fushatën e informimit të publikut, deri në mbylljen e plotë të procesit të digjitalizimit, në zbatim të vendimit të AMA-s nr. 82, datë 08.10.2020, për mbylljen e transmetimeve analoge në tre qarqet e mbetura Dibër, Gjirokastrë dhe Kukës më datë 30 dhjetor 2020, Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetime Numerike, si dhe në zbatim të vendimit nr. 83, datë 08.10.2020 “Për një ndryshim në vendimin e AMA-s, nr. 183, datë 19.12.2019, “Për miratimin e projektbuxhetit të AMA-s për vitin 2020”, të ndryshuar, AMA kreu fushatën e informimit të publikut për një periudhë 35 ditore (25 nëntor–29 dhjetor 2020) përmes transmetimit të spoteve publicitare, në televizione dhe radio kombëtare dhe lokale. Gjithashtu, fushata vijoi edhe përmes faqes zyrtare të AMA-s [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al) si dhe rrjetit social *facebook*.

Me qëllim identifikimin e nevojave të qytetarëve, në këto tre qarqe, për t’u pajisur me dekodera të tipit DVB-T2 si dhe për t’u njohur mbi ndikimin që ka pasur fushata e informimit të publikut të zhvilluar nga AMA sa i takon procesit të digjitalizimit, prej dy muajsh u zhvillua një sondazh nëpërmjet strukturës sonë Call Center, duke telefonuar qytetarët e qarqeve Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë dhe duke i pyetur ata mbi procesin e digjitalizimit, mbi teknologjitë që përdorin për të aksesuar transmetimet audiovizive si dhe nëse janë pajisur apo jo me dekodera.

Referuar këtij sondazhi u kryen 300 telefonata në Gjirokastrë, 199 telefonata në Dibër dhe 226 telefonata në Kukës, nga ku rezultoi se teknologjia më e përdorur në këto qarqe ishte IPTV dhe televizioni kabllor (Gjirokastrë 65% e të anketuarve; Dibër 68% e të anketuarve dhe Kukës 75% e të anketuarve). Si rezultat i aktiviteteve të kryera nga AMA, u bë e mundur që, më datë 30 dhjetor 2020, të mbyllet transmetimet analoge në qarqet Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë, duke finalizuar në këtë mënyrë procesin e digjitalizimit të transmetimeve audiovizive në të gjithë vendin.

## 11.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital II

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 29.7.2020, është miratuar politika spektrale, dhe, bashkëlidhur saj, është miratuar edhe plani i veprimit për implementimin e kësaj politike, ku, ndër të tjera, është përfshirë edhe procesi i liritimit të brezit DD2. Sipas këtij plani, institucionet e ngarkuara për ndjekjen e këtij procesi janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), AMA dhe AKEP. Gjithashtu, në këtë plan është përcaktuar që procesi të fillojë me organizimin e tryezave të konsultimit me të gjitha palët e përfshira (operatorë audiovizivë, shoqata të mediave, rregullatorë etj.), dhe në përfundim të konsultimeve të kryera të hartohet një plan i detajuar i masave që duhet të ndërmerren për lirimimin e brezit DD2 (ndryshime ligjore nëse do të jetë e nevojshme, kompensim financiar, realizimi i zgjidhjeve teknike etj.).

Në këtë kuadër, AMA duke e konsideruar detyrim ligjor si dhe tepër të rëndësishëm procesin e konsultimit me të gjitha palët e përfshira, me qëllim shmangien e problematikave, që mund të lindin gjatë implementimit, në mënyrë të përsëritur ka kërkuar nga MIE fillimin e këtij procesi. AMA ka kërkuar organizimin e një takimi në nivel të lartë drejtues me pjesëmarrje të të gjitha palëve të përfshira e, në veçanti, të operatorëve kombëtarë audiovizivë, të cilët kanë investuar në fushën e transmetimeve digjitale dhe investimet e tyre preken drejtpërsëdrejti nga lirimi i brezit DD2.

Me iniciativë të MIE-s është përfituar asistencë teknike nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU), me një projekt binjakëzimi me rregullatorin hungarez për gjetjen e zgjidhjeve efektive teknike pa përfshirë brezin DD2. Në grupin e punës, që bashkëpunon dhe merr pjesë në takimet me konsulentët e ITU-së, janë përfaqësues të MIE, AMA dhe AKEP. Duke qenë se jemi në kushtet e një pandemie botërore, takimet me konsulentet janë kryer nëpërmjet platformave online, ku janë shkëmbyer informacionet e nevojshme ligjore dhe teknike me qëllim arritjen e objektivit të kësaj asistence.

Aktualisht, konsulentët kanë paraqitur draft-raportin me rekomandime për zhvillimin e procesit të liritimit të brezit DD2 në vendin tonë dhe janë duke punuar për hartimin e një plani frekuencor efektiv, duke konsideruar kërkesat e AMA-s. Më kryesoret nga këto kërkesa janë ruajtja e numrit të operatorëve në treg, ruajtja e kapaciteteve të transmetimit të rrjeteve kombëtare numerike, marrja në konsideratë e marrëveshjeve ndërkombëtare për koordinimin e brezit frekuencor UHF, konkretisht, marrëveshja e Adriatikut dhe Jonit dhe marrëveshja SEDDIF (South-East Digital Divident Initiative Forum).

Referuar sa më sipër, konsulenti ka përgatitur 5 variante të planit frekuencor numerik. Me qëllim diskutimin e këtyre pesë alternativave të rialokimit të brezit UHF (pa përfshirë brezin DD2) të propozuara nga konsulenti i ITU-së, si dhe diskutimin e çështjeve të tjera teknike, që lidhen me këtë proces, AMA, më 20 janar 2021, organizoi një takim në nivel teknik me përfaqësues të MIE-së, AKEP-it, RTSH-së dhe operatorëve privatë audiovizivë kombëtarë. Në këtë takim, AMA informoi se ekspertët e saj kanë përgatitur një variant tjetër të planit numerik, i cili do t'u vihej në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve në takim.

Në këtë takim, operatorët kërkuar më shumë kohë për vlerësimin e pesë varianteve të dërguara nga eksperti dhe variantit të propozuar nga ekspertët e AMA-s (rreth 1 muaj). Operatorët ngritën edhe pretendime të tjera sikurse kompensimi financiar për shkak të ndryshimeve që do të ndodhin në infrastrukturën numerike, duke marrë në konsideratë se impakti financiar do të jetë tepër i lartë për operatorët kombëtarë numerikë. Gjithashtu, kërkuar që zbatimi i kompensimit financiar të ndodhë përpara lirimit të brezit frekuencor dhe jo pas përfundimit të procesit.

Duke qenë se këto çështje dilnin përtej qëllimit të takimit, i cili ishte organizuar në nivel teknik, AMA theksoi edhe një herë rëndësinë e organizimit të një takimi në nivel të lartë drejtues me të gjithë palët e përfshira.

Lidhur me procesin e lirimit të brezit DD2, më datë 11.11.2020, sikurse kemi raportuar edhe më parë, është zhvilluar edhe një takim midis zëvendësministrit Etjen Xhafaj (MIE) dhe Kryetarit të AMA-s, ku është rënë dakord që të zhvillohej një tryezë e nivelit të lartë me operatorët kombëtarë audiovizivë dhe, ndërkohë, paralelisht, të vije me konsulencën e ITU-së për zgjidhjet teknike.

Në përfundim të fazës së parë të konsulencës së ITU-së, që lidhet me përzgjedhjen e variantit më efektiv sa i takon përdorimit të brezit UHF për transmetimet audiovizive (pas komenteve/propozimeve të paraqitura nga operatorët kombëtarë audiovizivë), do të vijohet me fazën e dytë, ku do të vlerësohen teknikut konfigurimet e rrjeteve si dhe kapacitetet e tyre të transmetimit, duke përcaktuar në këtë mënyrë zgjidhjen teknike për lirimin e brezit DD2.

AMA e konsideron detyrim ligjor dhe tepër të rëndësishëm procesin e konsultimit me të gjitha palët e përfshira në këtë proces, me qëllim shmangien e problematikave që mund të lindin gjatë implementimit të tij. Nisur nga eksperiencat e mëparshme, sikurse procesi i lirimit të brezit DD2 apo procese të tjera të lidhura me të, ku ka pasur vonesa të konsiderueshme, për shkak të proceseve gjyqësore të ngritura nga operatorët audiovizivë kombëtarë, mendojmë se duhet të nisë menjëherë procesi i konsultimit publik.

## **11.2 Kompensimi financiar në kuadër të procesit të digjitalizimit**

AMA, gjatë vitit 2020, në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividendit”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 38, datë 07.03.2019, ka vijuar me kompensimin financiar për operatorët ekzistues analogë lokalë/rajonale, që janë mbështetur në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike, të licencuara sipas ligjit për median audiovizive, për allotmentet Berat, Korçë, Fier; Tiranë (qarqet Tiranë-Durrës), Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë, që kanë plotësuar kërkesat e parashikuara ligjore, deri në masën 53,87% të pagesave të kryera për 1 vit.

Ecuria e kompensimit financiar në fondin prej 1,000,000 euro (masa e përcaktuar dhe e vënë në dispozicion të AMA-s për këtë kategori operatorësh), paraqitet si më poshtë:

Për këtë kategori subjektesh, kompensimi financiar për periudhën korrik 2019 - 31 dhjetor 2020, është realizuar në masën totale 280,693 euro.

| Shoqëria/person fizik               | Emri tregtar/televizioni vendor | Berat         | Korcë         | Fier          | Tiranë         | Shkodër      |
|-------------------------------------|---------------------------------|---------------|---------------|---------------|----------------|--------------|
| Shoqëria "Scan" sh.a.               | "Tv Scan"                       |               |               | 12.916        |                |              |
| Shoqëria "Multiscreen" sh.p.k.      | "Report TV"                     | 6.012         | 9.029         | 12.916        | 16.647         |              |
| Shoqëria "M.R.M." sh.p.k.           | "TV Lobi"                       |               | 3.785         |               |                |              |
| Personi fizik Alban Shehu           | "TV Berati"                     | 6.012         |               |               |                |              |
| Shoqëria "U.T.V. Education"         | "TV UTV Education"              |               | 9.029         |               |                |              |
| Shoqëria "Egnatia Televizion" sh.a. | "CLUB TV"                       |               | 9.029         |               | 12.876         |              |
| Shoqëria "F.K.T." sh.p.k.           | "TV Apollon"                    |               |               | 12.915        |                |              |
| Shoqëria "G2 Media" sh.p.k.         | TV "A2"                         | -             |               |               | 16.647         |              |
| Shoqëria "SOT 7" sh.p.k.            | "TV SOT 7"                      |               | 9.029         |               |                |              |
| Shoqëria "Focus Media News" sh.p.k. | "News 24 TV"                    |               |               | 12.916        | 5.150          |              |
| Shoqëria "Fax Media News" sh.a.     | "Fax News"                      |               |               |               | 15.451         |              |
| Shoqëria "Ora" sh.a.                | "TV Ora News"                   |               |               | 12.916        | 16.647         |              |
| Shoqëria "Channel One" sh.p.k.      | "TV Channel One"                |               |               | 12.916        | 16.647         |              |
| Shoqëria "BBF"                      | "TV BBF"                        |               |               |               | 16.647         |              |
| Shoqëria "Media Plus"               | "TV Shijak"                     |               |               |               | 12.779         |              |
| Shoqëria "3DS&AF ENTERTAINMENT"     | "Tv Syri"                       |               |               |               | 16.647         |              |
| Shoqëria "4 plus Media Grup"        | TV "4+"                         |               |               | 2.464         |                |              |
| Personi fizik Zenel Hoxhaj          | TV "Kopliku"                    |               |               |               |                | 2.671        |
| <b>Totali euro/allotment</b>        |                                 | <b>12.024</b> | <b>39.901</b> | <b>79.959</b> | <b>146.138</b> | <b>2.671</b> |

### 11.3 Kontrata AMA – RTSH

Bazuar në kërkesat e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, konkretisht, nenet 18 dhe 19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e AMA-s; nenin 33 mbi detyrimet e OSHMA-ve; kreun 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH-së, ku përfshihen nenet 90 – 126 etj., AMA realizoi, gjatë vitit 2020, dy monitorime vlerësuese për performancën e RTSH-së në dy aspekte: së pari, për ndërtimin e buketës programore në kanalet e vetë transmetuesit publik, së dyti, për mbulimin me sinjal transmetimi të territorit të vendit tonë.

Nga nënshkrimi i Kontratës së Shërbimit të transmetuesit publik, (me vendimin nr. 18, datë 31 janar 2017) AMA ka realizuar 7 vlerësime të tilla, çdo 6 muaj. Autoriteti ka vlerësuar dhe vlerëson maksimalisht zbatimin e Kontratës nga ana e RTSH-së, si përgjegjësi dhe detyrim ndaj qytetarëve, që ata të marrin produktin audioviziv dhe shërbimin me cilësi dhe shumëllojshmëri, në plotësim të kërkesave dhe nevojave që kanë për informim, edukim dhe argëtim.

Sa i takon problematikave të identifikuar dhe të bëra prezent edhe për drejtuesit e RTSH-së dhe Këshillin Drejtues përmendim:



### *1. Buketa programore*

-RTSH SHKOLLË është ndër kanalet e reja të buketës programore, që ka lindur si nevojë e ngutshme dhe e detyrueshme e aplikimit të formateve të mësimdhënies në distancë, për sistemin parauniversitar, për shkak të kufizimeve dhe ndërprerjeve të zhvillimit të kurrikulave në klasa dhe mjedise të tjera të shkollave, si pasojë e efekteve të pandemisë COVID –19. RTSH SHKOLLË, për vetë natyrën e përmbajtjes së programeve të transmetuara, si dhe grup-moshës që i drejtohet, ka marrë atributet e një kanali të dytë për fëmijët, siç dhe me të drejtë është argumentuar nga drejtuesit e RTSH-së, në kërkesën drejtuar AMA-s për formalizimin e hapjes së kanalit, si pjesë e Kontratës së Shërbimit. Nisur nga angazhimet e vetë transmetuesit publik për kanalën RTSH SHKOLLË, AMA mirëpret dhe nxit ndërhyrjet e nevojshme dhe efektive organizative dhe përmbajtësore, në mënyrë që, krahas pjesës mësimore dhe edukative, me leksionet për lëndë të ndryshme, të vijohet të pasurohet programi dhe me dokumentarë të përzgjedhur për këto grupmosha, si dhe me rubrika sa më argëtuese, veçanërisht gjatë transmetimeve të ditëve të shtuna, të diela dhe ditët e festave.

RTSH AGRO është ndër kanalet më të reja të buketës programore të transmetuesit publik. AMA vlerëson zgjerimin e temave që u ofrohen ndjekësve përmes këtij kanali, por ka identifikuar gjatë monitorimit se një pjesë e dokumentarëve që emetohen janë të papërkthyer në shqip (me titra ose me zë). Pavarësisht se këta dokumentarë janë brenda linjës dhe formatit të RTSH AGRO, pavarësisht se janë produkte cilësore të televizioneve të njohura, ato humbin, në një pjesë të madhe, interesimin për t'u ndjekur nga shikuesit nga mungesa e përkthimit në shqip. AMA nxit RTSH-në që të marrë masa për shmangien e transmetimit të përmbajtjeve audiovizive, të cilat nuk kanë përkthimin (me titra ose me zë) në gjuhën shqipe – sikundër operohet normalisht në të gjitha kanalet e tjera të buketës programore të transmetuesit publik.

AMA, siç edhe ka përmendur në shqyrtimet e mëhershme, sugjeron sërish që kanali tematik në buketën programore, RTSH KUVENDI, krahas transmetimit të seancave të plota parlamentare, si dhe mbulimit të aktivitetit të komisioneve të deputetëve, të krijojë dhe hapësira informuese dhe shpjeguese përmes bisedave, intervistave, apo analizave profesionale me ekspertë të fushës, për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin. Ne mbetemi me mendimin se kjo qasje do të ketë më shumë impakt në nxitjen dhe gjallërimin e konsultimit publik për aktet ligjore, para se ato të diskutohen dhe votohen në seancë plenare nga deputetët. Duhet përmendur këtu dhe fakti se për kanalën RTSH KUVENDI ka diskutuar dhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në mbledhjen e datës 26.06.2020, ku, sipas njoftimit zyrtar të Kuvendit të Shqipërisë, është theksuar që, “të ketë më shumë hapësirë, duke qenë më shumë aktiv dhe t'u vijë në ndihmë deputetëve dhe Kuvendit, ku të pasqyrojë jo vetëm seancat por dhe dokumentarë, intervista, reportazhe, duke sjellë këtu dhe një paralelizëm me vendet fqinjë”.

RTSH duhet të plotësojë tërësisht kërkesën e Kontratës së Shërbimit (referuar nenit 7) për përdorimin e gjuhës së shenjave. Bazuar te Kontrata, duhet që në dy kanale gjeneraliste, të buketës programore të RTSH-së, të transmetohet, të paktën, një edicion informativ brenda 24 orëve, ku të ketë shpjegime, përmes një kuadrati të vogël në ekran, me gjuhën e shenjave. Ne e kemi identifikuar dhe në monitorimet e mëparshme se kjo kërkesë funksionon në rregull në kanalën gjeneralist RTSH 1, ndërkohë që në kanalën tjetër gjeneralist, RTSH 2, transmetohet, me gjuhën e shenjave, vetëm një edicion informativ në javë.

Në buketën programore të RTSH-së duhet të vijojnë përpjekjet për të përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Në nenin 1 të këtij ligji thuhet se RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08.00 deri në orën 22.00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash, transmetohet detyrimisht nga ora 17.00 deri në orën 22.00”.

Në përmbushje të detyrimeve që ka RTSH-ja për zbatimin e Kontratës së Shërbimit, si dhe ndjekjes së procedurave institucionale për ndryshimet që mund të bëhen në të, AMA mirëpret kërkesën për kanalin RTSH PLUS, njësoj siç është vepruar me shtesat për kanalet RTSH SHKOLLË, RTSH AGRO etj.

## *2. Mbulimi me sinjal i territorit*

-Zona të cilat nuk mbulohen me sinjal digjital:

### ALLOTMENTI BERAT

Lagjet mbas Kalasë së Beratit  
Njësia administrative Roshnik  
Njësia administrative Sinjë  
Njësia administrative Potom  
Njësia administrative Çepan.

### ALLOTMENTI KORÇË

Njësia administrative Voskopojë  
Njësia administrative Dardhë  
Njësia administrative Çërravë (qendër)  
Mokër (pjesërisht)  
Gorë  
Barmash.

### ALLOTMENTI TIRANË - DURRES

Njësia administrative Shëngjergj  
Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)  
Njësia administrative Krujë (pjesërisht)  
Njësia administrative Cudhi  
Njësia administrative Ndroq (pjesërisht).

### ALLOTMENTI ELBASAN

Njësia administrative Labinot (fushë Xibrakë)  
Njësia administrative Qukës (pjesërisht)  
Njësia administrative Lunik.

#### ALLOTMENTI VLORË

Njësia administrative Fshatrat e Lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç,etj.)

Njësia administrative Borsh (pjesërisht)

Njësia administrative Himarë (pjesërisht).

#### ALLOTMENTI SHKODËR

Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht)

Njësia administrative Ana e Malit (pjesërisht)

Njësia administrative Kelmend (pjesërisht).

#### ALLOTMENTI LEZHË

Njësia administrative Rrëshen (pjesërisht)

Njësia administrative Rubik (pjesërisht).

#### ALLOTMENTI GJIROKASTËR

Njësia administrative Picar

Njësia administrative Zagorie

Njësia administrative Kurvelesh

Njësia administrative Krahës

Njësia administrative Qesarat (pjesërisht)

Njësia administrative Dropull i Sipërm (pjesërisht)

Njësia administrative Pogon.

#### ALLOTMENTI DIBËR

Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)

Njësia administrative Sllovë (Kala e Dodës).

#### ALLOTMENTI KUKËS

Njësia administrative Lekbibaj.

Nisur nga informacioni i prezantuar më sipër, mbi mbulimin e territorit me sinjal numerik, RTSH-ja duhet të marrë të gjitha masat për realizimin e këtij treguesi në qarqet ku ka përfunduar procesi i digjitalizimit. Nga monitorimet e kryera konstatojmë se, në zona të caktuara të këtyre qarqeve, ka mungesë sinjali numerik. Zonat, të cilat i kemi listuar më sipër, janë zona pa shërbim sinjali TV. Këto zona ua kemi përcjellë dhe në raportimet e mëparshme, por sikurse dhe pasqyrohet dhe më sipër, nga ana e RTSH-së nuk është marrë ende asnjë masë për mbulimin me sinjal të tyre.

Theksojmë se ankesat në adresë të AMA-s, nga banorë të këtyre zonave, janë shtuar. Veçanërisht, kemi marrë ankesa nga banorë të zonës së Xibrakës dhe të zonave përreth (pjesë e allotmentit Elbasan), si dhe, në mënyrë të përsëritur, ankesa nga banorët e zonës së bregut të lumit (pjesë e allotmentit Vlorë), të zonës së Kelmendit (pjesë e allotmentit Shkodër), të zonës së Maliqit (pjesë e allotmentit Korçë) etj. Gjithashtu, ankesa të përsëritura kemi marrë dhe nga banorët e njësisë administrative Lekbibaj dhe Stravë, të cilët i janë drejtuar dhe Avokatit të Popullit për shqetësimin e tyre, shkresa të cilat ia kemi përcjellë dhe Kuvendit për dijeni.

Me mbylljen e procesit të digjitalizimit, AMA i ka kërkuar RTSH-së që të marrë masa për mbulimin sa më të mirë të këtyre zonave dhe të na mbajë të informuar mbi situatën aktuale të mbulimit të territorit me sinjal numerik, në mënyrë të veçantë për zonat e përmendura më sipër.

#### **11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave**

Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave audio/audiovizive realizohet në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore e rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menaxhimi në mënyrë sa më efektive i shfrytëzimit të spektrit audio/audiovizivë krijon mundësi për licencimin e operatorëve të rinj në treg, siguron shmangien e interferencave të dëmshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe garanton cilësi të lartë shërbimi të përdoruesit fundorë.

##### **11.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive**

Bazuar në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, brezi frekuencor, i përcaktuar për transmetime tokësore numerike DTT, është brezi UHF dhe VHF. Bazuar në Planin Kombëtar Numerik (PKN), banda UHF, aktualisht është në përdorim nga operatorët audiovizivë, që mundësojnë transmetimet numerike në të gjithë territorin e vendit. Operatori publik shqiptar RTSH disponon frekuenca për dy rrjete numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuenca për 1 rrjet numerik secili prej tyre. Ndërkohë është licencuar edhe një rrjet lokal, i cili mbulon me shërbim allotmentin Elbasan. Gjithashtu, në PKN parashikohen edhe disa frekuenca të lira për licencimin e operatorëve lokalë/rajonale.

Plani Frekuencor Numerik, paraqitet si më poshtë:

**Plani Frekuencor Numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të RTSH-së (i miratuar nga AMA me V. nr. 27, datë 01.02.2013)**

| Rrjetet Shqipëria | AL-001D | AL-002D | AL-003D | AL-004D | AL-005D | AL-006D | AL-007D | AL-008D | AL-009D | AL-010D     | AL-011D |
|-------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-------------|---------|
|                   | Shkodër | Kukës   | Dibër   | Lezhë   | Tiranë  | Elbasan | Fier    | Berat   | Korçë   | Gjirokastrë | Vlorë   |
| RTSH (MUX-1)      | 28      | 26      | 38      | 43      | 34      | 23      | 27      | 25      | 43      | 26          | 23      |
| RTSH (MUX-2)      | 41      | 32      | 24      | 23      | 21      | 33      | 31      | 30      | 45      | 37          | 39      |

**Plani Frekuencor Numerik për 5 rrjetet kombëtare private në brezin UHF në RSH**

| Rrjetet Kombëtare Private | AL-001D | AL-002D | AL-003D | AL-004D | AL-005D | AL-006D | AL-007D | AL-008D | AL-009D | AL-010D     | AL-011D |
|---------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-------------|---------|
|                           | Shkodër | Kukës   | Dibër   | Lezhë   | Tiranë  | Elbasan | Fier    | Berat   | Korçë   | Gjirokastrë | Vlorë   |
| KLAN (MUX-3)              | 34      | 50      | 55      | 33      | 41      | 42      | 35      | 32      | 51      | 44          | 46      |
| DIGITALB (MUX-4)          | 59      | 40      | 30      | 46      | 53      | 48      | 28      | 36      | 55      | 29          | 57      |
| TOP CHANNEL (MUX-5)       | 45      | 42      | 25      | 29      | 59      | 49      | 22      | 54      | 57      | 50          | 43      |
| MEDIA VIZION (MUX-6)      | 22      | 36      | 54      | -----   | 57      | 46      | 29      | 24      | 21      | 48          | 53      |
| ADTN (MUX-7)              | 51      | 52      | 60      | -----   | 39      | 40      | 45      | 47      | 27      | 35          | 51      |

Shoqëria “Era Digital” sh.p.k., me vendim të AMA-s nr. 186, datë 19.12.2019 është licencuar, për licencë lokale transmetimi audioviziv numerik për qarkun Elbasan. Në përdorim i është përcaktuar kanali frekuencor Ch37.

### ***Kanalet frekuencore të lira në brezin VHF dhe UHF***

|                       | AL-001D | AL-002D | AL-003D | AL-004D | AL-005D | AL-006D | AL-007D | AL-008D | AL-009D | AL-010D     | AL-011D | AL-012D Sub. |
|-----------------------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-------------|---------|--------------|
|                       | Shkodër | Kukës   | Dibër   | Lezhë   | Tiranë  | Elbasan | Fier    | Berat   | Korçë   | Gjirokastrë | Vlorë   | Tiranë       |
| Kanalet e lira në VHF | 9       | 9       | 8       | 9       | 10      | 7       | 10      | 5       | 6       | 8           | 8       | 6            |
|                       |         | 56      |         |         |         | 56      |         | 52      | 28      | 38          |         | 26           |
|                       |         |         |         |         |         | 58      |         |         | 59      | 56          |         | 44           |
| Kanalet e lira në UHF |         |         |         |         |         |         |         |         |         | 58          |         | 50           |
|                       |         |         |         |         |         |         |         |         |         | 60          |         | 60           |

Referuar tabelës më sipër, janë 6 kanale të lira në brezin III VHF. Sa i takon brezit UHF, numri i kanaleve të lira reduktohet, duke pasur parasysh lirimin e brezit 694-790 MHz i njohur si brezi DD2. Konkretisht, mbeten: 1 frekuencë në qarkun e Korçës (Ch28), 1 frekuencë në qarkun e Gjirokastrës (Ch38) dhe 2 frekuenca në suballotmentin e Tiranës (Ch 26 dhe Ch44).

Bazuar në Planin Frekuencor Numerik, rezulton se rreth 30.9 % e kanaleve të frekuencave të përcaktuara nga AMA, për 5 rrjetet UHF private kombëtare, i përkasin brezit DD2.

#### **11.4.2 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio**

Për planifikimin dhe administrimin e spektrit audio FM 87.5-108 MHz, AMA, në vijimësi, ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio, si dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të Frekuencave për këto shërbime. Disponueshmëria e frekuencave të lira, të brezit audio FM, mbetet një tjetër sfidë për rregullatorin, duke qenë se në qarqet ku ka më shumë kërkesë për këtë shërbim si Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë, identifikohen mungesa në burime të fundme, ndërkohë disponohen resurse të nevojshme për qarqet e tjera të vendit.

AMA, gjatë vitit 2020, ka kryer studimet teknike me qëllim licencimin e subjekteve të interesuara për të ofruar transmetime audio në qarqe të ndryshme të vendit. Më rëndësi konsiderohet licencimi i një rrjeti kombëtar audio (rrjet privat), bazuar në vendimin e AMA-s nr. 45, datë 25.06.2020. Gjithashtu, janë kryer studimet teknike për çeljen e garave për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge në nivel lokal/rajonat (gjithsej 6 gara).

Në funksion të detyrave që ka, AMA ka kryer, gjithashtu, studime mbi kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit. Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Në kuadër të përmirësimit të mbulimit me sinjal të transmetuesit publik, AMA, me vendimin nr. 97, datë 14.10.2020, ka miratuar “Dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave 90.5 MHz dhe 91.3 MHz, Radiotelevizionit Shqiptar për zonën e shërbimit Bashkia Himarë (për Radio Tirana 1) dhe Bashkia Pogradec (për Radio Korça).

### **11.4.3 Koordinimi i frekuencave të brezit audio/audioviziv**

Gjatë vitit 2020, AMA ka vijuar procesin e koordinimit me vendet nënshkruese të Marrëveshjes GE06 mbi riorganizimin e frekuencave të planeve frekuencore përkatëse, për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe shtimit të kapaciteteve transmetuese.

Bazuar në kërkesat e ardhura për koordinim nga vendet fqinjë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në Planin GE06. Administrata e Bosnje - Hercegovinës ka kërkuar miratimin e AMA-s lidhur me caktime frekuencore, sipas të cilave Shqipëria është konsideruar e prekur nga ndryshimet e këtij Plani.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë kryer dhe procedurat e koordinimit në përputhje me:

- Aktet finale të Konferencës Rajonale GE-75 “Për transmetimet audio në brezat frekuencorë LF/MF (Rajoni 1 dhe 3)”, në zbatim të notifikimeve të ardhura nga administrata e Italisë.
- Aktet finale të Konferencës Rajonale GE-84 “Për planifikimin e transmetimeve audio në bandën VHF (Rajoni 1 dhe disa pjesë të Rajonit 3)”, bazuar në notifikimet e ardhura nga administratat e Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës, Bullgarisë, Slloveninë si dhe Hungarisë.

Në kuadër të procesit të koordinimit të brezit III VHF për transmetimet audio/audiovizive digjitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe T-DAB), me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon (Itali, Kroaci, Slloveni, Mal i Zi, Bosnje Hercegovinë, Greqi dhe Shqipëri), iniciuar nga administrata e Italisë, edhe gjatë vitit 2020 janë organizuar disa takime, me qëllim rialokimin dhe përdorimin e këtij brezi në mënyrë efikase, proporcionale dhe pa interferenca të dëmshme. Ky proces ka nisur në tetor 2019, ka vijuar me takimet e radhës në 17-19 shkurt 2020 (organizuar në Romë), ndërkohë që takimet e fundit, për shkak të pandemisë COVID-19, janë kryer online nëpërmjet platformës Webex (në 2-3 korrik 2020, 10 nëntor 2020 dhe 7 dhjetor 2020). Në këto takime, Shqipëria është përfaqësuar nga AMA si dhe, në dy takimet e fundit, edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

Procedura e koordinimit të brezit III VHF do të vijojë edhe gjatë vitit 2021, me qëllim dakordësimin e përdorimeve të kanaleve frekuencore nga secila administratë palë e diskutimeve, si dhe finalizimin e propozimeve me firmosjen e një marrëveshjeje shumëpalëshe midis vendeve pjesëmarrëse.

### **11.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive**

#### *Shmangia e interferencave të dëmshme*

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave, që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë dhe marrjen e masave për shmangien e tyre, gjatë vitit 2020, AMA ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e spektrit audio FM, në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi synonte identifikimin dhe zgjidhjen, në kohë të shpejtë, të interferencave që shkaktohen nga sinjalet e emetuar nga transmetuesit e vendeve fqinje.

Në këtë kuadër, AMA, gjatë vitit 2020, realizoi zgjerimin e sistemit të qendëruar të monitorimit të spektrit audio FM, duke shtuar edhe 4 stacione të reja transmetimi. Ky sistem, monitoron *on-line* spektrin audio FM, përkatësisht në qytetet Kukës, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Librazhd dhe Sarandë. Krahas identifikimit të menjëhershëm të interferencave, sistemi bën të mundur:

- a. Identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët në treg ndryshojnë frekuencat;
- b. Identifikimin e menjëhershëm të përdorimit në mënyrë ilegale të spektrit audio;
- c. Kontrollin e gjendjes reale të transmetimit të subjekteve audio të licencuar (janë në transmetim apo jo);
- d. Kontrollin e parametrave teknikë të transmetimit të subjekteve audio.

Në qytetet e tjera, monitorimi i spektrit audio është kryer në mënyrë periodike nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLMF).

#### *Interferencat e shkaktuara brenda vendit*

Sa u përket interferencave të shkaktuara brenda vendit, gjatë vitit 2020, është raportuar vetëm një interferencë e shkaktuar nga subjekti Radio One drejt sinjalit audio të operatorit publik shqiptar (RTSH). Pas verifikimeve të kryera në terren dhe konstatimeve të gjetura, lindi nevoja e ndryshimit të frekuencës dhe vendndodhjes së pikës së transmetimit të subjektit Radio One. Kërkesa për interferencë është paraqitur më datë 25.09.2020 dhe AMA ka marrë vendimin për ndryshimet teknike të subjektit Radio One më datë 08.10.2020, duke i dhënë zgjidhje interferencës së shkaktuar në një kohë të shkurtër.

#### *Interferencat e shkaktuara në vendet fqinje*

Për sa u përket interferencave të shkaktuara në vendet fqinje, gjatë vitit 2020, AMA ka administruar ankesat nga administrata e Malit të Zi, lidhur me eliminimin e interferencave të dëmshme të shkaktuara nga subjektet audio të vendit tonë, konkretisht Radio One dhe Radio Motiv.

Lidhur me interferencat e shkaktuara nga subjekti Radio One drejt Radio Elita të Malit të Zi, AMA ka shkëmbyer korrespondencë të vazhdueshme me rregullatorin e Malit të Zi me qëllim shmangien e interferencave të dëmshme dhe zgjidhjen e problematikës. Gjithashtu, janë kryer monitorime në vijimësi nga të cilët konstatoheshin se interferencat nuk ishin të vazhdueshme por shfaqeshin në periudha të caktuara. Në këto kushte, AMA ka vlerësuar se nevojitet ndryshimi i frekuencës së subjektit Radio One. Ky i fundit ka paraqitur pranë AMA-s kërkesën nr. 462 prot, datë 25.01.2021 (prot. i AMA-s) për ndryshim frekuence, e cila është në proces shqyrtimi. Pas shqyrtimit, AMA do të marrë vendimin për ndryshimin e frekuencës me qëllim eliminimin e interferencës së shkaktuar.



Ndërkohë, referuar interferencës së shkaktuar nga Radio Motiv në qytetin e Podgoricës (Mali i Zi), duke qenë se AMA, me vendimin nr. 73, datë 3.9.2020, vendosi mosrinovimin e licencës së subjektit Radio Motiv, për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit sipas akteve rregullatore si dhe mosshlyerjes së detyrimeve financiare, subjekti, në zbatim të këtij vendimi, ndërpreu transmetimet audio.

Ndërkohë, gjatë vitit 2020 nuk janë identifikuar dhe nuk janë raportuar interferenca në transmetimet audiovizive drejt vendit tonë apo vendeve fqinje.

## **12. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL**

### **12.1 Organizimi i brendshëm i institucionit**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, gjatë vitit 2020, ka siguruar funksionimin normal të institucionit dhe kryerjen e rregullt të të gjitha veprimtarive institucionale, duke garantuar zbatimin e masave dhe udhëzimeve të sigurisë, të rekomanduara nga Instituti i Shëndetit Publik.

Në funksion të organizimit dhe funksionimit të punës në AMA, për të garantuar vijimësinë dhe kushtet e përshtatshme për reduktimin e transmetimit të COVID-19, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, me qëllim zvogëlimin e transmetimit të infeksioneve midis punonjësve dhe krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm, AMA miratoi urdhrin nr. 65, datë 24.04.2020 “Për zhvillimin e funksioneve të AMA-s në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së COVID-19”. Nëpërmjet këtij urdhri u vendosën rregullat bazë të cilat duhet të zbatoheshin detyrimisht në institucion.

Në vijim të situatës dhe në përshtatje të gjendjes së krijuar, me urdhrin nr. 93 datë 01.06.2020, AMA miratoi “Rregulloren për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”. Nëpërmjet kësaj rregulloreje u përcaktuan rregullat, procedurat standarde të punës të harmonizuara, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë.

Në kuadër të organizimit të brendshëm të institucionit, mbështetur dhe në rregullat e reja dhe gjithëpërfshirëse të brendshme, si dhe duke iu referuar rrethanave dhe ngjarjeve të ndodhura së fundmi, gjatë vitit 2020, AMA miratoi “Manualin për rastet e emergjencave në ndërtesën e AMA-s”.

Qëllimi i këtij manuali ishte garantimi i sigurisë së punonjësve dhe vizitorëve, që punojnë apo frekuentojnë mjediset e ndërtesës së AMA-s, nëpërmjet njohjes paraprake të masave për parandalimin e ngjarjeve të emergjencave, si edhe realizimi i ndërhyrjes së shpejtë dhe të saktë në këto raste, përfshirë edhe evakuimin efikas dhe të sigurt të çdo personi nga ndërtesa.

Ky manual përmban informacionet bazë më të nevojshme, të cilat ndihmojnë për të parandaluar ngjarjet dhe për të vepruar sa më mirë në rastet e shfaqjes së tyre në ndërtesë.

Vetë rrethana tepër specifike e ushtrimit dhe realizimit të detyrave funksionale nga çdo punonjës, për të arritur objektivat institucionale, ka diktuar përdorimin e formës së komunikimit online si dhe të punës me orar të reduktuar. Pavarësisht këtyre, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka vijuar edhe procesin ligjor të rekrutimit sipas planit vjetor të rekrutimit rast pas rasti.

Në vijim të shkresës nr. 1270 prot., datë 12.05.2020, “Kërkesë për informim Kuvendit të Shqipërisë”, AMA ka informuar Kuvendin e Shqipërisë, në mënyrë të përjavshme, mbi veprimtarinë kryesore të institucionit, mënyrë informimi e cila ka vijuar deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, në fund të muajit qershor 2020.

Gjatë vitit 2020, mbledhjet e Këshillit të AMA-s, edhe pse në kushtet e pandemisë, kanë vijuar të zhvillohen pa ndërprerje dhe, kryesisht, në periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme janë zhvilluar përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, në përputhje të plotë me parashikimet e Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID -19”. Gjithsej, gjatë këtij viti, janë zhvilluar 24 mbledhje. Prej muajit tetor 2019, mbledhjet e Këshillit vijnë të zhvillohen me 5 anëtarë.

Gjithashtu, në vijim të nismës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, njoftuar përmes shkresës së datës 4 prill 2020, administruar prej AMA-s me nr. 1035 prot, datë 06.04.2020, i është bashkuar kësaj nisme për dhënie kontributi financiar në kuadër të përballimit të nevojave për parandalimin e përhapjes së infeksionit shkaktuar nga COVID-19, nëpërmjet përgjysmimit të pagës mujore të Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të tij, për një periudhë tre mujore, duke filluar nga paga e muajit prill 2020.

## **12.2 Programi i transparencës**

Si një institucion i pavarur publik AMA funksionon në përputhje me standardin e transparencës, duke siguruar, gjatë veprimtarisë së vet, zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit 119/2014, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. AMA, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, ka kryer Rishikimin e Programit të Transparencës, të miratuar me urdhrin nr. 131, datë 24.04.2015, duke e përditësuar me ndryshimet e nevojshme.

Në përgatitjen e rishikimit të programit të transparencës është mbajtur parasysh interesi më i lartë i publikut, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion dhe sidomos:

- Garantimin e njohjes maksimale me informacion;
- Vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- Modelet e miratuara për kategoritë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët digjitalë për ankesa/aplikime, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut.

Për vitin raportues, pranë AMA-s kanë ardhur rreth 122 kërkesa për informacion, të cilat gjenden të pasqyruara edhe në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në faqen zyrtare të autoritetit.

### 12.3 Aktivitete të Autoritetit

#### ***Prezantimi i dy publikimeve në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit***

-Në mjediset e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës, u prezantuan, më 31 janar 2020, dy botime të reja të realizuara nga ky Departament, në kuadër të projekteve që janë mbështetur nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA.

*“Tregu i medias audiovizive, sjelljet e audiencave dhe kuadri rregullator”* dhe *“Oferta programore e transmetuesve televizivë shqiptarë”*, përbëjnë dy dosje faktike dhe analitike, si pjesë e studimeve dhe kërkimeve që kanë kryer, në dy vitet e fundit, anëtarët e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit.

Bashkëpunimi mes një universiteti publik dhe një institucioni publik, u tha gjatë takimit, duhet të jetë më i shpeshtë në vendin tonë, sepse ka impakt shumë pozitiv mbi vetë institucionet dhe mbi shoqërinë. Bashkëpunimi 5-vjeçar mes AMA dhe Departamentit u përshkrua si model, me impakt real që kanë projektet studimore dhe kërkimore për aktualitetin dhe perspektivën, duke pasur shumë rëndësi baza e të dhënave që përftohet nga kjo punë voluminoze dhe profesionale. Departamenti u vjen në ndihmë operatorëve audio dhe audiovizivë, që ata të kuptojnë më mirë dinamikën e zhvillimeve teknologjike dhe të përmbajtjeve që transmetojnë. Prezantohen me fakte dhe analiza kompetente se cilat janë trendet e së nesërme, duke u ofruar OSHMA-ve dhe shembuj e precedentë nga mediat audiovizive ndërkombëtare.

#### ***Sfida e radios në erën digjitale***

-Në Ditën Botërore të Radios, 13 shkurt 2020, AMA organizon aktivitetin *“Sfidat e radios në erën digjitale”*, ku ishin të pranishëm përfaqësues nga redaksitë radiofonike, publike dhe komerciale, nga shoqatat e medias, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, OSBE-ja, institucione të ndryshme publike si dhe shoqëria civile.

Diskutimi, që u zhvillua brenda ekspozitës pamore “Retro”, synoi të tërhiqte vëmendje ndaj rolit dhe ndikimit të këtij mediumi në shoqëri, të nxitet përshtatja e performancës së redaksive në rrethanat e multimedias dhe konvergjencës, të cilat kanë ndryshuar rrënjësisht dhe sjelljen e përfshirjen e audiencave në produktin mediatik.

Gjatë aktivitetit u përmend angazhimi institucional i AMA-s në favor të lehtësimit të procedurave për licencimin, zgjerimin e afatit të tyre, riorganizimin e strukturës së programacionit, juridikut, teknikës etj. Radioja po kalon kohë të vështira, teknologjia ia ka vështirësuar rrugën, sidomos në zonat rurale. Ka shumë zona periferike ku ka një ose asnjë radio. Për të nxitur hapjen e radiove në këto zona, AMA ka çelur edhe gara për licencime pa kërkesa, u tha gjatë aktivitetit.

## ***E drejta e autorit në transmetimet audio dhe audiovizive***

Më datë 4 mars 2020, AMA organizoi Tryezën e diskutimit “*E drejta e autorit në transmetimet audio dhe audiovizive*”, ku morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Kulturës, nga SUADA, nga agjencitë ALBAUTOR, FMAA, AKDIE, Gramm-A, nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Qendra Kombëtare Kinematografike, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Albatrade Plus, nga subjektet audiovizive kombëtare dhe lokale, ekspertë të fushës etj.

Të pranishmit e vlerësuan si të dobishme organizimin e Tryezës, si një përpjekje konkrete për të krijuar një hapësirë diskutimi dhe ekspertize, pasi vetëm përmes komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë çështjet vlerësohen me realizëm dhe palët e interesuara do të mund të kapërcejnë mangësitë e pengesat, përmes bashkëveprimit dhe koordinimit më të mirë.

Gjithashtu, u nënvizua fakti se e drejta e autorit është përfshirë në strategjinë 3-vjeçare të AMA-s dhe pritshmëria është që, në fund të tre viteve të ardhshme, problematikat me të drejtat e autorit dhe të transmetimit të jenë të përfunduara. Kjo do të arrihet, në radhë të parë, duke bashkërenduar dhe rakorduar angazhimet dhe kontributet, u tha gjatë tryezës, duke realizuar nëse ka mundësi përmirësime në kuadrin ligjor, në praktikat e metodologjitë që do ndiqen.

Të pranishmit kanë parashtruar problematika të ndryshme, të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Ata kanë përmendur raste të moskuptimit si duhet nga përdoruesit e përmbajtjeve audiovizive të detyrimeve që duhet të shlyejnë, mungesën, në shumë raste, të komunikimit mes grupeve të interesit, paqartësi në metodologjinë e përlllogaritjes së detyrimeve për shfrytëzimin e të drejtës së autorit, mungesën e prokurorëve apo gjyqtarëve të specializuar në këtë fushë, transformimin që u bëhet përmbajtjeve të mbrojtura me ligj nga disa operatorë audiovizivë etj.

## ***Reklamat për fëmijët dhe me fëmijët***

-Më datë 6 tetor 2020, AMA organizoi panelin virtual të diskutimit me temë “Reklamat për fëmijë dhe me fëmijët”. Për AMA-n mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme audiovizive ka qenë dhe mbetet përparësi e rëndësishme. Një pjesë të këtyre përmbajtjeve e zënë reklamat dhe komunikimet tregtare. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin përfaqësues të OSHMA-ve kombëtare dhe lokale, institucione publike dhe organizata jofitimprurëse, që fokusohen dhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ekspertë të medias e komunikimit etj. Të pranishmit ngritën si problematikë promocionin për aktivitetin online të fëmijëve, mbi pajisje të ndryshme elektronike që i bëjnë ata të varur nga përdorimi i internetit. Gjithashtu, dhe shmangia e reklamave audiovizive, ku përfshihen fëmijët në reklamat e produkteve të ndryshme ushqimore, u përmend si domosdoshmëri nga diskutantët.

## **Media Literacy dhe fëmijët**

-Më datë 17 dhjetor 2020, AMA organizoi tryezën e diskutimit virtual me temë “Fëmijët dhe shprehjet e edukimit mediatik”, në vijim të aktiviteteve që Autoriteti realizon me fokus mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në transmetimet audio dhe audiovizive. Të pranishëm në tryezë ishin zyrtarë dhe ekspertë nga institucionet dhe agjencitë publike të arsimit, nga Universiteti i Tiranës, subjekte të shoqërisë civile, apo kërkues të fushës, të cilët trajtuan problematika që lidhen me përfshirjen e edukimit mediatik në kurrikulat e nxënësve dhe studentëve, për kombinimin e njohurive teorike me aftësimin teknologjik, për nevojën e nismave vetërregulluese të redaksive gazetareske, për të shmangur lajmet e pavërteta dhe ato të shtrembëruara etj.

Diskutantët theksuan se edukimin mediatik duhet ta vendosim në fokus jo vetëm me fëmijët por edhe me vetë median. Në media transmetohen, më së shumti, kronika për fëmijët problematikë dhe shumë pak kronika pozitive për këtë kategori, gjë që sjell demotivim te brezi i ri. U përmend dhe rasti i platformave rinore ku të rinjtë gjejnë gjithmonë më shumë veten në komunikim me njëri-tjetrin, për të mos rënë pre e bullizmit në mediat sociale. Përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe nga Sektori i Zhvillimit të Kurrikulës në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar, përmendën dhe faktin se në trajnimet e mësuesve do të futet edhe moduli i edukimit mediatik, i huazuar nga manuali i UNESCO-s. Impakti i pritshëm është se nxënësi i edukuar mediatikisht, gjithashtu, do të kërkojë cilësi nga media.

Edhe pse në situatën e një pandemie globale, AMA ka vijuar me organizimin e tryezave të ndryshme fizike apo virtuale, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga OSHMA-të, institucionet apo agjencitë të ndryshme, fusha e veprimit të të cilave lidhet me fushën e veprimit të AMA-s, kontributi i të cilëve vijon të jetë një vlerë e shtuar.

AMA ka zhvilluar dhe mbajtur gjatë vitit 2020 marrëdhënie shumë të mira dypalëshe me autoritetet rregullatore në rajon. Përmendim këtu vizitën e Autoritetit të Kosovës, KPM në Tiranë, në muajin shtator, ku u diskutua mbi bashkëpunimin dhe komunikimin sistematik të institucioneve, në shërbim të konsolidimit të performancës institucionale, për rregullimin e tregut audioviziv. Kalimi i transmetimeve nga analogu në digjital dhe aplikimet e reja teknologjike mbeten aspekte ku AMA dhe KPM kanë energji dhe hapësira për të intensifikuar më shumë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, bazuar dhe në praktikatat e rregullatorëve në vendet e BE-së.

Më datë 2 nëntor 2020, Kryetari i AMA-s, z. Gentian Sala, zhvilloi një takim me Ministrin e Informatikës dhe Administratës të Maqedonisë së Veriut z. Jeton Shaqiri. Gjatë këtij takimi, të zhvilluar në AMA, u diskutua mbi nevojën e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve rregullatore të Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, por edhe për çdo problem që AMA mund të ketë në nivel qendror në Maqedoninë e Veriut.

AMA ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA, REFRAM etj.

Përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2020, kanë marrë pjesë në rreth 38 konferenca, takime apo seminare, kryesisht online, diktuar prej pandemisë COVID-19, ku AMA ka qenë e ftuar për të marrë pjesë apo kontribuar në organizmat dhe platformat evropiane apo rajonale të medias audiovizive. Temat kryesore të takimeve nga Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA) ishin “Miratimi i Strategjisë trevjeçare të EPRA-s”; “Rregullatorët dhe qytetarët”; “Media Literacy”, “Ligji i konkurrencës dhe ndërhyrja në treg”.

Me ftesë të Observatorit Evropian Audioviziv, AMA ka marrë pjesë në Konferencën e 63-të të Këshillit Ekzekutiv të Observatorit Evropian Audioviziv, në aktivitetet me temë “Sfidat me të cilat do të përballëtohet Industria e Mediave Evropiane në vitet e ardhshme”, Takimi i 18-të EFARN “Rrjeti kërkimor i Agjencisë Evropiane të Filmit”, “Adresimi i sfidave të paraqitura nga dezinformimi në Ballkanin Perëndimor” dhe “Diversiteti dhe përfshirja në industrinë audiovizive evropiane: si në ekran ashtu edhe jashtë tij”.

Nga Grupi i Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Mediatike Audiovizive (ERGA), AMA ka marrë pjesë në “Takimin e 13-të Plenar”; workshop për “Rregullimin dhe Shërbimin e Operatorëve Audioviziv në Platformat e Ndarjes së Videove” si dhe në Takimin e 14-të Plenar mbi Grupin e Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet e Mediave Audiovizive.

## 12.4 Botimet e Autoritetit

AMA, gjatë vitit 2020, ka vijuar me publikim të radhës së Buletinit Periodik, konkretisht nr. 6 me të dhëna nga dinamika e tregut audioviziv në Republikën e Shqipërisë<sup>2</sup>.

Gjatë vitit 2020 u botua, gjithashtu, edhe Buletini i Ankesave nr. 6. Ky dokument është një përmbledhje e ankesave që vijnë në AMA, në lidhje me përmbajtjet audiovizive, për periudhën janar-qershor 2019.

Botimet periodike të AMA-s gjenden në versionin e tyre elektronik edhe në faqen zyrtare të AMA-s, [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).

## 12.5 AMA në bashkëpunim me partnerët

- AMA në bashkëpunim me Shoqërinë “Ura” ka mundur të realizojë projektin me temë: *“Studimi i tregut audioviziv në vendin tonë lidhur me mbulimin e territorit me sinjal bazuar në teknologji të ndryshme (kabllore, tokësorë, IPTV, satelitorë, etj) si dhe impakti që ka sjellë digjitalizimi i transmetimeve audiovizive”*. Nevoja e zhvillimit të këtij projekti ishte identifikimi i situatës aktuale të tregut audioviziv në vendin tonë, si dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së këtij tregu në të ardhmen, referuar zhvillimeve dhe konvergjencës teknologjike.

Ky studim ka paraqitur skenarët e mundshëm për zhvillimin e tregut në të ardhmen, duke pasur parasysh zhvillimet dhe konvergjenat teknologjike, si më poshtë:

---

<sup>2</sup> Për informacion të plotë rreth Buletinit Periodik nr.6 të AMA-s, refererohuni te paragrafi 12.7.

- Përdorimi i televizionit tradicional;
- Aksesimi i formatit video nga moshat e ndryshme;
- Trendi i shikueshmërisë televizive në të ardhmen.

Nga gjetjet kryesore të sondazhit ka dalë në pah se përdorimi i televizionit klasik, në kohët e fundit, ka qenë gjithnjë në rënie. Moshat e reja e marrin informacionin, kryesisht, nëpërmjet internetit. Kërkesën më të madhe shikuesit e kanë për programet e filmave, si dhe ato informative.

Ndryshimet teknologjike janë të një shpejtësie dinamike, gjë që bën të mundur dhe ndryshimet e trendit të shikueshmërisë në të ardhmen. Studimi ka hedhur dritë mbi impaktin e ndryshimeve teknologjike të kalimit të sinjalit nga analog në digjital, me rritjen e cilësisë së shërbimit, si dhe të shtimit të numrit të kanaleve, të qytetarët. Përdorimi i teknologjive IPTV dhe OTT ka marrë një hov të madh dy dekadat e fundit dhe duket se trendi i përdorimit të IPTV për shikimin e televizionit dhe të videove, do të zërë pjesën kryesore të tregut mediatik.

-AMA, në bashkëpunim me Organizatën Jo-Fitimprurëse “Instituti për Konsulencë në Marketing dhe Menaxhim” ka nisur procesin për realizimin e projektit: “*Media si instrument delikat për edukimin shëndetësor*”. Projekti do të ketë në fokus performancën e 5 OSHMA-ve, analizë të përmbajtjeve të emetuara prej tyre, sondazh me qytetarët në dy qarqe të vendit, realizim të dy tryezave të diskutimit dhe një publikim ku do të përmbledhen gjetjet dhe përfundimet. Projekti është në vijim.

-AMA, në bashkëpunim me shoqatën “Instituti i Inxhinierëve Broadcasting Shqiptarë” ka nisur procesin për realizimin e një projekti me titull: “*Teknologjia dhe infrastruktura e transmetimeve audiovizive në kohën digjitale*.” Projekti do të ketë në fokus përditësimin e njohurive mbi teknologjitë digjitale DVB-T2, teknologjinë T-DAB dhe teknologjitë e avancuara digjitale për transmetimet audio, mbi qëllimin e monitorimit të frekuencave si dhe pajisjet që përdoren për teknologjitë digjitale, njohuri mbi eksperiencat e vendeve të BE-së mbi implementimin e teknologjive digjitale etj.

## 12.6 Marrëveshjet e bashkëpunimit

Për bashkëpunimin me institucionet e tjera, AMA ka ndërmarrë disa nisma për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të koordinimit të punës. Këto marrëveshje vijnë, gjithashtu, në kuadër të kërkesës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbi krijimin e hapësirave dhe thellimin e formave të bashkëpunimit midis institucioneve. Duke konsideruar se bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes AMA-s dhe këtyre institucioneve do të përmirësojë standardet dhe kushtet për një treg audioviziv të lirë dhe efektiv, në përputhje me standardet evropiane, AMA, brenda periudhës raportuese, ka propozuar nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke përgatitur draft-marrëveshje, objekt i të cilave është përcaktimi i fushave dhe formave të bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Më konkretisht, AMA, gjatë vitit 2020, ka propozuar dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet si më poshtë:



### ***AMA - Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës***

Në zbatim të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, duke njohur rëndësinë e mbrojtjes së të miturve, garantimin e të drejtave, interesave dhe kërkesave morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive; duke synuar respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijëve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive; me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis palëve në fushën e mbrojtjes së të miturve në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë, AMA dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, më 30 dhjetor 2020, lidhin Memorandumin e Mirëkuptimit.

Objekti i këtij *Memorandumi* është përcaktimi i fushave dhe i formave të tjera të bashkëpunimit ndërmjet palëve, për çështje të interesit të përbashkët, që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të miturve në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.

### ***Bashkëpunimi AMA - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi***

Në zbatim të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, AMA dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datë 23.11.2020, lidhin Memorandum Mirëkuptimi, me qëllim promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, çuarjen përpara të bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet tyre, në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi në këtë fushë. Memorandumi njeh dhe thekson rëndësinë e mbrojtjes dhe garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive; synon rritjen e bashkëpunimit midis palëve në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë.

Ky Memorandum ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, do të zhvillojnë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjellë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm, si dhe interesat e ligjshme të qytetarëve shqiptarë.

### ***Bashkëpunimi AMA - Ministria e Kulturës***

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) dhe Ministria e Kulturës, më 8 tetor 2020, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, për realizimin e projekteve të përbashkëta audiovizuale mbi promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. Projektet që mbështet AMA janë: *Muzeu i ri i Filmit*, një ndër projektet e Ministrisë së Kulturës; *realizimi i videotureve për “Itinerarin fishtian”*, që rrëfen gjithë rrugëtimin jetësor dhe krijues të At Gjergj Fishtës apo *Via Egnatian*, një nga rrugët mijërvjeçare, që lidhte Perëndimin me Lindjen.

Konteksti i ri, i krijuar prej pandemisë COVID-19, i vendosi institucionet kulturore përpara një realiteti të ri, që kërkon një qasje të re te publiku, sidomos ai i grupmoshave të reja. Në këtë këndvështrim po shihen të gjitha format e bashkëpunimit, që i ofrojnë publikut një produkt i cili i afron ata me trashëgiminë kulturore dhe artin.

Bazuar në këtë marrëveshje, palët angazhohen për krijimin e hapësirave mbështetëse, për ruajtjen e krijimtarisë artistike, si dhe për të promovuar artin e kulturën në fushën audiovizive. AMA, si anëtar me të drejta të plota në Observatorin European Audiovizual, organizëm që mbulon aktivitetet e kinemasë, i cili monitoron tregun kinematografik brenda Bashkimit Evropian dhe vendeve që synojnë anëtarësimin në BE, me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin ndër-institucional në drejtime konkrete, firmosi këtë marrëveshje.

## **12.7 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s**

Edicioni 6 i Buletinit Periodik, i përgatitur gjatë vitit 2020 përfshiu, për herë të parë, një vlerësim të angazhimit gjinor në transmetimet audiovizive. Për OSHMA-të kryesore, duke iu referuar një kampionimi kohor të njëjtë, u identifikuan tregues sasiore të raportit gjinor të moderatorëve të emisioneve, si dhe të të ftuarve që përfshihen në to (meshkuj dhe femra). Rezultatet reflektuan, për secilin nga subjektet audiovizive, por dhe në tërësi, prirjen se ekrani po afron për kontribute të dyja gjinitë, pa qenë pengesë dhe paragjykim për cilindo që ngarkohet me detyrën e moderimit të një programi, apo për ata që ftohen të ndajnë mendimet e pikëpamjet në trajtimin e temave dhe aspekteve, që subjekti audioviziv vendos në fokus.

Buletini Periodik është një set treguesish vjetorë me natyrë ekonomike dhe financiare, teknike e teknologjike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., që destinohet për përfaqësuesit e OSHMA-ve, për kërkuesit dhe studiuesit e tregut audio/audioviziv, për studentët e gazetarisë, për institucionet vendase dhe të huaja, që monitorojnë dhe mbështesin projekte dhe programe në sektorin mediatik etj.

Tek aspektet ekonomike të tregut audioviziv jepen tregues të tillë si renditja e OSHMA-ve sipas treguesve kryesorë ekonomikë, sipas totalit të të ardhurave vjetore, sipas rezultatit ekonomik, sipas nivelit të aseteve fikse etj. Treguesit prezantohen përmes grafikëve dhe tabelave, sipas dinamikës për secilin nga komponentët e tregut audio dhe audioviziv (televizionet, radiot, kabllorët dhe shërbimet e tjera). Një rubrikë më vete është dhe pronësia në aktivitetin audioviziv, duke reflektuar strukturimin pronësor, si dhe përqendrimin e kontribuesve të OSHMA-ve dhe në degë të ndryshme të industrisë.

Për burimet njerëzore, të angazhuara në tregun audio dhe audioviziv, në Buletin jepet informacion faktik mbi përbërjen e stafeve, sipas nivelit arsimor, moshës, vjetërsisë në punë, gjinisë dhe profesioneve. Këtu përfshihen dhe tregues mbi trajtimin e personelit në raport me të ardhurat dhe shpenzimet, nivelet e pagave bruto sipas ndarjes në profesione të stafit, raporti i pagave bruto mbi të ardhurat dhe shpenzimet vjetore totale të OSHMA-së etj.

Në pjesën e treguesve teknikë të transmetimeve, krahas dinamikës së procesit të digjitalizimit, jepet dhe paraqitja me harta gjeografike e nivelit të mbulimit me sinjal për OSHMA-të kombëtare, si dhe të dhëna për numrin e abonentëve për transmetimet kabllore IPTV dhe OTT.

Buletini përmbledh dhe treguesit vjetorë mbi përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA-të kombëtare, duke iu referuar edicioneve kryesore, volumin e reklamave dhe komunikimeve tregtare, si dhe renditjen e blerësve kryesorë të kohës televizive dhe shpërndarja e tyre sipas llojit të industrisë. Në formë të aktualizuar, Buletini përfshin dhe të dhëna të përgjithshme të OSHMA-ve.

## **12.8 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore**

Një nga objektivat e AMA-s, ka qenë forcimi i mëtejshëm i organizatës, duke pasur pikësynim funksionimin e saj si një trup e shërbimit publik sa më efikase.

Gjatë vitit raportues, AMA ka realizuar planin vjetor të rekrutimit, duke zbatuar me përpikëri legjislacionin e shërbimit civil, duke u udhëhequr nga parimi i meritës në rekrutim, vijueshmërisë së karrierës brenda shërbimit civil si dhe alternimit të praktikave trajnuese të nëpunësve.

Referuar përmirësimit të funksionit organizativ e institucional të Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe objektivave të vendosura për vitin 2020, si dhe mundësive e rrethanave të reja, të krijuara nga situata e pandemisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, si çdo fillim viti, ka hartuar Kalendarin Vjetor të analizës së nevojave për trajnim. Ky kalendar ka si bazë të të dhënave të tij informacionin e kërkesave e nevojave specifike të detajuara nga çdo njësi organizative, sa i përket trajnimeve individuale të punonjësve. Këto trajnime të parashikuara për vitin raportues do të mundësonin, në vijimësi, njohjen me standardet dhe praktikat më të mira trajnuese për administratën publike.

Nëse, në vite, trajnimet u realizuan në disa forma, këtë vit raportues AMA, në bashkëpunim me ASPA-n, ka ofruar online, për të gjithë kategoritë e nëpunësve civilë, si dhe për të gjitha trajnimet si ato bazuar në programet e formimit të detyrueshëm, të vazhduar dhe të thelluar dhe ato të zhvillimit të karrierës dhe përshtatjes profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, trajnimet me karakter të posaçëm, për kryerjen e detyrave të veçanta për nëpunësit e administratës publike. AMA, në përmbushje të detyrave funksionale dhe përmirësimit të performancës në punë, ka praktikuar, për çdo njësi organizative të institucionit, dhënien e asistencës së duhur dhe kërkuar mbi informimin e punonjësve me ndryshimet dhe zhvillimet në fushën e legjislacionit mbi shërbimin civil, Kodit të Punës, por dhe orientimin e punonjësve të rinj

Duke e vlerësuar si një metodë trajnimi efektive, që ndihmon në zhvillimin e aftësive dhe fitimin e përvojës, krijimin dhe shkëmbimin e njohurive, duke mësuar të tjerët dhe nxënë njëkohësisht, edhe gjatë këtij viti u zhvillua 1 trajnim i tipit staf-retreat. Tematika e këtij trajnimi ishte “Njohja me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizive 2010/13/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian” datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, (ndryshuar me Direktivën 2018/1808, datë 14.11.2018).

Gjatë vitit raportues ka vijuar puna për zbatimin me përgjegjësi të detyrimeve që rrjedhin nga kërkesat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, është dërguar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave raporti vjetor mbi aktivitetin e kryer nga Autoriteti i Mediave Audiovizive për vitin 2019.

Në këtë raport përfshihej aktiviteti i kryer nga institucioni për këtë vit, i fokusuar, ndërmjet të tjerash, në deklaratimet e bëra nga zyrtarët që mbartnin detyrimin për deklarim të pasurisë, dhënien e informacioneve për çdo ndryshim të subjekteve deklaruese, rastet e konfliktit të interesit.

AMA, me vendimin nr. 56, datë 04.04.2016, ka miratuar Kodin e Sjelljes të Anëtarëve të AMA-s, i cili përfaqëson tërësinë e normave dhe parimeve, që zbatohen dhe udhëheqin veprimtarinë e anëtarësisë, zëvendëskryetarit dhe kryetarit të AMA-s, gjatë ushtrimit të detyrës dhe funksioneve, që u njeh ligji. Nisur nga përmbajtja dhe rregullimi i përgjithshëm që ky Kod Sjelljeje parashikon mbi konfliktin e interesit, me kërkesë të ILDKPKI-së, AMA është në proces hartimi të Rregullores për Parandalimin e Konfliktit të Interesave dhe për Deklarimin e Pasurive në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin e Mediave Audiovizive. Kjo rregullore do të përcaktojë rregullat, mjetet, mënyrat, procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese, në rastet e konfliktit të interesave.

### 13. TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

Falë realizimit të të ardhurave të pritshme, AMA arriti të mbulojë me fondet e veta, përveç shpenzimeve të parashikuara për kryerjen e detyrave funksionale, edhe shpenzime për vijim të fushatës së informimit të publikut sipas Strategjisë së Kalimit nga Transmetime Analoge në ato Numerike, për mbylljen e tyre në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë më datë 30 shtator 2020, si dhe për mbylljen e tyre në qarqet Dibër, Kukës dhe Gjirokastrë, më datë 30.12.2020.

#### 13.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimitarisë së Autoritetit, si dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit të këtyre burimeve ka qenë një ndër objektivat e realizuara të AMA-s.

Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 97/2013, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin agjentit tatimor;
- d) financime nga Buxheti i Shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2020 për **“Të ardhura totale”** (Të ardhura korente të pritshme; Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar; Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar; dhe **“Shpenzime totale”** (Paga, kontribute dhe shpërblime; Mallra dhe shërbime; Investime korente).

Vendimi nr. 183, datë 19.12.2019 ka pësuar disa ndryshime gjatë vitit 2020, kryesisht për nevojën e vijimit të fushatës së informimit të publikut për realizimin e mbylljes së transmetimeve analoge në të gjitha qarqet.

### 13.2 Realizmi i burimeve të financimit në vitin 2020

**Ecuria e arkëtueshmërisë së burimeve të vetëfinancimit për “Të Ardhurat korente të periudhës” dhe “Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar”**

000 lekë

| N r.     | Emërtimi                                                                                 | Parashikimi i të ardhurave për vitin 2020 | Detyrimeve financiare të lindura OSHMA-ve të licencuara/autorizuara në vitin 2020 (Faturime gjatë vitit 2020) | Hequr/shpallur të pavlefshme licenca/autorizime/sisteme faturash gjatë vitit 2020 | Totali i të ardhurave të realizuara viti 2020 | Realizimi në % (sipas projekt buxhetit) | Realizimi në % (sipas faktit) |
|----------|------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------|-------------------------------|
|          |                                                                                          | 1                                         | 2                                                                                                             | 3                                                                                 | 4                                             | $5=4/(1-3)*100\%$                       | $5=4/(2-3)*100\%$             |
| <b>A</b> | <b>Të ardhurat korente të periudhës (1+2+3+4+5+6)</b>                                    | <b>232,379</b>                            | <b>207,614</b>                                                                                                | <b>2,789</b>                                                                      | <b>209,449</b>                                |                                         |                               |
| <b>1</b> | Të ardhura nga licenca/autorizimi + pagesat për rinovimet                                | <b>198,620</b>                            | <b>203,141</b>                                                                                                | <b>1,337</b>                                                                      | <b>190,573</b>                                | 97                                      | 94                            |
|          | a) Realizimi i pagesave nga subjektet televizive privat vendorë                          |                                           | 16,127                                                                                                        | 54                                                                                | 13,258                                        |                                         |                               |
|          | b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale   |                                           | 56,683                                                                                                        |                                                                                   | 56,683                                        |                                         |                               |
|          | c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA për OTT, IPTV, Internet TV |                                           | 49,798                                                                                                        | 350                                                                               | 46,500                                        |                                         |                               |
|          | d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonikë privat vendorë analog                  |                                           | 19,888                                                                                                        | 305                                                                               | 18,138                                        |                                         |                               |
|          | e) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA (kabllorë)                 |                                           | 60,645                                                                                                        | 629                                                                               | 55,994                                        |                                         |                               |
| <b>2</b> | Të ardhura si agjent tatimor                                                             | <b>713</b>                                | <b>752</b>                                                                                                    | <b>3</b>                                                                          | <b>696</b>                                    | 98                                      | 93                            |
|          | - Nga subjektet e licencuar/autorizuar                                                   |                                           | 752                                                                                                           | 3                                                                                 | 696                                           |                                         |                               |


|   |                                                                           |                |                |              |                |           |            |
|---|---------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|--------------|----------------|-----------|------------|
|   | - Nga subjektet hequr licenca/autorizimi                                  |                |                |              | 0              |           |            |
| 3 | Të ardhura nga përpunimi administrativ                                    | 1,940          | 3,660          |              | 3,559          | 183       | 97         |
| 4 | Të ardhura nga interesat bankare                                          | 150            |                |              | 23             | 16        |            |
| 5 | Të ardhura të tjera (lëshim DVD, fotokopje materiale)                     | 160            |                |              | 43             | 27        |            |
| 6 | Të ardhura të tjera:                                                      | 30,797         |                | 1,371        | 14,554         | 50        |            |
|   | -Nga kamatëvonës                                                          | 5,933          |                | 242          | 7,570          | 135       |            |
|   | -Nga gjobat                                                               | 2,157          |                | 0            | 402            | 19        |            |
|   | -Nga debitorët e viteve të kaluara (licenca/autorizimi me +5% tarifë RTV) | 21,707         |                | 1,129        | 6,217          | 30        |            |
|   | -Të ardhura nga debitorët hequr licenca/autorizimi                        | 1,000          |                | 0            | 365            | 36        |            |
| B | Të ardhura nga paga të kthyer nga ish-punonjës të AMA-s                   |                |                |              | 408            |           |            |
|   | <b>Totali i të ardhurave (A+B)</b>                                        | <b>232,379</b> | <b>207,553</b> | <b>2,552</b> | <b>209,857</b> | <b>91</b> | <b>102</b> |

AMA, në përmbushje të objektivave, pati rritje të arkëtueshmërisë së të ardhurave, duke ndjekur kryerjen e pagesave të detyrime financiare të lindura në vitin 2020, të subjekteve të licencuara/autorizuara, përmes rrugës shkresore, postës elektronike dhe komunikimit telefonik. AMA, gjatë vitit raportues, ka investuar organet gjyqësore për vjeljen e detyrimeve financiare të lindura ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit nga subjektet hequr/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve gjatë viteve 2016-2020.

Burimi kryesor i vetëfinancimit të AMA-s janë **“Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”**. AMA, gjatë vitit 2020, ka vazhduar me trendin rritës të arkëtueshmërisë së burimeve të saj të financimit, ku zëri **“Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”**, për periudhën 2016-2020 paraqitet si më poshtë:

000 lekë

| Vitet | Të ardhura vjetore të pritshme | Të ardhura vjetore të realizuara | Realizimi në % |
|-------|--------------------------------|----------------------------------|----------------|
| 2016  | 160.610                        | 140.242                          | 87%            |
| 2017  | 166.773                        | 156.661                          | 94%            |
| 2018  | 190.052                        | 177.352                          | 93%            |
| 2019  | 188.192                        | 183.229                          | 95%            |
| 2020  | 201.973                        | 190.573                          | 94%            |



Nënzëri **“Të ardhura nga gjobat”**, bazuar në pikën 13, të nenit 133, të ligjit nr. 97/2013, ku përcaktohet se: *“..Gjoba është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s”*, parashikon të ardhura për AMA-n, për vitin 2020, në masën 2,156,847 lekë (10,784,235 lekë x 20% = 2,156,847 lekë).

Në fund të vitit 2020, si rezultat i pagesave nga vetë subjektet apo si rezultat i kontratave të lidhura me përmbarues privatë gjyqësorë, AMA arkëtoi 2,008,191 lekë, prej të cilave 401,638 lekë i përkasin të ardhurave të institucionit.

Ecuria e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, për sanksione me gjobë, gjatë viteve 2016-2020, për arkëtimet e kryera dhe të ardhurat të cilat i takojnë institucionit, paraqitet si më poshtë:



000 lekë

| <b>Titujt ekzekutivë me sanksion gjobë/vitet</b> | <b>2016</b> | <b>2017</b> | <b>2018</b> | <b>2019</b> | <b>2020</b> |
|--------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Arkëtimet në total (100%)                        | 4,085       | 11,326      | 12,977      | 8,832       | 2,008       |
| Të ardhura për AMA-n (20%)                       | 817         | 2,265       | 2,595       | 1,766       | 402         |

Vërejmë se, nisur nga situata ekonomike si rezultat i COVID-19, në vitin 2020 pati rënie të arkëtueshmërisë së pagesave për sanksionet me gjobë.

### 13.3 Detyrimet financiare të OSHMA-ve

#### a) OSHMA të licencuara/autorizuara gjatë vitit 2020

Pasqyra përmbledhëse e OSHMA-ve të licencuara/autorizuara, që rezultojnë me detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, deri në fund të vitit 2020, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

| <b>Kategorizimi i subjekteve</b>                                        | <b>Licencë/autorizim</b> | <b>Tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive RTV</b> | <b>Kamatëvonesa</b> | <b>Totali</b> |
|-------------------------------------------------------------------------|--------------------------|-----------------------------------------------------------------|---------------------|---------------|
| Televizione analoge                                                     | 2,701                    | 660                                                             | 686                 | <b>4,047</b>  |
| Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale              | 0                        | 0                                                               | 915                 | <b>915</b>    |
| Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT) | 2,949                    | 0                                                               | 692                 | <b>3,641</b>  |
| Radio analoge                                                           | 1,461                    | 494                                                             | 362                 | <b>2,317</b>  |
| Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor                       | 3,678                    | 0                                                               | 1,406               | <b>5,084</b>  |
| <b>Shuma totale</b>                                                     | <b>10,789</b>            | <b>1,154</b>                                                    | <b>4,061</b>        | <b>16,004</b> |

AMA, në zbatim të vendimit nr. 220, datë 01.12.2017, “Mbi përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim dhe shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”, vendimit nr. 13, datë 20.02.2020 “Për miratimin e pagesës me këste të detyrimeve financiare për vitin 2020, të subjekteve të autorizuar për përsëritjen e shërbimit programor në rrjet kabllor dhe IPTV, për të ofruar shërbim në qarkun Durrës” dhe vendimit nr. 32, datë 04.05.2020 “Për shtyrjen e afatit të aplikimit të kamatëvonesave mbi pagesat vjetore për licencë/autorizim për vitin 2020, deri në datën 30 qershor 2020”, për subjektet që nuk kanë likuiduar pagesat për licenca/autorizime sipas afateve të përcaktuara, ka përllogaritur kamatëvonesat përkatëse. Vlera e kamatëvonesave, të lindura në fund të vitit 2020, rezultojnë në masën 4,061 lekë në fund të vitit.

#### **b) OSHMA me licenca/autorizime të hequra/konstatim pavlefshmërie, në vitet 2015-2020**

AMA, gjatë vitit 2020, ka marrë vendime për heqje/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve për 8 (tetë) OSHMA, prej të cilave 4 (katër) OSHMA rezultojnë me detyrimeve financiare në fund të vitit 2020, në masën totale 821,707 lekë. Kjo shumë përbëhet prej:

- 1(një) subjekti të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor;
- 2 (dy) subjekte të licencuara për televizion privat vendor; dhe
- 1(një) subjekt i licencuar për audio privat vendor.

Në vitin 2020 është ulur masa e detyrimit të një ish-subjekti të autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, me vendim gjykatë, në masën 19,282 lekë.

AMA ka vijuar të investojë organet gjyqësore gjatë vitit 2020, për vjeljen e detyrimeve financiare subjekteve të cilave iu është hequr licenca/autorizimi apo iu është bërë konstatim pavlefshmërie e tyre, në vitet 2015-2020. Situata e detyrimeve financiare, në fund të vitit 2020, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

| Kategorizimi i subjekteve/vitet | Televizione analoge |                          | Ripërsëritës programi |                          | Ofrues programi |                          | Radio analoge  |                          |
|---------------------------------|---------------------|--------------------------|-----------------------|--------------------------|-----------------|--------------------------|----------------|--------------------------|
|                                 | Nr. Subjekteve      | Masa detyrimit financiar | Nr. Subjekteve        | Masa detyrimit financiar | Nr. Subjekteve  | Masa detyrimit financiar | Nr. Subjekteve | Masa detyrimit financiar |
| 2015                            | -                   | -                        | 5                     | 10,405                   | -               | -                        | -              | -                        |
| 2016                            | 4                   | 5,388                    | 14                    | 59,077                   | 2               | 25,042                   | 4              | 1,939                    |
| 2017                            | 3                   | 415                      | 7                     | 2,754                    | 1               | 162                      | 3              | 1,105                    |
| 2018                            | 6                   | 3,179                    | 7                     | 670                      | -               | -                        | 1              | 106                      |
| 2019                            | 2                   | 199                      | 3                     | 2,186                    |                 |                          | 1              | 105                      |
| 2020                            | 2                   | 621                      | 1                     | 87                       | -               | -                        | 1              | 114                      |
| <b>TOTALI</b>                   | <b>113,554</b>      |                          |                       |                          |                 |                          |                |                          |

### 13.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2020

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projektbuxhetin për vitin 2020, të ndryshuar, si dhe në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, të ndryshuar.

Referuar situatës së krijuar prej pandemisë COVID-19, AMA ka bërë disa ndryshime në Regjistrin e Parashikimeve Publike për vitin 2020, për parandalimin e përhapjes së infeksionit.

#### 13.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2020

000 lekë

| Nr. | Emërtimi i Shpenzimeve/Investimeve                                                                             | Plani          | Shtesa/pakësime gjatë vitit 2020 | Fakti          | % e realizimit |
|-----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------------------------|----------------|----------------|
|     |                                                                                                                | 1              | 2                                | 3              | =3/(1+2)*100   |
| I   | <b>Shpenzime korente (a+b)</b>                                                                                 | <b>215,807</b> | <b>7,334</b>                     | <b>166,216</b> | <b>74</b>      |
|     | a) Paga, kontribute për sig. Shoq. dhe shend., shpërblime                                                      | 84,129         | 4,723                            | 82,236         | 93             |
|     | b) Shpenzime për mallra dhe shërbime                                                                           | 131,678        | 2,611                            | 84,073         | 64             |
| II  | <b>Shpenzime për investime (a+b+c)</b>                                                                         | <b>39,245</b>  | <b>-9,276</b>                    | <b>21,216</b>  | <b>71</b>      |
|     | <b>a) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara</b>                                                                  | <b>7,500</b>   | <b>4,800</b>                     | <b>8,009</b>   | <b>75</b>      |
|     | - Studime, kërkime, anketime                                                                                   | 7,500          | 4,800                            | 8,009          | 75             |
|     | <b>b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara</b>                                                                  | <b>31,439</b>  | <b>-14,066</b>                   | <b>13,034</b>  | <b>75</b>      |
|     | - Blerje pajisje elektronike                                                                                   | 700            | 260                              | 840            | 88             |
|     | - Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike                                                                      | 19,302         | -8,883                           | 6,837          | 66             |
|     | -Programe/aplikacione                                                                                          | 5,984          | -5,444                           | 0              | 0              |
|     | - Investime të pritshme (procedura në proces prokurimi në vitin 2019) për "Pajisje për spektrin e frekuencave" | 5,454          |                                  | 5,357          | 98             |
|     | <b>c) Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme</b>                                                      | <b>306</b>     | <b>-10</b>                       | <b>173</b>     | <b>58</b>      |
|     | - Projekte                                                                                                     | 120            |                                  | 0              | 0              |
|     | - F.V. për sistem me sensorë për rrjedhjen e ujit në dhomën e serverit; F.V. pompë uji                         | 186            | -10                              | 173            | 98             |

## 1. Me fondet e veta AMA realizoi:

- Shpenzimet për *paga e shpërblime, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore* sipas strukturës organizative, si dhe shpenzimet e nevojshme për mallra dhe shërbime të kërkuara nga drejtoritë/njësitë e saj.

- Bazuar në projektbuxhetin për vitin 2020, të miratuar me vendimin nr. 183, datë 19.12.2019, AMA lidhi aktmarrëveshjen nr. 23, datë 06.01.2020 me shoqërinë “Media +” sh.a., për të parandaluar bllokimin e llogarive bankare të institucionit nga shoqëria përmbarimore dhe ekzekutimin e menjëhershëm të detyrimit. Me këtë aktmarrëveshje, me afat deri më 01.01.2021, AMA uli masën e detyrimit me 25,305,036 lekë (25,000.000 lekë të likuiduara nga të ardhurat e AMA-s dhe kompesimin reciprok prej 305,036 lekë për detyrimin vjetor për licencë dhe tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive të vitit 2020). Në fund të vitit 2020, detyrimi i AMA-s ndaj shoqërisë “Media +” sh.a. është në masën 11,191,369 lekë.

AMA, në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Ministrinë e Kulturës, lidhur në datën 05 tetor 2020, mbështeti financiarisht Ministrinë e Kulturës në masën 7,200,000 lekë, për projektet “Edukimi përmes Kulturës” dhe “Digjitalizimi i Filmit”.

AMA, me fondet e saj realizoi gjatë vitit 2020 fushatat informuese për publikun përmes transmetimit të spoteve në televizione dhe radio kombëtare dhe lokale, për mbylljen e transmetimeve analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë më datë 30 shtator 2020, si dhe mbylljen e tyre në qarqet Dibër, Kukës dhe Gjirokastrë, më datë 30.12.2020.

## 2. Ecuria e investimeve:

Në zërin “*Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara*” (pjesë e Investimeve Korente), u realizuan:

- Zëri “*Studime dhe kërkime*”, i ndryshuar, u realizua në masën 8,009,243 lekë për financime të projekteve me tema: “Shkrimi dhe raportimi i lajmit – teori dhe praktikë”; “Cilësia e lajmeve televizive të transmetuesve televizivë shqiptarë”; “Studimi i tregut audioviziv në vendin tonë lidhur me mbulimin e territorit me sinjal bazuar në teknologji të ndryshme (kabllor, tokësor, IPTV, satelitor, etj.) si dhe impakti që ka sjellë digjitalizimi i transmetimeve audiovizive”; përmbylljet e projektit “Realizimi i një studimi dhe analize të performancës në tregun audioviziv, vlerësimeve të ndjekësve të përmbajtjeve të transmetuara, përfshirë dhe publikimin (me ISBN), fokusuar në evitimin e diskriminimit me bazë gjinore dhe dhunës së çdo forme ndaj grave dhe vajzave” dhe projektit “Krijimi i kushteve për një media egalitare dhe jo diskriminuese në Shqipëri dhe rritja e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore në media”.

Në zërin “*Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*” u realizuan shpenzime për:

- “Blerje pajisje elektronike/kompjuterike”, konkretisht për “Blerje server për sistemin e replikimit të aktiveve directory”.

- “Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike”, konkretisht për HDD të jashtme; televizor DVB-T2 43”, Kaseta LTO; blerje kufjesh profesionale për monitorim; vegla pune, kamera WEB, aparat për thithje lagështire; blerje zbulime për festat e fundvitit; pajisje për monitorimin dhe regjistrimin e spektrit audio FM në Elbasan, Pogradec, Lezhë dhe Sarandë, termometër Infrared; sistem i ri të monitorimit të radiove.

Gjithashtu, pas vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u realizua zëri Investime të pritshme (procedura në proces prokurimi në vitin 2019) për "Pajisje për spektrin e frekuencave".

Në zërin “*Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme*” u realizuan shpenzime për, konkretisht, “F.V. për sistem me sensorë për rrjedhjen e ujit në dhomën e serverit” dhe “F.V. pompë uji”.

### 13.5 Pasqyrat financiare

#### *Pasqyra të ardhura dhe shpenzime në datë 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020*

lekë

| Nr .                                      | Emërtimi                                                                              | Viti 2020          | Viti 2019          |
|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| <b>A</b>                                  | <b>Të ardhurat korente të periudhës</b>                                               | <b>216,208,795</b> | <b>211,169,731</b> |
| 1                                         | Të ardhura nga licenca/autorizim                                                      | 202,589,141        | 192,235,625        |
| 2                                         | Të ardhura si agjent tatimor                                                          | 750,256            | 893,933            |
| 4                                         | Të ardhura nga përpunimi administrativ                                                | 3,610,000          | 3,243,700          |
| 5                                         | Të ardhura nga interesat bankare                                                      | 38,803             | 99,870             |
| 6                                         | Të ardhura të tjera nga gjobat, kamatëvonesa për licenca/autorizime/gjoba             | 9,220,595          | 11,069,447         |
| 7                                         | Rimarrje shumash të njohura si shpenzim në vitet e kaluara                            | 0                  | 3,627,156          |
| <b>B</b>                                  | <b>Shpenzime operative</b>                                                            | <b>107,261,936</b> | <b>108,510,431</b> |
| 1                                         | Materiale zyre kancelari                                                              | 2,777,518          | 2,829,080          |
| 2                                         | Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli                                     | 87,837,125         | 86,261,767         |
| 3                                         | Shpenzime mirëmbajtje të godinës                                                      | 1,409,428          | 1,159,408          |
| 4                                         | Shpenzime për shërbime furnizuese                                                     | 8,643,783          | 15,138,416         |
| 5                                         | Shpenzime transporti dhe mirëmbajtje të makinave                                      | 2,397,292          | 3,105,760          |
| 6                                         | Taksa vendore                                                                         | 15,000             | 15,000             |
| 7                                         | Shpenzime gjyqë, legale                                                               | 4,181,790          | 1,000              |
| <b>C</b>                                  | <b>Shpenzime të veprimtarisë funksionale të AMA-s</b>                                 | <b>44,427,521</b>  | <b>49,800,952</b>  |
| 1                                         | Konsulenca, trajnime, studime tregu                                                   | 994,280            | 822,008            |
